Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (135). KORRIK 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Natyra

Lugina e Drinit, një mrekulli natyrore e botës

Nga dr. **Selman Mëziu**



Albanologji

Josif Bageri i Rekës së Dibrës

Nga prof.dr. **Shaban Sinani**





Debat

Rreth përkatësisë etnike të Vojsava Tribaldës "Kastriotit"

Nga **Hilmi Sadikaj**



HIDROCENTRALI I SKAVICËS

Samiti i Triestes rikthen debatin, qeveria nuk tregon detajet e projektit

FAQE 2,3,4

REPORTAZH

Stebleva, fshati që nuk blihet



Nga **BUJAR KAROSHI**

Stebleva, një nga fshatrat e krahinës së Golobordës, 35 km larg nga Librazhdi, është një fshat i vizitueshëm gjatë verës. Rrethuar me pyje të lartë, ajër i freskët dhe gjelbërim ngado, është një oaz i mrekullueshëm në lindje të Shqipërisë. Mersin Hoxha, kryetari i Shoqatës "Stebleva", ndryshe nga kolegët e tij të shoqatave dibrane në Tiranë, që kujtohen për vendlindjen vetëm për Ditëvere a Shëngjergj, është kthyer ta drejtojë shoqatën e tij në Steblevë, aty ku ka trojet e të parëve të tij. Por është kthyer ndryshe: duke ndërtuar një shtëpi druri bashkëkohore, me të gjitha komoditetet dhe pajisjet e nevojshme, të cilën e ka të hapur për të gjithë ata që duan të vizitojnë dhe ta njohin Steblevën.

(Lexoni në faqet 12-13)

Mikpritje, traditë dhe natyrë

Dibra, destinacion turistik

Nis zyrtarisht projekti D2T: **"Dibra: Turizëm & Traditë"**

FAQE 8-9



NË BRENDËSI:

■ **Skavica** në defterin e Ramës së Dytë ■ **Të ndërpriten** punimet në HEC Seta 4 ■ **Staravec**, rruga po rikthen besimin te investimet ■ **Filizat** e fisit Nikolli ■ **Mes** Beratit dhe Dibrës ■ **Klara**, vajza 11 vjeçare që ngjiti malin e Korabit ■ **Dibra** nga Antikiteti në Monarki ■ **Jonida Trupja**, logopedja pioniere e Dibrës ■ **Faton Daci**, fizioterapisti i Dibrës ■ **Dhunohet** busti i atdhetarit Mersim Dema ■ **Vjollca Kola**, një jetë në arsim ■ **Sllova** është e Dibrës, Sllovana është e imja ■ **Ky gusht** më gjen të martuar! ■ **Për një** Dibër të bashkuar ■ **Letër nënës** nga shumë larg ■ **Ali Puca**, mësuesi me zemër të madhe

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT.

Kushton vetëm 600 lekë në vit.

email: rrugaearberit@gmail.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (135). Korrik 2017

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI

Kontribuan për këtë numër:
Besnik ALKU
Selman MËZIU
Shaban SINANI
Hilmi SADIKAJ
Ilmi DERVISHI
Mentor HOXHA
Zabit LLESHI
Dionis XHAFA
Grehans UKA

Fotoreporter: Fehmi LLESHI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Skavica në defterin e Ramës së Dytë

Reagime pas një lajmi me "tre rreshta" në facebook. Këndvështrime, paqartësi, mungesë njohjeje, një debat shterp ku askush nuk e zë në gojë Ramën dhe shashkën e hedhur pas Samitit të Triestes.
Me sa duket luginës së bukur të Drinit të Zi nga Gjorica në Skavicë i ka ardhur në gojë MBYTJA!...



LAJMI:
Kryeministri Rama nxori nga sirtari projektin -"HEC-i i Skavicës", njeri prej pesë projekteve të pranuar në Samitin e Triestes. Projekti do të zbatohet sepse në Dibër NUK KA DIBRANË?!

REAGIMET...

Petrit Lahi: Dibranët ike dhe pijanecët ngelen aty, pse jo?

Arben Ismaili: Jo nuk ikën dibranët dhe as nuk ngelen aty pijanecët, por kanë vdekur ato që u larguan dhe e harruan Dibrën, ato që mbahen për dibranë Petrit Lahi!

Abdurahim Ashiku: Kujdes Beni. Unë jam larguar nga Dibra me dhunë dhe nuk e kam harruar atë. Bëra edhe një libër me pensionin tim por ti si gazetar në atë kohë nuk të pashë të shkruaje qoftë edhe një rresht në fb (lere pastaj në shtypin qendror e në "Rruga e Arbërit" në përkrahje e jo më të organizoje në Peshkopi e Tiranë ndonjë promovim. Nisur nga kjo, në një far mase jam dakord me Petrit Lahin. Unë nuk kam vdekur zotëri dhe nuk e kam harruar Dibrën.

Abdurahim Ashiku: Dhe një shtesë: Nuk kam moshë që nga kodra e ugrades së prindërve të mi, ulur në ballkonin e shtëpisë time të ëndrrave, që sheh jugun, Çapin e Brezhdanit nën ujë të kujtoj të mbyturit...

Petrit Lahi: Unë asnjëherë se kam harruar Dibrën dhe pse jam larguar që në vitin 1980 në Tiranë dhe në 1991 në emigrim e kam treguar veten si dibran duke vajtur çdo vit në vendlindje dhe në vitin2015 e tregova veten që jam atdhetar,

Arben Ismaili: Por jo te ofendosh njerëz të ndershëm dibranë z. Petrit duke u thënë pijanec. Nuk mund të jesh dibran patriot duke ofenduar!

HajredinToca: Unë do isha dakord të mos bëhej Skavica nëse lugina e Drinit do lulëzonte nga zhvillimi bujqësor e blegtoral.

Arben Ismaili: Edhe unë ashtu siç thoni ju mendoja z.HajredinToca, por mendja më ka ndryshuar shume kohe qe Skavica do behet me 1 dige. Ishte koha kur unë punoja si gazetar (korrespondent) ne qarkun e Dibres ne një televizion kombëtarë kur shkoja te intervistoja banoret e fshatrave qe prekeshin nga projekti i Skavices. Ne intervistat qe merrja nga banoret e këtyre fshatrave qe prekeshin nga ky projekt shikoja dhe dëgjoja vendosmërinë qe ky projekt te mos behej. Ne interviste përveç dëmeve ekonomike qe u behej aty përmendej dhe demet e tjera kulturore dhe historike te patjetërsueshme qe kishte zona e pellgut te Drinit te Zi. Por zhgënjimi u be me i madh kur ne një takim qe u be ne ambientet e prefekturës se Dibrës, te gjithë këto banore dhe kryepleq si dhe kryetar komunash me stafin e tyre interesoheshin sesa do te ishte vlerësimi për metër katror?! Dhe sa për historinë e dibraneve po na plasin sytë nga Kalaja e Grezhdanit qe është mbi 2000 vjeçare me 14 kulla vrojtimi dhe as është marre mundimi për zbulim te mëtejshëm apo dhe pë rnjë restaurim thellesor e cilësor qe asnjë nga dibranet e brendshëm, as ato te larguar ne Tirane apo ne mërgim nuk e kane ngritur zërin për Kalanë e Grezhdanit.

Adem Bunguri: I dashur Abdurahim,

Tani që shoferi ynë trendi ka marrë timonin dhe tepsinë, kazanin dhe kusinë, tani gjithçka është e mundur! Tani u harruan premtimet për Rrugën e Arberit, dhe po i jepet kerrit me gaz të shfrënuar drejt Danubit, për t'i bërë Dibrës atë që nuk arriti shkau me luftë.

E more i dashur Abdurahim, si erdhën punët! Po synohet asgjësimi fizik i Dibrës, dhe kjo prej shqiptarëve që i kanë hipur kalit mbrapsht, që hanë në Tiranë dhe ëndrrat i shohin në Beograd!

Megjithatë, unë vazhdoj të besoj me zemër dhe me shpirt, se populli i Dibrës, nuk do ta lejojë të ndodhë kjo hata!

Abdurahim Ashiku: Shpresa thonë se vdes e fundit por unë e kam humbur atë.

Vesel Hoxha: Përshëndetje të gjithëve,

Edhe unë, shumë vite më parë, kam dhënë disa mendime nën titullin: "A duhet të ndërtohen H/C në Lumin e Drinit të Zi".

Pata asokohe edhe një përballje në shtyp me z. A. Ashiku, në gazetën Rruga e Arbërit. Janë të njohura mendimet dhe këndvështrimet e dy palëve. Këtu dua do nënvizoj apo të sjellë në vëmendje vetëm një frazë:

"Ndërtimi i H/C të Skavicës, do të dalë në rend të ditës here-pas-here.....dhe, për fat të keq me variantin me një digë. Kjo, as më shumë e as me pak, është fundosja e Dibrës." Gjithsesi tani, askush nuk e din saktë projektin që bëhet fjalë. ...por, nisur nga intervistat e disa "Luigjave..të moshuar...të kohës së monizmit.", shumë kohë më parë, dyshoj përsëri se bëhet fjalë për një digë shumë të madhe, të frikshme".

Çuditem...Vjosën kanë frikë ta "prekin"...e duan të virgjër. ...kurse.....Drinin e Zi.. Jo, Setën.. Jo, Sopanikën.. Jo, Resnën..Jo.!!??

Shpetim Miftari: Përshëndetje z Abdurahim ne një takim rastësor qe pata me znj. deputete Blerina Gjylameti para zgjedhjeve me dha dhe fletpalosje kur e lexova flitej se do te bëjmë Skavicën dhe jo Rrugën e Arberit pas një debati qe pata me të me tha qe është bere gabim se ne do bëjmë rrugën dhe jo Skavicën. I thash se Skavica e shkatërron Dibrën ndërsa rruga është zhvillimi i Dibrës.

Nazmi Bitri: Të nderuar Dibranet e mi: Unë jam larguar por 52 vite te jetës time i kalova ne Dibër. Më deshën dhe më urryen marrëzisht për politikë se u bana familja më armike e Dibrës. Por unë edhe sot kam miq të mrekullueshëm që nga ish komunistet e ndershëm si vellai i Abdurahimit dhe babai i Arbenit. Nuk na ka hije të shigjetojmë njeri tjetrin. SKAVICA nuk duhet lejuar. Ajo Dibre duhet të mbrohet nga ne Dibranet qe kudo qe jemi duhet te jemi bashke kundër maskaradave

Selman Meziu: Pyetjet qe shtrohen ne këtë debat mendoj unë janë:

SA ASHT E VERTET QE NE MBLEDHJEN E TRIESTES QENKERKA APROVUAR KY PROJEKT?

Perse vallë na u dashka akoma pa u formua qeveria te hidhet një vendim i tille, i pa studiuar dhe i pa debatuar i pa organizuar e ligjëruar?

A mendoni se Kryeministri RAMA te ndërmarrë një aventure te tille e cila pa as ma te voglin dyshim i kushton shume ne shume drejtime?

A nuk asht marre një vendim qeverie qe deri ne fundin e vitit 2018 nuk do te ndërtohet as një hidrocentral?

A thua ky kryeministër e harroi vendimin e bashkimit evropian për ndërtimin e hidrocentraleve ne VJOSE?

Naim Kukeli: Përshëndetje për te gjithë këto vëzhgues qe po shkruani dhe po i lexoni te gjithë paragrafët e njeri tjetrit. Te gjithë personat qe po shkruani për ketë problem te gjithë jeni koka qe pak a shume u njehe "Dibra" a e kuptoni qe hidrocentrali qe behet ne Skavajc behet për interes te kuadrove te mëdhenjve si Debutet e për njerëz qeveritar për ta mbizotërua vet dhe jo për popull se asnjë leverdi ska populli vetëm dëme nga toka ju pse nuk këmbëngulni për Rrugën e Arbrit qe sipas dokumenteve qe janë hapur projekti ka qene qe ne vitin 1939 shikoni sa kohe është zvarritur, a e kuponi se për Dibrën nuk interesohet kush pse nuk ngreni këtë problem Z. Hajredin shkruan shume bukur pse te behet Skavajca një gjë qe është vetëm ne dem te popullit por edhe Petrit Lahi ka shkruar shumo mire se kokat e Dibrës janë larguar vetëm kane mbet njerëzit e pa afte. Populli e pa Dibrën ne votime u shite

(Vijon në faqen 4)

aktualitet

Majlinda Dhuka, Drejtore e Departamentit i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri: **"Morëm mbështetje për zhvillimin e hidrocentralit të Skavicës, një nga veprat më të mëdha energjetike të vendit dhe të Ballkanit Perëndimor"**

HIDROCENTRALI I SKAVICËS

Samiti i Triestes rikthen debatin, qeveria nuk tregon detajet e projektit

Nga **BUJAR KAROSHI**


Hidrocentrali i Skavicës ridel sërish në skenë pas Samitit të Triestes, i cili u zhvillua më 12 korrik 2017, ku morën pjesë 6 shtete të Ballkanit Perëndimor, të cilët konkurruan me projekte për të marrë financime nga Bashkimi Europian.

Majlinda Dhuka, Drejtore e Departamentit i Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri, gjatë një konference shtypi mbajtur me 14 korrik, së bashku me Kryeministrin Edi Rama, tha se morëm "mbështetje për zhvillimin e hidrocentralit të Skavicës, një nga veprat më të mëdha energjetike të vendit dhe të Ballkanit Perëndimor". Kjo mbështetje ishte një nga katër projektet që Shqipëria mori nga Samiti i Triestës.

Në të njëjtën konferencë shtypi, Kryeministri Rama nuk e përmendi më Skavicën, por iu referua investimit mbi Rrugën e Arbrit, si për të ulur diskutimet mbi çështjen e Skavicës, aq të debatuar në publik.

"Ashtu sikundër besoj që me fillimin e realizimit të Programit "1 Miliardë për Rindërtim" të qeverisë shqiptare, që nis në këtë vjeshtë me Rrugën e Arbrit" theksoi Kryeministri.

Skavica duket se është një nga çështjet që përmendet nga qeveria shqiptare, sa herë që ajo ndodhet ndodhet përballë vështirësive, sidomos për sa i përket mungesës së investimeve të huaja të mëdha në vend.



Varianti i Skavicës me 2 diga. Skavicës 395 metra. Katundit i ri 444 metra.
(Burimi: Ministria e Energjisë dhe Industrisë. "Shfrytezimi i Potencialit Hidro-Energjetik të lumit Drini i Zi", Agim Bregasi, Shkurt 2016. Faqe 7.)

SKAVICA, PROJEKTET NË VITE

Ideja për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës fillon që në vitet 1960. Pas studimesh për rreth dy dekada, rreth viteve 1980 filloi të flitej publikisht për të. Sipas projektit të asaj kohe, hidrocentrali do të ndërtohej në grykën e Skavicës, ku shtrati i Drinit të Zi ngushtohet deri në 40 metra në një gjatësi 5-6 kilometra. Që në atë kohë studimi kishte paraparë dy zgjidhje te cilat në vetvete përbënin dy projekte të ndryshme.

Zgjidhja e parë parashikonte ndërtimin e një dige 163 metra të lartë, që krijonte një liqen artificial me nivel normal të tij në kuotën 445 metra mbi nivelin e detit. Vëllimi i digës do të ishte 11 milionë metër kub. Ky variant përmbyste luginën e Drinit të Zi deri në kufi me ish-republikën Jugosllave të Maqedonisë. Vëllimi i liqenit do të ishte 2.7 miliardë metër kub, sipërfaqja 60 km katror, fuqia e instaluar 350 megavat, si dhe energjia e prodhuar në vit do të ishte 1 miliardë kvh. Kosto e ndërtimin në këtë variant ishte parashikuar 600 milionë USD.

Zgjidhja e dytë parashikonte një digë shumë më të lartë, 210 metra, po në Skavicë, që e shfrytëzonte luginën e Drinit tërësisht. Vëllimi i digës do të ishte 16.5 milionë metër kub. Kjo digë krijonte një liqen me nivel normal në 485 metra mbi nivelin e detit dhe që kishte shtrirje e përmbyste deri në brendësi të ter¬ritorit maqedonas. Diga ishte e parashikuar në të dy zgjidhjet të vendosej në kuotën 305 m mbi nivelin e detit në ceketinën e luginës, të krijuar nga lumi Drin i Zi (Gryka e Skavicës). Vëllimi i liqenit do të ishte 6.5 miliardë metër kub, më shumë se dyfishi i Liqenit të Fierzës. Sipërfaqja 95.5 km katror, fuqia e instaluar 350 megavat, si dhe energjia e prodhuar në vit do të ishte 1.3 miliardë kvh. Kosto e ndërtimin në këtë variant ishte parashikuar 950 milionë USD. Ky variant do të krijonte një kaskadë të në Drin me rregullim disavjeçar.

Me rënien e regjimit komunist, qeveritë në vend nuk patën kapacitete financiare për ta vazhduar projektin, kështu që gjithçka u la në mes.

Në Maj 2005, qeveria shqiptare miratoi në vendim "Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës sipas propozimit të pa kërkuar". Sipas këtij vendimi, Skavica do ti jepej me koncension grupit TGK (Tasara-Geo Tecna -Kinglor).

Por, më shumë se tre vite më vonë, më 17 dhjetor 2008, qeveria shqiptare hapi një tender për ndërtimet e HEC të Skavicës, në të cilën morën pjesë gjashtë kompani të huaja, mes të cilave, përveç TGK, ishin edhe Korporata Energjetike e Koresë së Jugut, shoqëria norvegjeze STATKRAFT, dy kompani austriake VERBUND dhe KELAG GRUP, si dhe konsorciumi gjerman "R.W.E" AG.

Më datë 5 janar 2009, komisioni i vlerësimit të ofertave duhej të shpallte fituesit për vazhdi¬min në fazën tjetër, por kjo nuk ndodhi kurrë. Qeveria shqiptare e asaj kohe pranoi dështimin vetëm një vit më vonë, duke ia vendosur për këtë fajin krizës ekonomike që kishte filluar të godiste eurozonën.

Por, kryeministri i asaj kohe, duke mos pranuar gjendjen e keqe financiare në vend, theksonte se "situata është më premtuese që qeveria të konsiderojë vetë ndërtimin e kësaj vepre gjigante. Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës, KESH-i dhe agjenci të tjera duhet ta shqyrtojnë me hol-lësi, duhet të hapë tenderin për projektin, nga studimet fillestare deri tek projekti i zbatimit, ose të përcaktojë parimet dhe ta tenderoi me çelësa në dorë".

Që nga viti 2009 deri në me stë vitit 2014, Skavica u harrua. U bë shkak një takim përfaqësuesve të konsorciumit Power China Corporation me ministrin e energjisë dhe Industrisë, Damian Gjiknuri, që Skavica të rikthehej në vëmendje.

Por ndërkohë që kompani kineze kishin dhënë oferta për Skavicën, qeveria shqiptare i dha një kompanie turke bonus për ndërtimin e një hidrocentralit tjetër mbi Drin, atë të Katundit të ri, i cili hapi një debat të madh në vend në lidhje investimet energjetike mbi Drin.

Përveç kundërshtarëve, kryesisht banorëve të zonës, për mosndërtimin e asnjë HEC, ka edhe qëndrime që ndahen në mënyrën nëse duhet të ketë një HEC të madh në Skavicë, dy HEC më të vegjël në Skavicë dhe Katund të Ri, apo ndërtimin e tre HEC: Skavicë, Arras dhe Katundi i Ri.

Tenderi i HEC i Katundit të ri dështoi, megjithëse kompania turke kishte marrë 8 pikë bonus.

HEC i Katundit të Ri do të ndërtohet në një kuotë 445 metra. Parashikohej të kishte një kapacitet ujëmbledhës prej 12.4 milionë metër kub, me një fuqi të instaluar prej 49 MW dhe prodhim vjetor prej 206 GWh. Ky hidrocentral do të përmbytë vetëm 87 hektarë tokë dhe do të zhvendosë nga banesat e tyre 150 persona. Vlera e Investimit e HEC të Katundit të Ri do të ishte 99.5 milionë euro, por shoqëritë turke "Suzer Group" dhe "Nurol Holding" u tërhoqën nga gara.

* * *

Ndërtimi i HEC të tjera mbi Drin duket se do të jetë në synimet e ardhshme të qeverisë shqiptare. Ajo ka kryer një studim të plotë mbi këto projekte, por nuk është bërë akoma e qartë se mbështetja financiare e marrë nga Samiti i Triestës është për projekte financimi apo plane studimi. Kjo do të mbajë të hapur debatin mbi grupet e interesit në vend, të cilët vazhdojnë të jenë të ndarë mbi perspektivat e zhvillimit të këtij rajoni.

STATISTIKA

Ofertat e kompanive energjetike nga Kina

Qeveria shqiptare ka marrë propozime, madje ka firmosur edhe Letra Mirëkuptimi për ndërtimin e Skavicës së Madhe si pronë e KESH nga tre kompanitë më të mëdha në Kinë dhe në botë (PoëerChina, GeZhouBa dhe Norinco), që i propozuan qeverisë shqiptare (KESH-it) financimin 100 për qind të Skavicës së Madhe (1 miliardë euro), me një kredi të butë 35 vjeçare, 7 vjet periudhë mospagimi dhe në vazhdim 2 përqind në vit interes. Por qeveria nuk u ktheu kurrë përgjigje kompanive të mësipërme.

Power China, kompania më e madhe e hidroenergjisë në botë, me 53% të tregut botëror ka dorëzuar një ofertë pranë qeverisë shqiptare më datë 30 tetor 2014. Ajo parashikon një financim 1 miliard euro dhe do ta ndërtonte Skavicën me një "Leasing Contract" 15 vjeçare. Pasi me çmim mesatar të energjisë 5 €c/MWh dhe me prodhim 2 milionë MWh në vit, Skavica do të gjeneronte 100 milionë euro në vit. Pra do të vetëshlyhej nga 12 deri në 15 vite.

Një ofertë të dytë të ngjashme qeveria ka marrë edhe nga kompania e dytë energjetike në Kinë, Ge Zhou Ba

Ndërsa oferta e tretë që qeveria ka marrë gjatë vitit 2014 është sërish nga një kompani kineze, NORINCO, një grup i fuqishëm industrial kinez, i cili ka propozuar një financimin 100%, 1 miliard euro, me një kredi të butë 35 vjeçare, 7 vjet periudhë pa pagesë dhe në vazhdim 2% në vit interes.

Në lojë është edhe një kompani gjermane, "Becker Büttner Held", e cila ka dhënë detaje mbi modelin e financimit të hidrocentralit të Skavicës.

Rruga e Arbërit nr. 135

opinione

Skavica në defterin e Ramës së Dytë

(Vijo nga faqa 2)
populli për 50 mije leke te vjetra a kjo është dinjiteti i DIBRES...!

Flamur Bulku: Mendoj se Titi fjalën pijanec e ka për kuadrot e Dibrës dhe jo për popullin, se ai është i zgjuet. Persa i përket hecit me sa kam informacion ndertohet mbi uren e Katundit te ri me kuote 445 m mbi nivelin e detit.Tre metër poshte urës Topojanit. Kjo kuote zhvillon zonën ne te gjithë resurset.

Vesel Hoxha: Ok, Flamur. Por nga këshilltarja e kryeministrit u përmend Skavica. Katundi i Ri është tjetër gjë.

Pra Skavica eshte Skavica.. bile dhe për rkëtë ka studime te cilat e lëvizin vend-ndërtimin e digës, por kjo eshte tjetër gjë.

Katundi i Ri eshte Katundi i Ri, njeri nga tre variantet e propozuara per te kundërshtuar Skavicen me një dige te madhe ku, ne Skavice apo 1-2 km me poshte... ne Ujemisht... propozohet nje dige me kuote max. 365 - 368 m. Kjo përkon me kuotën e Urës se Lushës.

Flamur Bulku: Kuota Katundit te ri është pjese e projektit me tre diga te Skavices. Diga Skavice 370. Diga Kodra Bitrit 390 dhe diga Katund i Ri 445 m. Ndërtohet ne fillim Katundi i Ri se këtu eshte interesi me i madh. Ky hec do te jete gjithmonë ne pune si i Dibres o ing.Veseli.

Vesel Hoxha: Përshëndetje Flamur,

Unë kam dijeni te plote për sa shkruani. Kam shkruar gjere e gjate ne gazeta per tre digat dhe kuptohet se bashku me nje koleg timin, nje profesor mjafte te degjuar, kemi bere dhe studimet përkatëse. Une thjesht bëra nje saktësim. Te fala dhe klm.

Vesel Hoxha: Nuk duhet te thuhet pjese e projektit Skavica me tre diga. Ketu eshte gabimi. Secili ka specifikat dhe emrin e vete.

Mendu Damzi: Dibranet janë veç për hallvë. Dibranet e vërtetikën, kanë ngele ata qe nuk duan tja dine sec behet, shesin votën per dy kg. mish dhe për katër vjet qajnë se nuk kanë kujt ti kërkojnë drejtësi se blerësi nuk e qas as te oborri i institucionit, pasi i bleri nuk kate drejte te kërkojnë atë qe shiti. Te shesësh votën eshte te shesësh te drejtën tende,te shesësh lirinë, te shitesh për katër vite te blerësit, te japish veten me koncesion te koncesionari. Edhe Skavica per pak vite siguron vende pune, por pas ndërtimit nuk ka me vende pune por humbasin dhjetëra mijëra vende pune për fermerët dibranë, pasi token me te mire te Dibrës e mbulon uji i liqenit, kjo do jete dhe nji katastrofe ekologjike.

Lulzim Hoxha: Përshëndetje te gjithë komentuesve!

Se pari ju kërkoj ndjese se nuk dua te luaj me ndjenjat dhe nostalgjitë qe kane komentuesit me HECIN e Skavices, se dyti dua dhe unë te jap opinionin tim ne lidhje me ndërtimin e këtij projekti!


Unë mendoj se gjithë lugina e Drinit te Zi qe permbytet nuk ka lidhje me ndërtimet arkeologjike pasi te paret tone ishin te zgjuar duke ndërtuan ne kodra!

Tokat pjellore te Dibrës qe mund te përmbyten nuk janë me pjellore si me pare pasi plehëruat, plugimet dhe tregu i prodhimeve kane kosto dhe do vazhdojnë te kenë kosto dhe ne dekadat e ardhshme.

Ne lidhje me ndryshimet e ekositemit nuk di ç'te them pasi nuk di nese ndonjeri di te na thote se ç'dëme sjell?!

Rruga e Arbrit do lidhet me Peshkopinë por do te izoloje vijën e fshatrave nga Luznia deri ne Skavice por dhe ato do mund te shfrytëzohen nga krahu I Burrelit.

Por lind pyetja -Çdo te jete Peshkopia pa fushën e Luginës se Drinit ??Atëherë unë do te them se do jete siç eshte tani me fushën e luginës se Drinit!



Varianti 1 i Skavicës me 1 digë. Niveli 441 metra. Fuqia e instaluar: 193 MW. Prodhimi vjetor: 768 GWh. Investimi 662.4 milionë Euro. Sipërfaqja e përmbytur: 5861 Ha. Popullsia e zhvendosur: 10000 persona.
(Burimi: Ministria e Energjisë dhe Industrisë. "Shfrytezimi i Potencialit Hidro-Energjetik të lumit Drini i Zi", Agim Bregasi, Shkurt 2016. Faqe 6.)

Popullsia qe ka mbetur ne ato zona flas per vijen gjeografike Luzni-Skavice (se ato njoh me mire) ka nevoje per projekte shtetërore te rigrupohet dhe tu shërbehet diku se ka dendësi shume te vogël per km katror.

Nëse Skavica ndërtohet ate per 100 vite do ta mbuloje llumi dhe shpejt do te kthehet në moçal e pastaj te thahet si Terbufi dhe Malici.

Unë mendoj qe populllsia e zonës ku përmbyten te grupohen dhe te bëjnë Kontrata te zgjuara me ndërtuesin e Skavices!

Ju kërkoj ndjese për mendimin ndryshe!

Abdurahim Ashiku: Më fal por nuk e paske idenë fare dhe flet si nga maja e Korabit. Po të pyes: Sikur në Cangonj të Korcës të ngrihej një digë e madhe sa ajo e Skavicës mbi lumin Devoll a do ta pranonin korçaret mbytjen e fushës së tyre, a do të bënin "Kontrata te zgjuara" me mbytësit e fushës së Korçës? Pse ti dhe unë kemi ikur mos vallë duhet të ikë edhe Dibra ?

Lulzim Hoxha: I nderuar Profesor !

Përveç ekosistemit qe ndryshon, asgjë tjetër nuk do ndryshoje mbase Muhurri do zhduket nga faqja e dheut e ca fshatra te tjera me fushore, mbase Brezhdani do jete ne mjegull 6 muaj te vitit por fundja le te ndodhi dhe kjo.

Unë e di se Dibrën e do shume se s'ka se si te mos e doje nje fotoreporter ku i ruan kujtimet e saj ne foto si gjene me te vyer.

Dibra i dashur Profesor ka ndryshuar shume ka koha qe ti e fotografoje, kur ne bujqësi aso kohe zbatoheshin zhvillimet teknologjike dhe shkenca e institutit bujqësor.

Sot ajo vuan dhe me sa duket do te vuaje e lëngojë gjate nga ky realitet.

Pyeti njëherë banoret e zonave malore çdo te te thonë, se si e përjetojnë ankthin e dimrit?!

Nëse ka ndonjë emergjence nga zonat malore gjate dimrit do te jete jetëgjate te i sëmuri nese arrin te Shkoje ne Peshkopi për ndihmën e pare!

Dibrën dhe une e dua por mbase me nje menyre tjeter, ndoshta e dua me fatalizëm por them se do te përmirësohet me shume ne këndvështrimin tim!

Ju e keni dashur Dibren se e keni fotgrafuar ne kohen kur blici ishte nje mekanizemi rralle ne duart e Dibrat dhe e keni dashur shume biles se e keni ruajtur ne arkiv.

Besoj se do ta duash me shume duke e lene te zhvillohet me HECE dhe projekte tjera por do ta duash shume me shume nese do te sjellesh ide te reja nga atje ku ti Jeton qe ti furnizosh intelektualet dibrane (nese ata do mblidhen per te mbrojtur Dibrën nga Shitje per 5 leke nese do ti behet nese do te ndertohet HECI) me ide te novatore!

Nazmi Bitri: Duhet ngritur dhe ndalur kjo masakër e Dibrës. Te gjithë po e shesin token ame. Mos te behet Edi Rama i katërti qe shet trojet shqiptare pas dajës se Zogut, Zogut vet, Sali Rame Berishes qe shiti detin. Por populli do te ngrihet dhe do te dje te ju vere flaken maskarenjve

Thanas Llangozi: Mos shani dhe mallkoni kur një pune behet e mire për ndërtimin e vendit.

Abdurahim Ashiku: Thanas, korrigjoje pak fjalën. Bëhet fjalë për përmbytjen e 65 kilometrave katrorë tokë të fushës më të madhe në Luginën e Drinit të Zi, fusha e dytë nga madhësia sa edhe Fusha e Korçës dhe për shpërnguljen e 40 mijë banorëve. Kjo punë nuk bëhet e mirë për ndërtimin e vendit por për shkatërrimin e një treve historike që ka përballuar 18 nga 25 betejat fitimtare të Skënderbeut dhe pasurimin e kapitalistëve të rinj shqiptarë e botëror. Kësaj në Dibër i thonë "Mos pre mbi kalli" i nderuar.

Perparim Markja: Përshëndetje Abdurahim. Pas digave fshihen frikshëm interesa te kompanive dhe njerëz te fuqishëm ne bote, (fitime marramendëse) bëhen pazare te renda qe vetëm nje mosbindje civile e madhe nuk di ne mund ti ndaloje....

Ju përshëndes te gjithëve per shqetësimin.

Xhevat Bushi: Ju qe mendoni për "DIBREN" jeni shërbëtore te komunizmit. Ju e harroni historinë e Dibres para interesit. Lumi Drin përshkon shume vende,por ne Dibër eshte shkruajtur historia. Mendojeni Dibrën me liqenin ne mes?Gjysma e Dibrës do quhen maqedonas, e gjysma tjetër do quhen matjane. Prandaj te gjithë bashke duhet ti themi jo digës. Dhe një jo te forte dëshirave te shfrenuara te zotit Rama. Boll,-nuk mjaftojnë tere këta hidrocentrale mbi lumin Drin, nuk mjafton gjithë kjo energji qe prodhon ky lum, apo duhet te shpërngulen edhe mijëra familje te tjera dhe te ngelen ne qiell te hapur,se e pame si i dëmshpërbleu edhe diktatori Hoxha. Jo kaskades....



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

peticioni

Shënim i redaksisë: *Peticioni i botuar mban nënshkrimet disa banorëve te fshatit Çidhën, me firmë e kartë identiteti, si dhe disa foto nga luginës. Për arsye vendi në gazetë nuk po i botojmë, por ne mbetemi të hapur për të botuar në numrat e ardhshëm çdo opinion tjetër që bie në kundërshtim me këtë peticion ose opinione të reja që e kundërshtojnë apo miratojnë ndërtimin e këtij hidrocentrali.*

Të ndërpriten punimet në HEC Seta 4

Banorët: Dëgjesat publike nuk janë realizuar. Verifikoni dokumentacionin. Firmat e fshatarëve që janë përdorur për të marrë lejen janë të manipuluar. HEC dëmton Kanionet e Setës të cilat janë shpallur monumente kulture. Dëmton të ardhmen, investimet në turizëm, biodiversitetin dhe rrit mundësinë e konflikteve mes banorëve.

DREJTUAR:
- **Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë**
- **Z. Damian Gjiknuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë**
- **Znj. Milva Ekonomi, Ministër i Ekonomisë**
- **Z. Dritan Demiraj, Ministër i Punëve të Brendshme**
- **Për dijeni dhe mbështetje: Z. Donald Lu, Ambasada e SHBA në Tiranë**

Lënda: Të ndërpriten punimet në HEC Seta 4

Zotërinj të nderuar,

Banorët e fshatit Cidhën e Poshtme në rrethin e Dibrës janë tej mase të shqetësuar nga punimet që po kryen firma "Hydro Seta shpk" në burimet ujore të Setës në krahinën tonë.

Punimet kalojnë nëpër pronat tona, pa biseduar më parë me banorët që preken drejtpërdrejtë nga investimi, pa dakortësinë tonë dhe në shpërfillje totale të peticionit drejtuar institucioneve në fazën e miratimit të projektit, kontestimeve të vazhdueshme nga "Shoqata Çidhna dhe Kastriotët", protestave e kundërshtimeve tona.

Pavarësisht interesimeve tona të vazhdueshme, jemi njohur zyrtarisht me projektin më datë 14.07.2017.

Sipas projektit synohet që i gjithë shtrati i Lumit Seta, bashkë me burimet, do të futen ne tubacione çeliku nën presion në tokë me gjatësi rreth 3 km, nga të cilat 1 km. tunel.

Soponika, Klloxhnesha, Resna, Rasatasi etj., janë ujëra të kristaltë dhe të pijshëm me raporte e analiza. Si mundet dhe me çfarë ligji lejohet përdorimi i burimeve të ujit të pijshëm për prodhim energjie, midis tyre Gryka e Ngushtë e SETES me kanionin e saj, bashkë me burimin dhe Shpellën e Ujëvarën e Saponikës, me VKM. 676 Datë 20.12.2002, janë të shpallura Monumente Natyre të Mbrojtura me numër rendor 10 dhe 3 në listën për rrethin e Dibrës.

Ky investim gjithashtu bie ndesh me Ligjin nr.10 dt.9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 3, Neni 4, Nenin 10 e Nenin 13". Prandaj, me Vendimin e Komisionit të shqyrtymit të Aplikimeve, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nr.17 dt.22.04.2015, ndërtimi i HEC Seta 4, Arras, Dibër është REFUZUAR, e me pas përsëri është lejuar.

Çfarë dëmesh i sillen këtij komuniteti?

1. Dëmtohet rëndë Turizmi malor për të sotmen dhe të ardhmen, duke qenë se prishën burimet natyrore në relievin interesant, me kanione që vende-vende zbresin thikë në shtratin e Setës, në korridoret e ngurta dhe të ngushta në zigzaket e tyre, me 4 burime si Saponika bashkë me shpellën dhe ujvarën 60-70m, Resna, Klloxhnesha e burime të tjera, në të cilat bëhet rrahja e peshkut troftë në periudhën nëntor-dhjetor.

2. Theksojmë se në luginë ndodhen Mullinjet e Blojës që kanë qenë edhe mullinjet e luftrave, të cilët kanë bërë të mundur vazhdimin e jetës për gratë, fëmijët e pleqtë në strehimin natyror si dhe rreth 17 shpella historike e misterioze, disa prej tyre vendbanime të lashta me vazhdimësi të pandërprerë të jetës në shekuj, të studiuara pjesërisht nga një Ekspeditë Spaleologjike Bullgare për dy javë në Gusht të vitit 2015, nga një grup prej 30 pedagogësh dhe studentësh Spaleolog, të cilët na kanë përcjellë në internet pamje e foto mahnitëse.

3. Ujrat e kristalta, bukuritë e rralla, sasia e madhe e oksigjenit dhe freskia e ambjentit, i japin këtij vendi vlera të jashtëzakonshme në fushën e turizmit malor. E themi me bindje se ky territor është një nga vendet më të bukura në tërë rajonet Shqiptare, sidomos për ekstremet e natyrës dhe Turizmin e Egër.



Këtu, në dalje te burimi i kësaj ujëvare fantastike, duan të sjellin tubat për burgosjen e kësaj perle "Monument Natyre" që mbrohet me ligj, duke shkatërruar të ardhmen turistike të këtij vendi kaq të bukur. Po burgosen 4 burime të tilla të Setës nga një HEC, energjinë e të cilit mund ta prodhojnëe me një digë fare të ngushtë te Kepi i Qytetit që të kultivohet edhe trofta. Foto dhe teksti marrë nga www.facebook.com/murat.koltraka. Në foto: Mustafa Tola dhe Murat Koltraka, dy nga kundërshtarët e ndërtimeve të HEC mbi Setë.

Ndërtimi i HEC SETA 4, e kthen këtë vend në shkretëtirë, duke rritur temperaturat në periudhën e vjeshtës dhe të pranverës, dhe ulur ato në -20 gradë në periudhën e dimrit.

Futja në tubacione e mbi 85% të sasisë së ujit të lumit, asgjëson florën dhe faunën e këtij territori, sidomos ndërpret plotësisht ciklin biologjik të troftës, e cila vjen nga Ohri dhe Fierza në nëntor të çdo viti për të bërë rrahjen.

- Për punimet që kryhen nuk është marrë fare pëlqimi ynë,

- Diskutimi 20 minutësh që pretendohet se është bërë me publikun, ka qenë një dështim i plotë i atij takimi, dhe jo me banorët që preken drejtpërdrejtë nga ky investim.

Ne nuk jemi refugjatë e as nuk e kemi marrë këtë vend me qera, por jemi autoktonë ne trojet e pronat tona, trashëgimtar historik prej shekujsh.

Shteti nuk gjendet në territorin tonë as në shekullin e 21.

Territori kalohet nga Arrasi në drejtim të Lurës, nga një rrugë e pa asfaltuar e vitit 1967, krejt e degraduar në të cilën akoma vazhdohet të mos vihet dorë për ta rregulluar. Ne pronat i kemi të trashëguara, të ndara me kufij të vjetër në të gjithë territorin e fshatit, tokat, pyjet, kullotat , lumin SETA , burimet ujore, shkëmb apo zall qoftë vendi, me kufijtë e vjetër para qindra vjetësh.

Jeta në këtë territor ka vazhduar pa ndërprerje në të gjitha periudhat historike. Këtu ka qenë qyteti i lashtë Ilir OENEA. Në anë të luginës në fshatin Sinë e Poshtme është Muzeu i vendlindjes së Kastriotëve.

Lugina e SETES bashkë me grykën e Sheut të Thatë, kanë qenë vendstrehim natyror i brezave në shekuj. Në këtë teritor të p pushtueshëm, kanë patur zanafillën rezistenca e vendosur dhe shumica e luftrave, të krahinës se Çidhnës dhe të gjithë Dibrës.

Këtu u krye dhe masakra e Çidhnës e vitit 1466 nga Sulltan Mehmeti II, i cili sipas Barletit, shkoi në thikë 8-10 mijë burra, veç grave dhe fëmijëve, për hakmarrje në vendlindjen e Skëndërbeut. Këtu, gjithashtu, në një kodrinë në afërsi të Soponikës ndodhet edhe toponimi interesant "Varret e Mehmetit".

Po këtu filloi, sipas Prof. Kristo Frashëri, edhe kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 kundër Turqve në datat 26 dhe 27 mars, e cila 3 muaj më pas u përhap në Kosovë.

Lugina e Setës, pjesa e ngushtë dhe e thellë e saj, fillon në Kalanë e Lashtë Ilire, pranë Kepit të Qytetit dhe vazhdon deri në kalanë e Kastritotëve në Qafe Kala, e jo në vendin që pretendon firma , sipas dëshirës së njërit prej Investitorëve, i cili ka fshehur shumë të vërteta të zonës, për ta patur të lehtë miratimin e investimit për HEC SETA 4 nga KKRT. Pikërisht për këtë, pjesa e ngushte e kanionit, meqënëse është e pakalueshme nga mjetet, është planifikuar në projekt që të ndërtohet me Tunel rreth 1 km.

Konstatojmë me keqardhje se në vendimi KKRT nr. 10, datë 09.09.2015, në faqen 7 pika 3.3 shkruhet: ... "Seta 4 nuk shtrihet në zona të mbrojtura" , pra në kundërshtim të plotë me vendimin e mëparshëm të KM. nr.676 dt.20.12.2002, që shpall Luginën e Setës dhe Shpellën e Ujvarën e Soponikës, Monumente Natyre të mbrojtura.

Ndërsa në vendimin nr. 26, datë 05.03.2015 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë thuhet: ... nuk është idenfikuar si zonë Arkeologjike me trashëgimi Kulturore apo Historike. Kur këmbë arkeologu nuk ka shkelur për të parë qeramikën e shumëllojshme deri te amforat ilire, apo kalatë ilire e ato të Kastriotëve që ndodhen në luginën e SETES.

Si mundet që një Institucioni kaq të lart të Shtetit Shqiptarë si KKRT, ti vihen në tryezë për firmë, materiale të manipuluara deri në këtë shkalle?

Ne nuk besojmë se punonjësit e ngarkuar për përgatitjen e dokumentacionit përkatës janë vërtet kaq të paditur dhe se ju mungon informacioni.

Këto nuk janë gabime njerëzore, por veprime të qëllimshme manipulative, që KKRT e Republikës ta ketë të lehtë të pranojë dhe të firmosi Investimin për HEC SETA 4.

Dërgoni ju lutemi njerëzit e duhur dhe kompetent për verifikimin e këtyre të dhënave në terren, dhe të ballafaqohen publikisht me ne.

Shpresojmë se me dëgjesat me publikun , do ti jepni një dimension të ri Qeverisjes suaj z. Rama, duke shkundur pluhurin dhe mykun e zyrave të administratës së korruptuar e larguar prej tyre qelbin e korrupsionit.

Kjo vepër është shkatërrimtare e mjedisit të zonës. Ajo dëmton rëndë turizmin malor e historik në luginën e Setës, e cila të çon tek parku Kombëtar dhe Liqenjtë e Lurës , ku SETA ka zanafillën e sajë. Një pjesë e inerteve të dala nga punimet përgatitore është hedhur tek "Kepi i Qytetit" duke mbuluar e prishur një vend shumë të rëndësishëm historik, megjithëse një grup arkeologësh të një firme të liçensuar, të thirrur nga vetë banorët për të kryer një vëzhgim arkeologjik në zonë, bënë thirrje të ruhen dhe të mos cenohen këto pasuri e vlera të mëdha historike e Kombëtare.

Alternativa të tjera nuk janë diskutuar me komunitetin dhe grupet e interesit, por janë anashkaluar padrejtësisht.

Banorët e fshatit shumë të irrituar kanë pezulluar me rezistencën dhe qëndresën e tyre punimet. Ata janë gati të shkojnë në konflikt me cilindo që varros SETEN në të tërë gjatësinë e luginës, që përshkon territorin e fshatit Çidhën, dhe shpërfill të drejtat e tyre për të qenë pjesë në vendimmarrje. Në qoftëse do të vazhdohet me presionin, thirrjet në polici për kështillime dhe kërcënime për ndjekje penale, apo ndalime të tjera nga organet e rendit për banorët si deri tani, situata vetëm do të përkeqësohet. Rezistenca e qëndresa jonë, e cila ka filluar me protestat në datë 6 maj 2017, ka vazhduar dhe do të vazhdoje pa ndërprerje, me forma e mjete të ndryshme dhe nëse na imponohet, do shkohet deri në mosbindje civile, për ta mbrojtur UJIN e Setës që është JETA dhe e ardhmja jonë.

Sipas psikologjisë së banorit të këtij fshati, kur i lëvizet kufiri qoftë dhe me 50 cm, nuk tolerohet as vëllai, prandaj mundësia e një përplasje të egër dhe me pasoja shumë të rënda mendojmë se është e pashmangshme, po vazhduan punimet me shpërfillje e provokim.

Investitori bashkë me Qeverinë duhet të heqin dorë nga ky projekt që VARROS SETEN, me të cilin komuniteti që preket drejtpërdrejte, nuk mund të bjerë kurrësesi dakord, dhe të shohin mundësinë e investimeve të tjera, për ujin e pijshëm dhe për turizmin në zonën tonë.

Së shpejti do të ngrihet padi në gjykatë, megjithëse nuk kemi fare besim te drejtësia shqiptare. Qoftë edhe formalisht , ne do t'i kalojmë të gjitha shkallët e gjyqësorit, deri sa të shkojmë në Gjykatën e Strasburgut, në të cilën shpresojmë, se do jemi të barabartë me shtetin dhe pasanikët e rinj të këtij vendi.

Për të mos u ndodhur para faktit të kryer, kërkojmë ndërprerjen e menjëhershme të të gjitha punimeve deri në përfundimin e gjithë procesit gjyqësor në gjykatën ndërkombëtare.

Kërkojmë gjithashtu ndërhyrjen tuaj me një ekip të specializuar dhe të paanshëm, sa më shpejtë të jetë e mundur, pa na ndodhur ndonjë fatkeqësi, të diskutojnë me ne për t'i dhënë një zgjidhje problemit me interes të dyanshëm.

Shpresojmë në mirëkuptimin me ju.

Rruga e Arbërit nr. 135

reportazh



Kjo është një rrugë, e cila përveç banorëve të Staravecit lidh me qytetin fshatrat Shimcan, Bahute, Zimur si dhe për bjeshkët fantastike të Gramës, të cilat i shoqëron një bukuri e pashoqë

Staravec, rruga po rikthen besimin te investimet

Tre vëllezërit Nikolli: Hajrullai, Arturi dhe Dylberi, që të tre me arsim të lartë, e kanë biznesin e përbashkët. Asgjë nuk bëjnë pa u konsultuar e biseduar me njëri-tjetrin. Shumë gjëra kanë arritur deri tani, por akoma shumë projekte shfaqen në horizont.

Nga **OSMAN XHILI**

Katërqind vjet me parë, Nikollët e ardhur nga Lura, kaluan në Luzni, në Katundin e Ri dhe vendosën të ndalojnë lëvizjen e mëtejshme. Nuk kishin përse të shkojnë më tej, kishin gjetur gjithçka që u duhej, gjithçka që kishin ëndërruar. Këtu kishin ujin, lumin e Drinit, për vaditje, por dhe për tu larë. Kishin malet e kodrat për mbrojtje, për drunj zjarri e plot funksione të tjera. Kishin dhe fushën aq të bollshme dhe të begatë, saqë do të mjaftonte dhe pas qindra vjetësh, kur Nikollët do të bëheshin një fis dhe një fshat i tërë. Nuk u mbetej tjetër, vetëm se të ngrinin këtu strehën e tyre të re dhe të vazhdonin rrugëtimin nëpër historinë e kohës. Një histori që do të kishte dy anët e medaljes, lavdi dhe nder, pozitë të lartë në konaqet dhe odat e dikurshme të burrave. Jo rrallë historia kaloi mes varfërisë e mjerimit, mes zisë së bukës, grindjeve dhe hasmërive. Në të gjitha këto dallgë e trazira të jetës, trungu i fisit Nikolli goditej e lëndohej, por prapë bëhej i fortë dhe fitonte imunitet për tu përballur me sprova e vështirësi të reja.

Shumë e shumë degë të shëndosha dolën nga ky trung. Pa dashur të nënvlerësojmë ndonjë prej tyre, ne po i referohemi vetëm njërit prej filizave të shumtë dhe pikërisht Hajrulla Nikollit e vëllezërve të tij, djemve të Gani Nikollit. Vitet nëntëdhjetë e gjetën Hajrullain në auditoret e fakultetit të veterinarisë. Kur gjithë shoqëria shqiptare ishte e dyzuar mes ideve të largimit nga vendi, apo qëndrimit aty dhe studenti i ri, me ëndrra për jetën, i mendoi këto dy varjante. I peshoi me detaje me të mirat e të këqijat e tyre. Bashkë me studentin tjetër, shokun e tij, Fitimin, u endën përballë ambasadave, në ato ditë të para të korrikut.

- Po, ja ikëm, - tha Fitimi. Çfarë pasojash do të ketë familja? Po Xhelalin, vëllain që kam ushtarak, me siguri që do të ma largojnë nga ushtria! Do të më mallkojë përjetë që u bëra sebep për t'i shkatërruar karrierën. Kështu, dy të rinjtë zemërthyer, u kthyen andej nga kishin ardhur, duke parë skenat e nxehta të atyre ditëve të nxehta korriku. Po kaq të vështirë e patën për të vendosur dhe kohë më vonë në ikjen masive, por këtë radhë nga deti. U sollën për orë të tëra tek anija që mbante emrin "Partizani". Vëzhgonin njerëz të moshave të ndryshme që kapeshin e mbërtheheshin në konstruktet metalike të anijes, në litarët e saj, në një ikje që e mendonin pa kthim. Sërish, për njëmijë e një arsye ata vendosën të mos iknin. Ndoshta dhe fakulteti që do të mbetej përgjysmë, ishte një nga shkaqet kryesore. U kthyen sërish në auditore për të vazhduar studimet e pak kohë më vonë morën diplomat e nderuara të mjekut veteriner.

Vite më vonë, mjeku i ri do të endej në zonën e tij të Luznisë dhe të Selishtës, herë si operator privat e herë si inspektor i zonës për sëmundje të ndryshme veterinare. Do të bënte vaksinime, gjurmime të tuberkulozit e brucelozës. Do të njihej me gjendjen e blektorisë, do të shihte bujarinë e mikpritjen e atyre banorëve, që përpiqeshin të fshihnin e të sfidonin varfërinë. Po vinte fundi i mijëvjecarit të dytë dhe po hynte i treti. Hajrullai po përtypte ëndrrën e vjetër. Shikimi i tij tretej brigjeve të Italisë. Një ditë shtatori i tha lamtumirë familjes, Luznisë, atdheut, por jo përgjithmonë.

Nga **SAMET ZAGRADI**

Ne jetojmë në një vende që duhet punuar me të vërtetë fort për të plotësuar minimumin e kërkesave bazë të jetesës. Jemi të vetëdijshëm për problemet të cilat pengojnë fuqishëm zhvillimin e zonës dhe e dimë mjaftë mirë ç'farë na nevojitet për të sheshuar disi këto probleme. Dibra do ishte ndryshe në qoftë se do kishte një infrastrukturë më të zhvilluar rrugore dhe zhvillimi i saj do shumëfishohej në qoftë se "Rruga e Arbërit" do ishte ndërtuar. Por jo vetëm Dibra në përgjithësi, por edhe zonat brenda saj kanë probleme serioze në urbanistikë dhe në sistemet rrugore. Rruga është një nga faktorët kryesorë për zhvillimin e çdo zone apo krahine.

Prej vitesh fshati Staravec është përballur me vështirësinë e transportit rrugor për arsye se rruga prej 1.5 km nuk ishte aspak e përshtatshme për të mos thënë totalisht e amortizuar duke penguar ndjeshëm qarkullimin dhe zhvillimin e kësaj zone kaq pranë qytetit. Kjo është një rrugë, e cila përveç banorëve të Staravecit lidh me qytetin fshatrat Shimcan, Bahute, Zimur si dhe për bjeshkët fantastike të Gramës, të cilat i shoqëron një bukuri e pashoqë. Rruga kalon përmes lagjes së Kamenit, më pas në Cipure, kalon përbri lagjes së Lusheve dhe maloreje pas maloreve ngjitesh në zonat e "4 copë katundeve" siç quhet në mënyrë popullore nga banorët e zonës. Për vite me radhë ky aks rrugor është bërë pengese e zhvillimit ekonomik të kësaj zone, sepse siç dihet, zhvillimi i çdo vendi suksesin e ka tek rruga. Rruga, është një faktor kryesor lëvizjes së popullsisë nga fshatrat drejt zonave urbane. Mungesa e shërbimeve bazë detyron këto banorë të migrojnë gjithmonë e më larg zonës. Pothuajse në çdo vit elektoral, si në zgjedhje vendore apo lokale pika mbështetëse e fushatës në këtë zonë ka qenë rehabilitimi i rrugës. Pavarësisht faktit që ky aks rrugor në kilometra dhe në pamje të parë duket i pa përfillshëm gjendja për vite të tëra sa vjen edhe rëndohej.

"I lejmë makinat në lagjen e Kamenit (në gjysmë të rrugës)", shprehen banorët duke qenë që rruga është e asfaltuar deri aty. Në rast se kemi emergjenca shëndetësore detyrohemi të lëvizim me makina të mëdha apo në raste të veçanta në këmbë duke qenë se rruga është e papërshtatshme. Në jetën e përditshme këto banorë zakonisht lëvizin me mjete publike si janë fugonët. Shoferët e linjave të fshatrave të sipërpërmenduara theksojnë që kostoja e mirëmbatjes së mjetit me këtë rrugë është e papërballueshme.

"Kam ndërruar 4 furgonë për periudhën e 4 viteve", tregon një nga shoferët e linjës. "Çdo 2 ose 3 javë", shton ai, mjeti duhet të çohet tek mekaniku pasuar kjo më një kosto thuajse të papërballueshme. Këtu nuk ka vënë dorë askush, pëveç 2-3 makina zhavorr çdo vit zgjedhor".

I revoltuar, një 70 vjeçar, tregon se si çdo vit gënjehen banorët. Të revoltuar shprehen edhe pronarët e disa minifermave që kanë aktivitetin e tyre në fshat por e kanë pothuajse të pamundur transportimin e mishit, bulmetrave, qumështit apo çdo produkti në tregun kaq pranë dhe kaq larg duarve të tyre.

Por pas shumë premtimeve dhe tentativave të shkuara dëm për investime në këtë fshat , këtë muaj duket se qeveria lëshoi dorën për këto banorë duke akorduar një fond prej rreth 40 milionë lekë për zgjerimin dhe asfaltimin e kësaj rruge. Për hartimin e projektit dhe marrjen e fondit për ndërtimin e kësaj rruge u angazhuan shumë aktorë, pjesëtarë të komunitetit që ngulmuan fort duke lobuar fuqishëm për të bërë të mundur një vepër që për vite me radhë nuk u arritur. Pas shumë përpjekjeve u sigurua fondi për hartimin dhe zbatimin e projektit të rrugës "Staravec- Shimcan- Zimur". Projekti konsiston në zgjerimin dhe asfaltimin e aksit rrugor Peshkopi-Staravec 1.5 km dhe rehabilitimi i aksit tjetër të mbetur deri në fshatin Zimur. Ky projekt i mbështetur nga bashkia Dibër ju besua një kompanie ndërtimi me peshë në qytetin e Peshkopisë. Kompania e ndërtimit "Selami shpk" filloi punën menjëherë pas mbarimit të dy akseve të tjera si ajo e Dovolanit dhe ajo e Herbelit. Rruga e ndërtuar sipas inxhinierëve dhe mbykqyrësve të punimeve i përket standarteve optimal, rreth 4 metër e gjerë, gjë e cila e bën të mundur qarkullimi i lirshëm dhe komod për një kohë mjaftë të shkurtër.

Tashmë banorët ndihen shumë të kënaqur për vetë faktin se më në fund diçka në të mirë të tyre ndryshoi duke krijuar më shumë benefite dhe lehtësi për to dhe jo vetëm. Ato shprehen se kanë vite që e presin që ky investim të bëhej madje ishin të gatshëm që të bashkëpunonin me të gjithë aktorët që bënë të mundur që ky investim të bëhej. Disa prej tyre vazhdojnë të bashkëpunojnë duke zhvendosur mbrojtëset e pronave të tyre në mënyrë që rruga të ishte e disa standardeve kryesore që projektuesit e projektit vendosën. Pjesa më e madhe e aksit Peshkopi- Staravec duket se ka përfunduar gjë e cila ndjehet shumë në shtimin e qarkullimit të mjeteve të tonazheve të ndryshme. Kudo flitet për rrugën dhe normalisht qe ka dhe skeptikë mbështetur në mendime personale apo interesa personal.

R.Trupja, banor i këtij fshati, flet për gazetën "Rruga e Arbërit" duke cituar se nuk intereson asnjë parti, apo kush insistoi të bëjë këtë investim. Mua dhe bashkëfshatarët e mi na intereson që kjo rrugë hapi siparin e investimeve dhe zhvillimit. Fshati jonë ka shumë nevojë për ndërtimin dhe sistemimin e kanaleve të zeza dhe shpresoj që pas rrugës të vijë dhe radha e ndërtimit të tyre. Do na ndihmonte mjaftë, shton ai, duke falenderuar personat që bënë të mundur këtë investim.

Falenderues, entziastë dhe të liruar nga një barrë e rëndë janë fermerët dhe bujqit, të cilët shpresojnë të shtojnë aktivitetin e tyre. Rregullimi i rrugës do tu jepte mundësinë për të qenë më afër tregut të cilin do shisnin produktet e tyre bio që rralle i gjen në tregjet e mëdha. Një nga blegtorët më të vjetër të zonës me rehabilitimin e sistemit rrugor mendon të investojë vërtetë dukë planifikuar ndërtimin e një baxhe për përpunimin e qumështit e më pas tregtimin e tij si një produkt 100% bio dhe po kaq perqind të shëndetshëm për konsumatorin Dibran dhe jo vetëm.

Ky investim mjaftë me vlerë u jep mundësi banorëve të larguar në zonat urbane të këtyre fshatrave të kthehen me investime në pronat e tyre. Ndërtimin dhe rikonstruktimin e shtëpive të braktisuara dhe shumë benefite të tjera kjo zonë do të ketë përfitojë gjatë kohës që vjen. Bjeshkët e Gramës në qoftëse ky projekt do realizohej 100% do ishin një atraksion dhe një pikë mjaftë e vlefshme për zhvillimin turistik të kësaj zone. Bukuritë e atyre bjeshkëve kanë mbetur të izoluara për shkak të një rruge aspak të përshtatshme deri në destinacion. Por duhet thënë që ndërtimi i rrugës ka zgjidhur shumë halle të këtyre njerëze. Kjo zonë ka nevojë për shumë investime të cilat disa prej tyre janë emergjente po ashtu sa vetë rruga. Kanalizimet e ujërave të zeza, furnizimi me ujë të pijshëm dhe me atë vaditës mbeten me të vërtetë problem që duhet të zgjidhet. Rruga ishte një nga qindra halle që këto banorë kanë mbajnë mbi kurriz këto njerëz.

Na mbetet të jemi me shpresën që të kemi zgjedhje çdo vit apo çdo 6 muaj duke shpresuar që të bëhet diçka për vendin dhe komunitetin. Komuniteti jonë ka nevojë për çdo lloj investimi, qoftë i vogël i mesëm apo investim i madh. Të gjithë jemi pjesë e një situate jo aq të kënaqshme dhe që kërkon shumë vëmendje të çdo lloj pushteti apo organizimi. Na mbetet te shpresojmë që ditë të mira do të vijnë, do punojmë pak më shumë e do përpiqemi te vjedhim apo mashtrojmë pak më pak.

profil

Filizat e fisit Nikolli


Paulonia

EMIGRIMI

Dymbëdhjetë vite zgjati aktiviteti në vendin fqinj, bashkë me dy vëllezërit, Dylberin dhe Arturin. Fillimi i vështirë si zakonisht, pa letra, pa gjuhë, pa përkrahje, vetëm me shpresën te Zoti. Nga do t'ia nisnin? Dhe pse nuk kishin ndonjë eksperiencë të madhe në ndërtimtari, dukej sikur ky sektor kishte mundësi më të mëdha. Pas një viti ishin paisur me letra, kishin mësuar dhe gjuhën e shpresat ishin rritur. Vëllai vazhdonte të punonte për një firmë italiane, kurse Hajrullai guxoi më tepër. Përse të punonte për italianin e të mos dilte si firmë më vete. Pati pak kundërshti mes vëllezërve e së fundi Hajrullai realizoi idenë e tij. E kishte vendosur, do të dilte i vetëm. Publikoi firmën e tij të re, shkroi emaile, bëri çfarë ishte e mundur, por më kot. Tre muaj përpjekje, tre muaj shpenzime, pa asnjë përfitim. Tamam atëherë, kur u duk se kishte bërë hapin e gabuar, ndodhi një mrekulli. Teksa ecte i pashpresë nëpër rrugët e Savonës, pranë zyrave të Guardia di Financës, sytë i kapën një send të rënë përtokë, që nuk ishte as më pak e as më shumë, por një portofol. Vetë portofoli i fryrë pasqyronte njeriun e kamur të cilit i përkiste. Hajrullai e hapi. 890 euro, patenta, kodi fiskal, kartëvizitat, telefonat, si dhe një bllok pagesash. Nuk ishte vështirë të lexoje emrin Mauricio në kartvizitat brenda portofolit. Hajrullai me sendin e gjetur në duar u ul për një moment, ta mendonte më qetë situatën. Po të mos llogarisje gjë tjetër, tani zotëronte afër 900 euro dhe ky mund të ishte një përmirësim i vogël i gjendjes financiare. Të paktën për pak kohë, për pak javë. Mjaftonte të ikte diku, larg që këtu. Por ndërgjegja, edukata, gjaku i fisit Nikolli, por dhe ajo krenari e nëpërkëmbur shqiptare, veç e veç e të gjitha sëbashku i thanë jo, nuk duhej ta merrte. Ti telefononte sa më shpejt Mauricios e ti jepte sendin e humbur. Nëse Hajrullai fitonte 900 euro, i huaji humbiste shumë më tepër. Nuk vonoi shumë për të çuar në vend zërin e ndërgjegjes. I dërgoi zile, por telefoni nuk hapej. Më pas u hap por nuk përgjigjej njeri. Bile Hajrullai dëgjonte nga telefoni tjetër zëra që grindeshin. Mauricio instiktivisht kishte shkelur butonin dhe ndërkohë grindej me zyrtarët e Guarda di Financës, të cilët i akuzonte pikërisht për fshehjen e portofolit të tij. Më pas pyeti si i bezdisur se kush ishte.

- Jam personi që ka gjetur portofolin tënd dhe jam gati ta kthej. Më gjen tek Autosole, përballë dyqanit. Nuk vonoi shumë dhe u


Aronia


Me Kristianin dhe Robertën duke verifikuar terrenin. (Foto: Familja Nikolli)

duk makina e sipërmarrësit italian dhe më pas dhe ai vetë. U përshëndetën dhe habia më e madhe e Mauricios ishte, kur mori vesh se njeriu që i ktheu portofolin, ishte shqiptar.

"Nuk do ta besoja, po të ma thoshte dikush, ishte shprehu ai. – Kisha dëgjuar vetëm për anën kriminale të shqiptarëve dhe tani po shoh dhe një anë tjetër tuajën, të bukur e miqësore. Të lumtë miku im! Ke nderuar veten, por dhe kombin tënd. – Merri paratë, janë të tuat dhe i zgjati 900 eurot, po Hajrullai i refuzoi, pa e fyer tjetrin. – Të falenderoj dhe unë nga ana ime, për bujarinë që po tregon, por nuk i pranoj. Ne në anët tona themi, më mirë një mik se një çiflik kështu që unë po ju ftoj juve të jeni miku im i ri. Mauricio mbeti i habitur nga djaloshi i zgjuar dhe i ndershëm. I zgjati dorën dhe i tha se ata tani ata ishin me të vërtetë miq. Kur Mauricio e pyeti, Hajrullai i tregoi për firmën e re që nuk punonte akoma, për pozitën e dobët financiare e të tjera si këto. Po, italiani mund ta ndihmonte. Ai kishte kontrata ndërtimi që nga Roma deri në kufi me Francën, rikonstruksione shtëpishë, vilash, zyrash e të tjera si këto. Mund ti jepte disa punime të vogla mikut të tij të ri, në kompesim të nderit të bërë.

Shumë shpejt firma e re e Hajrullait hodhi hapat e para. Në fillim me tre vetë e më pas duke u shtuar, deri në 15 specialistë, që të gjithë me kualifikime maksimale. Punët që kryente firma e re ishin vërtet cilësore, por dhe pagesa e Mauricios ishte gjithmonë në kohë dhe me korrektesë. Shumë shpejt erdhi çeku i parë, 21 mijë euro. Më pas, çdo muaj një shumë e tillë, një sukses i ri. Hajrullai fluturonte nga gëzimi. Bota sikur kishte hapur portat e lumturisë dhe ai po hynte brenda tyre. Të gjitha këto u kurorëzuan në vitin 2005, me lindjen e djalit të parë dhe të vetëm, Engjëllit. Vetëm pak ditë më vonë u nënshkrua një marrëveshje mbi 200 mijë euroshe, si bekim i Zotit për djalin e posalindur.

INVESTIMET E PARA

Doktor Hajrullai e dinte misionin e tij. Nuk kishte shkuar për turizëm në vendin fqinj. Kishte fituar gjuhën, letrat italiane. Kishte fituar eksperiencën, duke u ngjitur nga punëtor i thjeshtë, në gradat më të larta të kualifikimit. Kishte ngritur nga hiçi një ndërmarrje të vogël dhe po e fuqizonte atë vazhdimisht. Ai besonte se kishte ardhur koha për investimet e para. Bleu tre apartamente të lodhura nga përdorimi dhe në pak kohë i rregulloi dhe sistemoi, aq sa nuk njiheshin më. I shiti me çmime të leverdisshme, duke e parë këtë si një biznes interesant. Në vitin 2011 mendon që të investojë diçka dhe në Shqipëri. Kishte idenë për një qendër të madhe estetike dhe fizioterapie në Tiranë, por kjo nuk funksionoi, pasi gjërat këtu nuk ishin si në Itali. Atëherë vendosi të provonte të bënte diçka tjetër në Peshkopi, në vendlindjen e tij. Shumë shpejt, diku në qendër të Peshkopisë, pranë shkollës bujqësore, hedh shtat një ndërtesë gjashtë katshe shumë funksionale, që do të kushtonte mbi njëmilion euro. Pesë dhoma frigoriferike me nga 35 ton, secila, me komandim në vete. Kati i dytë është konceptuar si një qendër tregëtare dhe laborator dentar, ku punon vëllai i tij Arturi, bashkë me të shoqen. Në dy katet sipër janë 15 apartamente banimi për familjarë dhe për turizëm, kurse dy katet e fundit janë për tre vëllezërit Nikolli.

Ndërkohë sytë ishin hedhur dhe nga bujqësia. Ka pesë gjashtë vite, që bashkë me kushëririn e tij, Flamur Nikolli, kanë mbjellë tetë hektarë ara në fshatin e lindjes, në Katund të Ri. Ata kanë filluar të japin kokrrat e para. Pas një dhjetëvjeçari ato mund të prodhojnë diku te një kuintal secila, duke dhënë mbi 100 ton arra si total. Po ata e dinë që për të synuar këtë objektiv duhet punuar akoma më fort. Duhen bërë disa zëvendësime, punime rreth kurorës, plehërimi i tyre e rrethimi në disa vende. Kushëriri, Flamur Nikolli po punon fort me qershinë, duke e nisur me katër dynymë, para 12 vitesh e sot ka të mbjellë 15 dynymë. Nga prodhimi i shitur parvjet arriti të fitojë gati 20 milionë lekë, shifër kjo që mund të ngjitet akoma më shumë.

TË TJERA PROJEKTE

Tre vëllezërit Nikolli, Hajrullai, Arturi dhe Dylberi, që të tre me arsim të lartë, e kanë biznesin e përbashkët, por drejtues kanë doktor Hajrullain. Asgjë nuk bëjnë pa u konsultuar e biseduar me njëri-tjetrin. Shumë gjëra kanë arritur deri tani, por akoma shumë projekte shfaqen në horizont. Nuk di pse këto projekte u shëmbëllejnë me hijen e njeriut, kur ti kërkon ta kapësh atë, ajo sërish është larguar prej teje, në po atë distancë.

Në një vizitë pune që bëmë në Prizren, Hajrullai udhëtoi dhe disa orë të tjera, deri në komunën serbe Shtërpska, e shquar për kultivimin e bimës së Aronias. Atje bleu 11 rrënjë me nga pesë euro, kurse sot ka 82 të tilla, që janë në prodhim. Një pjesë e këtij prodhimi është kthyer në shurup dhe reçel, me të cilat gostiten miqtë e tyre të shumtë. Familja Nikolli ka rreth pesë dynymë mollë, që pak nga pak po e mbarojnë misionin. Vitin tjetër aty do të mbillen aroniet, duke jetuar disa vite sëbashku me mollët. Njëra palë duke u rritur, tjetra duke u mplakur, duke kursyer kështu pak kohë të çmuar.

Por kjo është vetëm maja e ajsbergut.

Hajrullai ka pesë vite që është larguar nga Italia, por vetëm fizikisht. Një pjesë të shpirtit e ka aty, një pjesë të pronave i ka atje dhe shumë shokë e miq të një niveli mjaft të lartë, me të cilët i ruan akoma lidhje. Këto lidhje dëshiron ti shfrytëzojë jo vetëm për vete e për familjen, por dhe për Dibrën e më gjerë akoma. Emilio Ahmati është njëri prej tyre. Ai është profesor i Paulonias në Itali. Ka laboratore në Itali dhe Bullgari që shërbejnë për prodhimin e klonuar të kësaj peme, me një cilësi dërrase shumë të mirë dhe mjaft të kërkuar nga tregu. Në ndihmë të profesorit janë djali i tij Kristian Ahmati me të shoqen, Roberta Zaninoni.

Firma e tyre e nderuar kultivon rreth gjashtë mijë hektarë me Paulonia në Itali dhe po përpiqet ti shtojë me njëmijë të tjera në Shqipëri. Hajrullai u ka sugjeruar brigjet e Drinit në Dibër, si mjaft të përshtatshme për këtë pemë te veçantë. Bashkëpunimi i bashkisë me firmat italiane të interesuara për këtë problem, do të bënte të mundur mbjelljen dhe kultivimin e të paktën 400 hektarëve me Paulonia në ultësirën e Drinit, që mbulohen nga dy bashkitë Bulqizë dhe Peshkopi. Impaktet dhe vlerat e këtij projekti gjigand do të ishin të shumta e të larmishme. Zona në fjalë do të kthehej në një kantjer për prodhimin e dërrasës, duke ulur ndjeshëm importin. Do të shmangeshin përmbytjet e do të punësoheshin fuqi punëtore. Por, fatkeqësisht, bashkitë, njerëzit, komuniteti, janë skeptikë, janë indiferentë, mos të themi më shumë se kaq.

Në këtë situatë, Hajrullai do që ti bindë njerëzit, jo vetëm me fjalë, por tashmë dhe me vepra konkrete. Pranë shtëpisë së vjetër, në Katund të ri, ka mbjellë para dy vitesh 27 rrënjë paulonia, që janë rritur mbi tetë metra. Këtë vit ka mbjellur shtatë dynymë me këtë lloj druri me kaq vlera, në tokën e tij në breg të Drinit. Kjo sipërfaqe do të shtohet çdo vit me nga një hektar, duke e çuar investimin katërvjeçar në njëzet mijë euro. Vetëm prerja e një hektari pas katër vitesh, do ta shlyente gjithë vlerën e këtij financimi. Ndoshta vetëm atëherë njerëzit do ti kuptojnë me të vërtetë vlerat e këtij projekti dhe të mendojnë se sa shumë kohë kanë humbur. Një pyll Pauloniash në breg të lumit Drin, do të ishte një atraksion i bukur turistik. Kafshë të ndryshme të buta dhe të egra në të , disa shtëpi druri, disa vaska peshku dhe natyrisht disa rreshta me koshere bletësh që do të shfrytëzonin lulet mjaltëse të kësaj peme dhe të bimësisë përreth.

Doktor Hajrullai ka njohje nga afër me kryetarin e komunës së Savonias, por dhe me drejtuesit e universitetit. Ka kohë që përpiqet të vejë në jetë një projekt të këtij universiteti, për njohjen e llojeve autoktone në Ballkan, ndihmesën për ti ruajtur e fuqizuar ato. Vlerat e kësaj pune do të ishin tepër të mëdha dhe për vendin tonë.

Ja të tilla projekte e të tjera si këto bluan në mendje miku ynë i nderuar, duke shërbyer si një ambasador i vogël i fisit Nikolli, por dhe i Dibrës e më gjerë akoma.

vëzhgim





Mes Beratit dhe Dibrës

Nga **ALBAN TUFA**

Berati kishte plot të rinj, dhe kështu edhe këtu unë gjithnjë i jap qasjen në mendim duke e krahasuar me vendin tim. Në Dibër të rinjtë ose ikin në kurbet pa mbaruar asnjë shkollë ose bëjnë një shkollë në Tiranë dhe të suksesshmit nuk kthehen më dhe kjo ndodh si mungesë e perspektivës e shpresave për një të ardhme ndryshe.

Në fund të korrikut patëm një ftesë për në Festivalin multikulturorë të Beratit, nga Biblioteka "Vexhi Buharaja", për të lexuar poezi në pedonalen e qytetit. E para gjë që më vjen në mendje në mënyrë komplet të pavetëdijshme më çon direkt në Dibër. Sikur ky lloj festivali të bëhej dhe në qyteti tim dhe unë të lexoja poezi mu në mes të bulevardit, para Pallatit të kulturës?!

U nisëm të gjithë anëtarët e Klubit të librit, Kamëz. Ora qe 10 e 5, dhe fiks në 11: 30 ishim në Berat, mu ballë një Terminali me kushte vërtet europiane, dhe më ngjante me një stacion treni në Cherebourg të Francës. Mu këtu, bindesh plotësisht se Dibra është e lënë komplet pas dore. E bëj këtë paralelizëm veç mbi bazën e asaj çka kam parë, dhe të njëjtën gjë mund të them edhe për qytet e tjera më të mëdha në jug.

Rruga për në Berat është e gjitha autostradë. Autobusi nuk ndjehet, dhe të bëhet sikur je në një divan, mu në mes të odës. I them shokut tim që e kam ngjit, i cili është nga Burreli:

-Shikoje ç'rrugë? A nuk jemi diskriminuar nga të gjitha qeveritë duke na lënë pas dore?

-Për rrugën?- më pyet.

-Po. I them.

-Ç'faj kanë qeveritë?- pyeti prap.

-Ja, këta mbajtëset prej hekuri anash: këtu është fushë dhe nuk mungojnë askund, ndërsa tek ne as në Shkopet, as në Qafë të Buallit nuk ka. Me marr hov andej, bëhesh troshka.

-Ke të drejtë.-tha, dhe më duket se u bind.

Kam parë në çdo qytet të Europës ku kam qenë, madje edhe për në Shkodër, që udhëtarë e shtyjë udhën duke lexuar. Kjo është fitim kohe, domethënë edhe koha shtyhet, edhe dija me kënaqësinë fitohen njëkohësisht.

Edhe në çantën time gjithë kohës qëndron së paku një libër. Rrugës për Berat, kam marrë Gabriel Garcia Maques-in reportazhe, "Udhëtim në Europën Juglindore" kur po zbrisja kisha lexuat 73 faqe (faqet nuk janë shumë të mëdha). Ndërkohë kam provuar ta bëj edhe rrugës nga Dibra në Tiranë, por duart janë të zëna për t'u shtrëguar mos i hipësh tjetrit në shpinë gjatë kthesave e laqeve që ka rruga, ndërsa mendja ka marrë teposht Rrugës së Arbërit duke fluturuar nga një xham i lënë hapur që tu futur ajër i ri. Nëse rrugës për në Dibër do mund të lexoje, jam i sigurt se do të qe një indicie për të shkuar sa më shumë njerëz dhe sa më shpesh.

Dibra dhe Berati janë thuajse të barazlarguara nga Tirana në vijë ajrore, ndërsa, për të shkuar në Berat të duhet gati një orë e gjysëm, për në Dibër të duhen katër orë. Dmth, dy orë e gjysëm më shumë, dhe sipas meje, padrejtësia më e madhe që mund t'i bësh dikujt është: t'i marrësh kohën. Të shkosh nga Dibra në Tiranë të kushton 8 orë kohë vajtje-ardhje, që normalisht duhet të lësh ditën e punës. Kjo gjë bëhet rrallë, dhe dashja-pa-dashje, kjo marrje kohe të kufizon.

Duke i kapërcyer bukuritë e Beratit (sepse çdo vend ka bukuritë e veta), në çdo cep të qytetit kishte kosha mbeturinash, diku kishte semaforë, dhe vende plot me stola dhe sheshe publike. Rrugët nuk kanë gropa dhe dritat në mbrëmje janë ndezur kudo. Trotuaret nuk ishin të zëna me karrige nga kafenetë dhe kjo të jep idenë se gjërat këtu shkojnë mirë.

Pedonalja është përplot pemë të mëdha dhe hija të krijon kushtet mos të të digjet rrashta e kresë kur të kalosh në të. Nën këto hije ka stola, dhe pasdite mbushen plot me të rinj e pleq. Vertetë që të rinjtë nuk gjenden në kafene por në stola. I gjithë vendi mbushej plot me njerëz muzgjeve dhe qyteti gjallon.

Berati kishte plot të rinj, dhe kështu edhe këtu unë gjithnjë i jap qasjen në mendim duke e krahasuar me vendin tim. Në Dibër (dhe të gjithë verilindjen e Shqipërisë) të rinjtë ose ikin në kurbet pa mbaruar asnjë shkollë ose bëjnë një shkollë në Tiranë dhe të suksesshmit nuk kthehen më dhe kjo ndodh si mungesë e perspektivës e shpresave për një të ardhme ndryshe.

Çmimet janë gati të njëjta edhe pse është qytet turistik. Ndoshta kjo është arsyeja që vizitohet nga plotë e plotë të huaj duke veçua faktin që është qytet muze.

Pas mbylljes së aktivitetit poetik në pedonalen e qytetit, ku lexuam poezi tonat dhe të poetëve të preferuat dolëm dhe u sorollatëm nëpër qytet. Kishte edhe panair libri, gjë që në Peshkopi u bë vetëm dy vite, dhe gjasat janë mos të zhvillohet më.

Drejtori i Bibliotekës së Beratit, Arben Jaupaj, kërkon që të ngjallë frymën e leximit në qytetin e tij, tek të rinjtë dhe jo vetëm, dhe fill pas kësaj, si pasojë edhe të nxisë krijime të reja.

Më ka rënë rasti të jem në aktivitete letrare në Shkodër, Kamëz, Durrës, Tiranë po e po, por së fundmi edhe në Berat, dhe të them të drejtën që nuk ka diçka të mirëfilltë letrare (me sa di unë) prej disa vitesh që tentoj të jem pjesë e kësaj bote kulturore.

Më shqetëson fakti që nuk ka të tilla aktivitete, që fatkeqësisht, këtë rast janë pasqyrë e kulturës së leximit por edhe të kulturës në përgjithësi që ka një brez dhe që pret ta trashëgoj tek pasardhësit. Dikush do të thoje se ne kemi hallet të tjera, halle me siguru jetesën, por kurrsesi nuk po vdes Shqipëria për copën e bukës, megjithëse kultura është buka e mendjes dhe e shpirtit.

Fjala bie, ne kemi halle politike. Këtu jam shumë dakord. Sepse nëse bëhet një protestë për një parti politike, i ke në Tiranë mbi 5 mijë dibranë, ndërsa për të protestuar për Rrugën e Arbërit, bëhen-s'bëhen 300 veta. Por as kjo nuk e justifikon leximin e pakët dhe qasjet inferiore ndaj kulturës në tërësi. E megjithatë, leximi në krizë është një fenomen botërorë, por kurrë s'duhet të shterrohen qasjet, e as indiciet.

DIBRA: TURIZËM DHE TRADITË



Dibra, një nga rajonet malore më të bukura të Shqipërisë, rrethuar nga vargmalet Deshat-Korab dhe Lurë-Selishtë, me 21 liqene akullnajore, dy parqe kombëtare dhe banja termale të mirënjohura, ka potencialin për të mbështetur një industri të gjallë turistike. Megjithatë, zona ka infrastrukturë dhe qasje të dobët me rrugë, ka pasur pak angazhim në sektorin privat dhe nivelet e larta të varfërisë dhe papunësisë vazhdojnë.

Dibra: Projekti Turizëm dhe Traditë kërkon të rrisë punësimin, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe grave, dhe të rrisë të ardhurat e familjeve të Dibrës të përfshira në zinxhirin e furnizimit me shërbimin e turizmit. Projekti synon të zhvillojë dhe promovojë ndërmarrjet e turizmit të qëndrueshëm në komunitetet e Shqipërisë së Veriut.

ZONAT E PROGRAMIT
PËRMIRËSIMI I MJEDISIT
Duke punuar në partneritet të ngushtë me Bashkinë e Dibrës, projekti do të mbështesë përmirësimin e qeverisjes, planifikimit dhe shërbimeve publike, nxitjen e mundësive dhe partneriteteve në sektorin privat dhe përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe TIC-ut në lidhje me zhvillimin e turizmit.

KAPACITETET E PUNËS
Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin e modelit të turizmit, të përmirësojë cilësinë dhe aftësitë teknike të prodhuesve dhe furnizuesve të produkteve dhe shërbimeve, si dhe të krijojë një program të praktikës profesionale për të rinjtë dhe vullnetarët.

ZHVILLIM I PRODUKTIT
Projekti do të modelojë, zhvillojë dhe promovojë produkte të specializuara të integruara duke përdorur mjete të bazuara në prova dhe qasje pjesëmarrëse për të siguruar pronësinë dhe për të shërbyer si modele të ardhshme.

REZULTATET E PRITSHME:

- **Krijimi i një Institucioni vetëqeverisës, ndërsektorial (Forumi Dibra Turistike), i cili në mënyrë efektive planifikon, koordinon dhe promovon turizmin në Dibër;**
- **Zhvillimi i një Plan-Veprimi për Turizmin (TAP) për Bashkinë e Dibrës përmes një procesi pjesëmarrës me vëmendje ndaj traditës, pasurive natyrore, bujqësisë, qëndrueshmërisë, pajtueshmërisë me çështjet gjinore dhe ato të mjedisit;**
- **Përmirësim i funksionimit të një Qendre të Informacionit Turistik (TIC) cilësore, nëpërmjet formimit të një PPP-je dhe rritjes së kapaciteteve të stafit për menaxhimin dhe funksionimin e TIC, shërbimit cilësor ndaj konsumatorëve dhe informacionit mbi tregun;**
- **Krijimi i lidhjeve B2B dhe partneriteteve ndërmjet furnizuesve turistikë dhe mes artizanëve dhe prodhuesve të produkteve bujqësore;**
- **Ndërtimi i një plani të qëndrueshëm marketingu me platformën e TIC-ut / mediave sociale për të promovuar dhe mbështetur turizmin në Dibër;**
- **Trajnimi i një grupi të kualifikuar të guidave turistike lokale (shërbime udhëzuese);**
- **Zhvillimi i trajnimeve profesionale, praktikave profesionale formale dhe përcaktimit të pozicioneve vullnetare për rininë e zonës.**
- **Identifikimi dhe zhvillimi itinerareve për "udhëtime 5-ditore";**
- **Identifikimi dhe shënjimi i 5 itenerareve tematike turistike, duke përfshirë shënimin e rrugëve, tabelat orientuese në fshat; Hiking / biking / hartat e karavaneve; dhe broshurat informative; dhe**
- **Krijimi i dy modeleve të fshatrave tradicionale turistike.**

PROJEKTI AKTUAL
Emri: Dibra: Turizë dhe Traditë
Kohëzgjatja: mars 2017 – mars 2020
Buxheti: $1, 046,689
Zbatuesi: Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF)
Person Kontakti: Dennis Wesner, USAID General Development Officer | dwesner@usaid.gov | +355 4 229 3536

Turizëm

Nis zyrtarisht projekti D2T
“Dibra: Turizëm & Traditë”

Dibra, destinacion turistik

– Mikpritje, traditë dhe natyrë –

Embushur dhe e zbukuruar si asnjëherë më parë salla e QEK në Pallatin e Kulturës në Peshkopi, me date 17 korrik, u bë vendi pritës i konferencës hapëse të projektit “Dibra: Turizem & Tradite” (D2T). Në prani të më shume se 80 pjesëmarrësve nga autoritet vendore të Prefekturës Diber, Këshillit të Qarkut, Drejtorive rajonale; përfaqësuesve të sektorit privat (hoteleve, shpi pritëse, guida, grupe prodhuesish, agropërpunues) dhe shoqërisë civile e medias, zv. Drejtori i zyrës së Europës dhe Azisë së USAID në Washington z. ROB Camillari dhe kryetari i Bashkisë Dibër Muharrem Rama shpallën nisjen e këtij projekti.

D2T, Dibra: Turizëm dhe Traditë, është një projekt 3-vjeçar që financohet nga USAID dhe Ambasada Suedeze dhe zbatohet nga ALCDF (Fondacioni Shqiptarë i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale) në partneritet me Bashkinë Dibër, CNVP dhe shoqata “Dibra Turistike”. Ky projekt kërkon që ta kthejë Dibrën në një Destinacion Turistik, duke i shfrytëzuar vlerat esenciale dibrane të mikpritjes, traditës dhe natyrës.

Drejtoresha e ALCDF Znj. Lindita Manga, hapi konferencën dhe në emër të projektit ju uroi mirëserdhjen pjesëmarrësve dhe të ftuarve të tjerë, si dhe prezantoi qëllimin kryesor të projektit i cili kërkon të ndikojë në rritjen e numrit të punësimit dhe shtimin e të ardhurave të familjeve dibrane nëpërmjet zhvillimit të sektorit të turizmit.

Konferencën e përshëndeti zv. Drejtori i zyrës së Europës dhe Azisë së USAID ne Washington z. ROB Camillari, që vlerësoi mikpritjen që ju bë nga stafi i projektit dhe kryetari i bashkisë Dibër z. Muharrem Rama dhe stafi i tij. Ai ndihej i lumtur dhe i mahnitur nga bukuritë natyrore të Dibrës dhe nga monumentet kulturore që vizitoi në Kërçisht dhe përgjatë rrugëtimit të tij në Dibër. Ndihma e USAID do vazhdojë theksoi z. Camillari, sepse qeveria Amerikane nëpërmjet USAID dhe ajo Suedeze mendon që zhvillimi dhe prosperiteti i Shqipërisë do mund të vijë vetëm nëpërmjet zhvillimit ekonomiko-social dhe Turizmi është një sektor shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në ekonominë e familjeve dibrane dhe në përmirësimin e imazhit dhe mjedisit në Shqipëri. Ai shprehu premtimin që projektet e USAID do vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Me interes u prit fjala përshëndetëse nga kryetari i bashkisë Dibër z. Muharrem Rama, i cili theksoi që në fillim se stafi i tij dhe Bashkia kanë qenë plotësisht të angazhuar që ky projekt të eci në rrugë të mbarë. Turizmi është sektori prioritar i zhvillimit të zonës së Dibrës, dhe Bashkia e vlerëson atë si prioritet të punës së saj. Projekti “Dibra: Turizëm dhe Traditë” theksoi kryetari i bashkisë vjen pikërisht në kohën që Bashkia ka përgatitur Planin Vendorë dhe po përgatit planet buxhetore afat-mesëm dhe vjetor duke hedhur hapat e sigurt të zbatimit të objektivave të bashkisë në këto sektorë. Ai shprehu angazhimin dhe mbështetjen e tij dhe stafit që ai drejton për projektin duke përmbushur të gjitha detyrimet që ka Bashkia si partneri kryesorë në projekt.

- Rob Camillari, zv. Drejtori i zyrës së Europës dhe Azisë së USAID në Washington: **Qeveria Amerikane nëpërmjet USAID dhe ajo Suedeze mendon që zhvillimi dhe prosperiteti i Shqipërisë do mund të vijë vetëm nëpërmjet zhvillimit ekonomiko-social dhe Turizmi është një sektor shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në ekonominë e familjeve dibrane dhe në përmirësimin e imazhit dhe mjedisit në Shqipëri.**

- Dennis Wesner, Drejtori i programeve të USAID në Shqipëri: **Zgjodhëm zonën e Dibrës pasi kjo zonë ka shumë potenciale natyrore si lumin Drin, 21 liqenet akullnajore në Lurë dhe Selishtë, 41 monumentet e natyrës, ujërat e termale të Llixhave dhe malin më të lartë në Shqipëri, Korabin. Me gjithë këto resurse Dibra përsëri mbetet zona më e varfër në Shqipëri, me numrin e lartë të papunësisë dhe infrastrukturën e keqe rrugore. Pavarësisht këtyre pengesave, ky projekt do të jetë i suksesshëm dhe Dibra do jetë një Destinacion Turistik shumë i vizituar.**

- Lindita Manga, drejtoresha e ALCDF: **Qëllimi kryesor i projektit kërkon të ndikojë në rritjen e numrit të punësimit dhe shtimin e të ardhurave të familjeve dibrane nëpërmjet zhvillimit të sektorit të turizmit.**

RRETH D2T:

Projekti D2T do të rrisë numrin e turistëve në Dibër dhe cilësinë e përvojave të tyre. Përmes partneriteteve me bizneset dhe qeverisjen vendore, projekti do të zhvillojë atraksione të agrobiznesit në harmoni me natyrën, kulturën dhe mjedisin, si pista për ecje dhe biçikleta, bujtina dhe fshatra tradicionale, futjen e sistemeve të vetqëndrueshme të menaxhimit të energjisë dhe mbetjeve, përmirësimin e Infrastrukturës, dhe do të trainojë guida lokale.


PROJEKTI AKTUAL
Emri: Dibra: Turizë dhe Traditë
Kohëzgjatja: mars 2017 – mars 2020
Buxheti: $1, 046,689
Zbatuesi: Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF)

Konferencën e përshëndeti edhe Drejtori i programeve të USAID në Shqipëri Z. Dennis Wesner i cili theksoi që projekti është në kuadër të bashkëpunimit të USAID me Ambasadën Suedeze dhe kërkon të



zhvillojë dhe promovojë ndërmarrjet e turizmit të qëndrueshëm në komunitetet e Shqipërisë së Veriut. Zgjodhëm zonën e Dibrës pasi kjo zonë ka shumë potenciale natyrore si lumin Drin, 21 liqenet akullnajore në Lurë dhe Selishtë, 41 monumentet e natyrës, ujërat e termale të Llixhave dhe malin më të lartë në Shqipëri, Korabin. Me gjithë këto resurse Dibra përsëri mbetet zona më e varfër në Shqipëri, me numrin e lartë të papunësisë dhe infrastrukturën e keqe rrugore. Pavarësisht këtyre pengesave Z. Wesner shprehu besimin e tij që ky projekt do të jetë i suksesshëm, dhe Dibra do jetë një Destinacion Turistik shumë i vizituar.

Konferencën e përshëndeti edhe Drejtori i CNVP për Ballkanin Z. Ross Bull, i cili në emër të organizatës partnere në zbatimin e projektit shprehu besimin e plotë që ditët për Turizmin në Dibër do të jenë shumë më të mira. Kam punuar në Shqipëri në vitet 1993-1996 si këshilltarë ndërkombëtarë i ministrit të Ekonomisë z. Ruli, dhe shikoj një ndryshim shumë të madh që nga ajo kohë në Shqipëri. Janë vetë shqiptarët, fermerët, grupet prodhuese, turet turistike, agjencitë, pronarët e hoteleve dhe restoranteve që me punën dhe investimet e tyre kanë ndryshuar pamjen e Shqipërisë dhe kanë zhvilluar vendin. Me më shumë përpjekje nga të gjithë aktorët dhe me mbështetje nga donatorët



kam shumë besim që Dibra do të jetë Destinacion Turistik gjatë këtyre 3-vjetëve, theksoi drejtori i CNVP.

Me entuziazëm u prit edhe fjala përshëndetëse deputetes së Dibrës znj. Almira Xhembulla, e cila deri para pak ditëve ka qenë pjesë e stafit të projektit që nga faza përgatitore. Ajo ndihej e privilegjuar që ishte e pranishme mes kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të saj që me profesionalizëm kanë punuar që ky projekt të bëhej realitet. Ajo vlerësoi mbështetjen e dhënë nga USAID dhe Ambasada Suedeze dhe shprehu gatishmërinë e saj për të kontribuar për këtë projekt dhe për projekte të tjera të zhvillimit nga pozita e deputetes dhe politikbërëses. Znj. Xhembulla shprehu edhe besimin që bashkërisht me bashkinë Dibër dhe partnerët e tjerë në projekt ALCDF, CNVP dhe Shoqata “Dibra Turistike” do sjellin një ndryshim pozitiv për Turizmin në zonën e Dibrës.

Koordinatori i këtij projekti z. Besnik Alku paraqiti për të pranishmit në mënyrë të detajuar se çfarë objektivash, rezultate dhe aktivitete do të ketë projekti. Në kuadër të këtij projekti janë shumë ndërhyrje dhe produkte duke filluar nga përmirësimi i mjedisit të sektorit të turizmit, aftësimin e fuqisë punëtore, dhe zhvillimin e produktit turistik. Z. Alku theksoi se janë 14 produkte kryesore që do dalin nga ky projekt duke filluar nga krijimi i “Forumit Dibra Turistike”, i cili në mënyrë efektive planifikon, koordinon dhe promovon turizmin në Dibër; zhvillimi i një Plan-Veprimi për Turizmin (TAP) për bashkinë e Dibrës; përmirësim i funksionimit të një Qendre të Informacionit Turistik (TIC); krijimi i lidhjeve B2B dhe partneriteteve ndërmjet furnizuesve turistikë dhe mes artizanëve dhe prodhuesve të produkteve bujqësore; ndërtimi i një plani të qëndrueshëm marketingu me platformën e TIC-ut / mediave sociale për të promovuar dhe mbështetur turizmin në Dibër; trajnimi i një grupi të kualifikuar të guidave turistike lokale (shërbime udhëzuese); zhvillimi i trajnimeve profesionale, praktikave profesionale formale; identifikimi dhe zhvillimi itinerareve për “udhëtime 5-ditore”; identifikimi dhe shënjimi i 5 itenerareve tematike turistike, duke përfshirë shënimin e rrugëve, tabelat orientuese në fshat; hiking / biking / hartat e karvaneve dhe broshurat informative dhe krijimi i dy modeleve të fshatrave tradicionale turistike që janë Kërçishti dhe Rabdishti.

Në rolin e moderatores së konferencës, znj. Lindita Manga, njëherësh edhe menaxhere e projektit, ftoi pjesëmarrësit për pyetje dhe diskutime, të cilët nuk u kursyen të urojnë suksese projektit dhe vlerësuan punën e bërë nga stafi i ALCDF në vite për zonën e Dibrës. Znj. Lindita pas pyetjeve dhe diskutimeve bëri dhe konkluzionet e kësaj konference dhe gjeti rastin të falënderojë pjesëmarrësit dhe donatorët për besimin dhe financimin e këtij projekti. Ajo theksoi, që ky projekt nuk është çelësi magjik që do zgjidhë të gjitha sfidat e turizmit në Dibër, por ai do jetë “Leva e Arkimedit” për të ngritur një turizëm të zhvilluar në zonën e Dibrës, pasi bashkia Dibër dhe të gjithë aktorët lokalë të sektorit të Turizmit në Dibër të pranishëm në sallë janë pika më e fortë mbështetëse e këtij projekti.

Ndryshe nga shumë konferenca të tjera, në mjediset e QEK u organizua edhe një mini-panair me produkte tradicionale tipike dibrane, dhe u shtrua një koktel vetëm me prodhime dibrane nga lëngu i mollës së Veip Salkurtit dhe frutave të stinës si mollë, dardhë, kumbulla dhe produkte të tjera të kulinarisë dibrane. “Si Dibra s’ka tjetër”, ky ishte dhe lajtmotivi i kësaj veprimtarie.

Koresp.“Rruga e Arbërit”

Sipas librit "Udhëzues për mrekullitë natyrore të Botës", botuar në Milano në vitin 1979.

Lugina e Drinit, një mrekulli natyrore e Botës



Nga Dr. **SELMAN MËZIU**

Nuk janë fjalë të pa vlera që përbëjnë një fjali të pakuptueshme. Por as fantazi trupash qiellor të largët me dymijë vjet dritë ku hamendësohet: ka jetë - nuk ka, ka hidrogjen apo oksigjen si elemente kimike të fillesës së gjallimit. Është një realitet që ka ekzistuar në mijëra shekuj, por, vlerësimi i asaj që lëviz, transformohet, zhduket, apo zbukurohet nga njeriu apo vetë faktorët klimatik ka mbetur pezull në memorien e kohës. Ndërsa në rastin tonë e kanë përzgjedhur ekspertët natyralist, të zgjedhur nga e gjithë bota, të cilën këtë luginë e kanë klasifikuar një ndër mrekullitë e botës.

MREKULLITË NATYRALE TË BOTËS

Nuk kam mundësi t'iu jap të shkruara me hollësi të gjitha ato mrekulli të natyrës, qofte pyje, parqe natyrale, përrenj, lumenj, masive shkëmbinjsh, oaze, shkretëtira, male, lugina, rrafshnalta e masive malesh të cilat sigurisht janë me mijëra. Do të përpiqem të jap vetëm emrin e shteteve. Dhe ja fillojmë sipas rendit alfabetik të kontinenteve. Fillojmë me Afrikën, dhe ja, radhiten, Namibia, Algjeria, Angola, Kameruni e Kongon e më tej me ishullin Mauricio në Kenia e Madakaskar, nga Xhibuti në Ruanada dhe akoma më tej nga Tunizia në Uganadae Zaire. Ndërsa Kontinenti Amerikan fillon me Argjentinën, Kilin e Guetemalën, vazhdon me Meksikën, Kosta Rikën, Perun e SHBA. E zbret deri tek Uruguai e Venezuela. Në kontinentin Aziatik, fillon me Afganistanin, Japoninë, Filipinet dhe vazhdon me Iranin, Nepalin, Vietnamin e Bashkimin e Republikave Sovjetike e deri ne ishujt indonezian.

Kontinenti Europian fillon me Shqipërinë dhe vazhdon me Bullgrinë, ngjitemi deri në Danimark, Finlanda e Islanda, dhe shkojmë më tutje nga Gjermania, Polonia, Portugalia, Anglia dhe deri tek Zvicra e Hungaria, etj. Ndërsa për kontinentin Oqeania e fillon me Australinë, shkon tek ishujt Havai dhe arrin deri tek ato të Tahitit.

PËRSHKRIM I LUGINËS SË DRINIT TË ZI

Ndërsa Shqipëria përfaqësohet nga lugina e Drinit, ku autori, ose grupi i ekspertëve na e jep këtu në faqen 134: "Është lumi më i gjatë në Shqipëri, i cili formohet nga dy degëzime, Drini i Zi dhe Drini i Bardhë duke përshkuar 283 km gjatësi".(f.134)

Dhe më tej ja se si e trajtojn njohjen e kësaj lugine: " Në fillimet e shekullit (XX-të S.M.), pjesa më madhe e gjatësisë së luginës ishte e panjohur, dhe konsiderohej vendi më i egër i cili nuk mund të kalohesh nga evropianët." (f.134)

Deri më tani pak etnolog, gjeograf e kanë përshkruar gjatë gjithë gjatësisë së tij. Grykat që ai çan përmes masiveve malore, kthesat e forta, brigjet shumë të pjerrëta ka paraqitur në shekuj"... një pengesë të pakapërcyeshme, apo shume të vështirë për ushtrinë otomane, duke u mbrojtur nga këto barriera gjiganteske natyrale si popujt e Mirditës, Këlmendit e Dukagjinit kanë mundur të krijojnë kushte për mbijetesë e një jete të qetë në alpet shqiptare." (po aty. f. 134)

Drini i zi, e ka vend burimin në liqenin kaltërosh të Ohrit, i cili ndodhet në një lartësi 700 m. mbi nivelin e detit. Në ish-territorin Jugosllav, sot Maqedonas, i cili përshkon 45km. gjatësi, përmes grykash të përthyera por me bukuri natyrale mahnitëse. Shpatet janë të përbërë nga shkëmbinj gëlqeror ose flyshe, të cilat ngjiten deri në 800 m. mbi nivelin e detit. Pas këtij udhëtimi arrin në krahinën e Dibrës, duke përshkuar gryka mjaft të bukura, të cilat në lartësi duken shkëmbinjt masiv gëlqeror.

Të parin mal që takojmë është Valivari (2734 m.) në krahun lindor ndërsa në perëndim ngrihet madhështor mali i Homeshit (2000 m). Ndërsa duke përshkuar disa ultësira në perëndim të Peshkopisë rihyn në grykat gëlqerore të Gjallicës, që duken si shkëmbinj vullkanik. Kjo grykë ka një thellësi 600 m duke formuar një kanion të frikshëm, të egër. Në këto relieve të thepisuar, të frikshme, të egëra si dhe në shpatet shkëmbore e shumë të pjerrëta duken edhe gëmusha shkurresh që vegjetojnë plotë jeshillëk duke i dhanun pamje joshëse.

Ndërsa në lindje ngrihet, " vargmali i Korabit me një bardhësi ndriçuese, vezulluese, për një kohëzgjatje gjashtë mujore, me kreshtat në formë dhëmbësh me shenjat e erës së akullnajave, me dhëmbëzime të shumta, apo thepa thepa." (po aty, f.134)

Ndërsa pranë qytetit të Kukësit bashkohet me Drinin e Bardhë, i cili përshkon krahinën e Kosovës e Metohisë (banuar nga shqiptar). Shtrati i tij është formuar në 250 metra mbi nivelin e detit dhe ka një prurje prej 98 km³ në sek. Më pas Drini përshkon një gryk prej 50 km. Në vargmalet e Alpeve të veriut me shkëmbinj gëlqeror, por shfaqen hera-herës edhe ato serpentinor. Duke formuar pamje magjepse, me zbritjet e vrullshme dhe kthinat e relievin mjaft të thyer të shpateve të maleve.

"Procesi i industrializimit i ka përdorur ujërat e tij për të prodhuar energji elektrike, e cila krahas të tjerash për popullsinë e krahinave përgjatë brigjeve të Drinit, ka kontribuar në nxjerrjen e tyre nga izolimi qindra vjeçar" (po aty, f.135). Por, lidhja e popullsisë në brigjet e kundërta është e pamundur nga mos ndërtimi i urave e përdorimi i varkave apo anijeve të vogla.

TRANSFORMIME DHE VLERËSIME

Në hyrje te shkrimit mbi lumin Drin është shkruar: "Grykat e thella, me anët shumë të pjerreta e të thella që përshkon Drini, kanë shërbyer gjithmonë si një barrikadë mbrojtëse me përmasa gjigante për ushtritë e shumta pushtuese, të cilat i bëjnë akoma këto krahina vende më të paarritshme të kontinentit europian" (po aty, f. 135).

Me gjithë këtë konstatim subjektiv mbi peizazhet tërheqëse e me bukuri të rralla të Drinit, në rrëpirat e shpatet e pjerrëta të maleve, në qafat e tyre kanë kaluar përgjatë ekzistencës së ilirëve me fisin Penest që banonte në Dibër dhe ma radhë hordhitë romake, gote, hunëve, bullgare, serbe, turke, të cilë kanë masakruar popujt e luginës së drinit. Por duke u përballur me ato me luftëra titanikësh.

Natyra me relieve malesh e luginash të thella, me pllaja me sipërfaqe të kursyera, kanë krijuar kushte për formimin e karaktereve të forta. Po kështu janë kultivuar sipas mjedisit gjeografik të jetës, trimëria, guximi, vullneti i fort, punëdashës e mjaft energjik në punët bujqësore e blektorale e mbrojtjen e vendbanimeve.

Dhe ja po japim një fragment tjetër të kësaj enciklopedie ku trajton një dukuri tjetër tek popujt që banojnë në dy anët e brigjeve të Drinit: "Edhe pse nuk kemi ma rrezik të na vrasin me pushkë nga malsorët edhe pse kullat (ndërtime antike me kulla mbrojtëse nga dritare në pjesët e sipërme) janë të boshatisura, gojët (bedenat) e tyre mbeten të papushtueshme, po kështu edhe urat dhe livadhet etj."(f. 135). Edhe pse enciklopedia është botuar në vitin 1979, vlerësimet e mjediseve psikologjike e shoqërore, janë së paku të viteve 1930. Duke krijuar një mendim të keq, cinik e të frikshëm mbi malësorët, të cilët tanimë janë të shkolluar, zhvilluar kulturisht e të emancipuar në të gjitha hallkat e veprimtarive ekonomike e kulturale.

Vendbanimet kanë dhjetëra vjet që janë të arritshme dhe me dëshirë e projekte të modeleve evropiane kanë arritur të transformojnë natyrën dhe e kanë vënë ujin në shërbim te tyre, hidrocentrali me liqenin në Dibër të Madhe, Vau i Dejës, Komani e Fierza, duke krijuar kushte të lundrimeve përmes qindra kilometrave e shijuar peizazhet e egra e fshatrat e ndryshme përgjatë lumit Drin.

Tanimë, në këto brigje ku kemi kala të lashta si ajo e Ohrit, kalanë që ndërtoi Gjergj Kastrioti në Medriçe, qytetin antik i Gërdecit, kalaja antike dhe e madhërishme e Grezhdanit, e në vazhdim deri tek vendbanimi i Shurdhahut në Vaun e Dejës dhe me kishën shumë të vjetër që u hodh ne erë në vitin 1968 po këtu.

Prandaj, turizmi malor për evropianët, që i njohin pak bregdrinasit në dyqind e tetëdhjetë e tre kilometra, do të zbulojnë jo vetëm një natyrë të virgjër, por edhe atë të transformuar nga dora e njeriut duke e kthyer në arkitektura peisazhistike të mahnitshme, do të njihen me histori të lashta që të epokës së gurit e deri në kohët moderne. Kështu, ato do të ndjejnë kënaqësi shpirtërore dhe do të marrin përshtypjet e tyre, ku ndokush do të shkruaj për transformimet e natyrës dhe të botës psikologjike, morale e kulturore të banorëve të dy anëve të Drinit.



MBYLLJA

Vlerësimin që i ka bërë luginës së Drinit kjo enciklopedi asht një dëshmi e vlerave të mëdha natyrore, turistike, hidrologjike e kulturore që ka kjo luginë mjaft e populluar. Por, edhe pse ka patur aleat malet e vargmalet më të larta e më të egra në Shqipëri, ka mundur të ruaj në gjirin e vetë, natyra në bashkëpunim me njeriun, mijëra e mijëra banor në shkreptimat, rrufetë e bubullimat e shekujve, të cilat nga gjeografët, historianët duhen vlerësuar, propaganduar e ngritur lart në dobi të mjedisit e qytetërimit të popullsisë që jeton në dy anët e Drinit.

Ky material u mbështet në librin: "Guida illustrata alle Meraviglie naturali del Mondo", Milano 1979, f. 464, format 21.3 x 27.6 me 400 fotografi, harta, diagrama.

turizëm



Klara, vajza 11 vjeçare që ngjiti malin e Korabit

Nga **GREHANS UKA**

Klubi Discover Albania që në muajin Mars 2017 organizoi një seri guidash që do të finalizoheshin në datën 2 korrik me ngjitjen në malin e Korabit. Për këtë arsye ky turne u quajt "Misioni Korab 2017".

Që në Panairin e Turizmit u prezantova si guidë lokale dhe shkëmbeva kontaktet me përfaqësuesit e klubit, për përgatitjen e turit në Korabi. U formalizua gjithçka.

Me datën 30 qershor nisemi për në Radomirë. Unë arrita në Radomirë nga Peshkopi ndërsa grupi turistëve nga Tirana. Gjatë rrugës u miqësova me shoferin e linjës, Petrit Tanushin. Pas një orë udhëtimi arrita tek bujtina e Haxhi Himës. Këtu më priste djali i Haxhiut dhe njëkohësisht shoku im Agroni, një djalë i shkathët dhe i zgjuar, i cili të krijon një mjedis gazmor në bujtinë. GPS shënoi 1260 metra lartësi. Ajri i freskët dhe i pastëer ndjehet menjëherë. Kënaqësia ime u rrit kur këtu në bujtinë takohem me Fation Plakun, fotografin profesionist në Shqipëri. Me Fatjonin biseduam gjatë rreth zhvillimit të turizmit, veçanërisht në Dibër. Rreth orës 22:05 grupi arrin në fshat. I gjithë grupi ishin të rinj dhe me profesione të ndryshme. Më e vogla e grupit ishte Klara, vajza 11 vjeçare që ishte e vendosur në qëllimin e saj për t;u ngjitur në Korab, së bashku me babain e saj.

Të nesërmen, rreth orës 07:15 fillojmë ngjitjen drejt majës. Gjatë ecjes bënim ndalesa të shkurtra derisa grupi të bashkohej dhe të normalizoheshin të gjithë. Shikoja në fytyrat e secilit që mrekulloheshin me peizazhin e natyrës. Në lartësinë 2200 metra që ishte më shumë se gjysma e rrugës kishim ecur shkëlqyeshëm. Gjatë rrugës takuam edhe grupe të tjera me turistë. Ishin në mosha të ndryshme, nga SHB, Kosova, Tirana, Çekia.

Në orën 12:30 arritëm në majë dhe për 1 orë ne shijuam qëndrimin në majën e Korabit, duke realizuar disa foto por dhe duke marrë përshtypje pozitive nga natyra përreth. Ajo që na gëzoi më shumë ishte dhe ngjitja e vajzës 11 vjeçare deri në majën e Korabit. Për të gjithë grupin dhe sidomos për mua si guidë ishte arritje sepse ishte personi më i vogël që ngjitej në Malin më të lartë të Shqipërisë pa asnjë problem. Dalëngadalë ne filluam zbritjen drejt fshatit ku gjithçka na shkoi sipas parashikimeve.

Gjatë mbrëmjes shijuam gatimet tradicionale si dhe bisedat e ngrohta.

Me datën 2 korrik së bashku me grupin rreth orës 10:00 u ngjitëm te Liqeni i Zi. Grupit i pëlqeu mjedisi nën hijen e pishave dhe cicërimat e zogjëve rreth e rrotull. Pas shëtitjeve nëpër park rreth liqenit, grupi vendosi që të bënte edhe pak joga në qetësin e parkut. Çdo detaj fotografohej nga pjesëtarët e grupit që u mahnitën. Pak më vonë aty erdhën edhe një grup banorësh të fshatit që festonin në këtë ditë Festën Tradicionale të Radomirës. Kjo e bëri edhe më tërheqëse mjedisin për turistët.



Për një guidë turistike në Dibër kontakto me Gresin në email: udhëtomegresin@gmail.com. Telefon: (+355) 67 36 25 835 (What's App & Viber)

BOTIME


DIBRA NGA ANTIKITETI NË MONARKI



Në këtë punim (vol. I "Dibra nga Antikiteti në Monarki", bëhet fjalë për Trevën Dibrane, për Oranikun (Shehri) e Dibrës, Peshkopinë, Albanopolisin e Ptolemeut, Principatat e Dibrës, lokalizimin e betejave të Skënderbeut në Dibër, organizimin administrativ dhe shoqëror të Dibrës, për Nandë Malet e Dibrës, për oxhaqet, bejlerët dhe agallarët e Dibrës; për qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes dibrane, për politikat aneksioniste serbe ndaj viseve shqiptare, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, lëvizjen kaçake në Dibër, për luftërat kundër ushtrive serbe, masakrat serbe dhe qëndresën mbinjerëzore të dibranëve, për shkolla e shkrim shqip, për demokratizimin e vendit etj. Këta si dhe ngjarje të tjera, formuan lëndën, që u bë objekti i monografisë: «Dibra, nga Antikiteti në Monarki". Autori ka në proces dhe tri volume: "Dibra nga Monarkia në nazifashizëm"; Kontributi i Dibrës në Luftën kundër nazifashizmit" dhe "Dibra në monizëm".

Libri ndodhet në proces botimi. Ftohen qytetarë apo biznesmenë që të kontribuojnë në botimin e këti libri voluminoz.
Të interesuarit të kontaktojnë autorin në FB ose t'i shkruajnë email në adresën: moisimurra@gmail.com

LIBRI I RI



Libri "Profile kolegësh" është botimi më i ri i inxhinierit dibran, Orhan Sakiqi. Në libër është shkruar për 50 personazhe, por janë përmendur së paku edhe 100 kolegë të tjerë, që janë pjesë e pashkëputur e jetës dhe veprimtarisë së tyre.
Më shumë mbi këtë libër do t'ju informojnë në numrat e ardhshëm.
ISBN: 978-9928-4424-501
Çmimi: 500 lekë

reportazh

Stebleva, fshati që nuk blihet


Stebleva

Nga **BUJAR KAROSHI**

Stebleva, një nga fshatrat e krahinës së Gollobordës, 35 km larg nga Librazhdi, është një fshat i vizitueshëm gjatë verës. Rrethuar me pyje të lartë, ajër i freskët dhe gjelbërim ngado, është një oaz i mrekullueshëm në lindje të Shqipërisë.

Mersin Hoxha, kryetari i Shoqatës "Stebleva", ndryshe nga kolegët e tij të shoqatave dibrane në Tiranë, që kujtohen për vendlindjen vetëm për Ditëvere a Shëngjergj, është kthyer ta drejtojë shoqatën e tij në Steblevë, aty ku ka trojet e të parëve të tij. Por është kthyer ndryshe: duke ndërtuar një shtëpi druri bashkëkohore, me të gjitha komoditetet dhe pajisjet e nevojshme, të cilën e ka të hapur për të gjithë ata që duan të vizitojnë dhe ta njohin Steblevën. Gjatë kësaj vere turistë nga vendet europiane e kanë vizituar, kryesisht çekë dhe gjermanë.

Një shtëpi pritëse karakteristike në Steblevë është "Te Qeralli", që në shqip do të kuptohej "Te Hauri". Shtëpitë tradicionale në Steblevë e kanë pas përdorur katin e parë të banesës për bagëtinë, por tani që mirëqenia është rritur, hauri është kthyer në një mjedis të këndshëm për turistët.

Në shtëpi nuk ka njeri. Baki Nura, pronari i saj, ka dalë në ara duke vaditur. Ndërsa ne shijojmë për pak çaste kopshtin e rregulluar bukur në oborrin e shtëpisë. Shkëlqim Gruda, i cili na ftoi të vizitonim Steblevën, tregon se kjo shtëpi u kthye në shtëpi pritëse falë ideve dhe pasionit të djalit të Bakiut, Aranitit, i cili iku nga kjo botë në moshën 41 vjeçare.

Araniti la pas vizionin e tij modern për një fshat turistik me të ardhme. "Ballkoni i Steblevës", i rregulluar bukur në hyrje të fshatit, rrethuar me dru dhe lyer me gëlqere, është pika e parë që të fton të shikosh fshatin e njohur për patatet dhe arrat, por edhe për luftërat e hershme të Skënderbeut.

Bakiun e takojmë të nesërmen te "Çezma e Gjizaxhiut", një krua në hyrje të Steblevës, aty ku kufijtë e fshatit ndahen me Fushë-Studënin. Janë duke e merementuar, lyer me gëlqere muret, si dhe kanë ngritur një banjo publike poshtë rrugës, si për t'i ftuar udhëtarët që të qëndrojnë e të shijojnë ujin e ftohtë, por edhe ta mbajnë mjedisin pastër.

PYJET, BIMËT DHE KAFSHËT, PASURIA QË DUHET RUAJTUR

Pyjet e Steblevës futen në Parkun Kombëtar të Shebenik-Jabllanicë, me një shtrirje prej rreth 33927 hektarë, nga të cilat mbi 10 mijë hektarë pyje dhe afro 7 mijë hektarë kullota e livadhe alpine janë të krahinës së Steblevës.

"Pyjet i kemi ruajtur me forcë, - tregon Mersini. Kur nga Librazhdi dhe Bulqiza u turrën rreth vitit 2005-2006 shkatërruesit e pyjeve, djem të rinj, të ardhur nga Tirana, Durrësi e Elbasani, ku më së shumti janë shpërngulur steblevasit, i kanë ndaluar dhe ruajtur me forcë. Në qoftë se nuk do ta kishim bërë këtë, këto pyje do të kishin fatin e Lurës".

Në malet e Steblevës i takon shumë shpejt pyjet e dushkut, pishën e zezë, ahun, bredhin e bardhë e deri te kullotat alpine. Rruga për te fusha ku ndodhet Piramida 30, aty ku ndahet kufiri me Maqedoninë, është një mrekulli natyrore.

Në malet e Steblevës gjenden mbi 178 lloje bimësh mjekësore, mes të cilëve dallohen kamomili, njëmijëfleteshi, lulebalsami,trumza, trëndafili egër, molla e egër, kulumbria, mjedra, dëllinja e kuqe dhe e zezë, bliri, rigoni, salepi, agulicja, shpatorja, murrizi, vadhëza, peshtriku vilëngjashëm, mokërrza, pinguikula e ballkanit, hepatika fisnike etj.

SI E KA MARRË EMRIN FSHATI?

Stebleva është një vend i bukur, mrekulli e natyrës. Mijëra pushtues, shekuj më parë, u turrën ta bënin të tyren dhe s'e bënë dot. Qindra tregtarë u turrën ta blinin dhe s'e blenë dot. Gojë më gojë ka ardhur emri dhe gojëdhëna: "Moj e bukura Steblevë, me para s'të bleva dot". Mrekulli të tillë si Stebleva nuk mund të shiten dhe të blihen.

Nga mbledhja pa kriter dhe në kohë të papërshtatshme, disa prej tyre rrezikojnë zhdukjen si tisi, panja e malit, mëlleza, bliri, sanza, salepi, ajdësi alpeve, crocusi, zambaku Shqiptar,boronica, çaj mali, mështekna, manushaqja e dukagjinit etj. Kështu që lind e nevojshme që të hartohen manuale dhe programe në terren, që të mësojnë banorët për mënyrën se si ato duhen mbledhur dhe kohën kur është e përshtatshme mbledhja e tyre.

Ashtu si në shumë fusha, shitja e bimëve mjekësore është një problem më vete. Tregu i tyre është kaotik dhe jo stabilizuar, duke çuar jo vetëm në mbledhje pa kriter, por edhe në humbjen e të ardhurave për shkak të tregut të pastabilizuar.

Fauna është shumë e pasur në lloje të ndryshme,duke filluar nga gjallesat njëqelizore e më andej me dhjetëra specie zvarranikësh, amfibësh, peshqish brejtësish , gjitarët e vegjël e deri tek gjitarët e mëdhenj dhe shpendët e zogjtë. Ndër specie më të rëndësishme është trofta e malit, por në këto anë gjen edhe lepurin e egër, kaprollin,



derrin dhe dhinë e egër, ketrin etj.

Rrëqebulli është një ndër kafshët e rralla, por disa kamera të fshehura në pyje të vendosur nga disa organizata mjedisore, e kanë filmuar atë të lëvizë në këto anë. Po ashtu edhe ariun e murrëm, ujkun, kunadhen, macen e egër, dhelprën etj.

Shpendët përbëjnë një pasuri të veçantë e të mahnitshme, si: gjeli egër, kali qyqes, shqiponja, qukapiku, skifteri, gjeraqina, thëllëza e malit, shkabat. Zogjtë përbëjnë një ansambël të vërtetë me cicërimat e tyre, takohen gjithandej në zonat urbane, pyjet e deri tek kullotat alpine.

MENDJEN NË DIBËR, LETRAT NË LIBRAZHD

Stebleva, në kohën e komunizimit, ka qenë e varur administrativisht nga rrethi i Dibrës, por infrastruktura që e lidh me Peshkopinë e Bulqizën është shumë e dobët. Rruga ka nisur të zgjerohet, por punimet po ecin shumë ngadalë.

Që në atë kohë banorët i kanë pas shkruar letra pushtetit të asaj kohe, por thonë se Haxhi Lleshi e ka pas kundërshtuar. "Steblevasit janë dibranë dhe ajo do të mbetet e Dibrës".

"Nuk ka ndonjë ndryshim varësia administrative, - thotë një banor. Për certifikatë do të shkonim në Peshkopi, për certifikatë shkojmë në Librazhd. Por Librazhdi është më afër".

Kur vendi u nda nga komunizmi, në vitin 1990 zona e Steblevës kaloi në varësi administrative të Librazhdit. Tani të gjitha shërbimet publike banorët i marrin nga ky qytet, ndërsa nga pikëpamja etnografike e kulturore, ngjashmëritë me Dibrën janë të mëdha.

Stebleva ka qenë një nyjë e rëndësishme kalimi për zonën e Strugës, Dibrës, Librazhdit, Elbasanit dhe më tej drejt Manastirit, Selanikut, Shkupit etj. Një zonë e tillë e rëndësishme pritet të bëhet edhe në të ardhmen.

"Kemi bërë kërkesë për hapjen e një pike tjetër doganore në vendin e quajtur "Fusha e tridhjetës", një fushë e madhe mes pyjeve, ku ndahet kufiri me Republikën e Maqedonisë. Prej aty, Struga dhe Dibra e Madhe janë shumë afër.

"Megjithëse kam qenë disa herë në Ministrinë e Jashtme, kemi bërë kërkesa të vazhdueshme, e kemi diskutuar me drejtuesit lokalë e deputetë, madje edhe është rëndë dakord parimisht mes dy qeverive për hapjen e dy pikave të vogla kufitare, kjo çështje nuk ka marrë zgjidhje", - thotë Mersini, mikpritësi ynë në Steblevë.

Rruga deri afër Steblevës është e shtruar me çakull, është zgjeruar dhe pritet t'i shtrohet asfalti. Një tabelë e vendosur tregon se afati i përfundimit të saj është dhjetor 2017, por banorët thonë se janë të kënaqur edhe sikur ajo të mbarojë para mesit të vitit tjetër. Dhe atëherë Stebleva do të jetë më afër, por edhe pikat e reja doganore do të jenë të nevojshme

RIKTHIMI

Demir Osmani, një nga bashkudhëtarët tanë në këto ditë korriku, ka qenë disa herë me punë në Steblevë para viteve 1990. Ai i kujton me shumë dashuri miqtë e tij në këto anë, mikpritjen dhe respektin, shumë prej të ilëve e njohën edhe gjatë rrugëtimit tonë në këtë fshat.

Komuna e Steblevës në të kaluarën, përfshirë edhe fshatrat Borovë, Sebisht, Zabzun, Llangë, Moglicë, Fushë-Studën ka pasur mbi 900 shtëpi dhe mbi 4500 banorë. Ndërsa sot popullsia është zvogëluar shumë. Sapo vendi doli nga izolimi komunist, banorët e Steblevës shfrytëzuan lirinë e ekonomisë së tregut dhe sot janë ndër komunitetet në Tiranë, Durrës dhe Elbasan ndër më të pasurit. Disa prej tyre drejtojnë biznese të mëdha


Banorë të Steblevës duke u kthyer nga mali me bimët mjekësore

cyan magenta yelloë black

turizëm

LEGJENDA

Varri dhe çezma e Gjizaxhiut

Një tregtar grumbullonte gjizë në fshatrat e Steblevës dhe e transportonte atë me kuaj dhe e dërgonte në qytetet si Elbasani apo edhe në Strugë. Banorët e këtyre zonave e quajtën Gjizaxhiu dhe kështu e thërrisnin kur kishin për të shitur gjizën apo dhe djathin e tyre. Këtë punë ai e vazhdonte vite me radhë, mirëpo ngaqë po bënte këtë lloj tregtie, normal që mbante shumë para me vete. Kjo gjë u nuhat nga disa hajdutë apo kusar, të cilët i dolën në pritë afër kësaj çezmeje në drejtim të fshatit Steblevë. Gjatë përpjekjes me ata, për të mos ju dhënë paratë hajdutëve, ata e vranë Gjizaxhiun. Kështu që aty ku ai u vra, fshati i bëri dhe varrin Gjizaxhiut të mirë dhe që edhe sot quhet Varri i Gjizaxhiut e po ashtu mori emër dhe kjo çezmë. Nuk dihet emri apo origjina e Gjizaxhiut të mirë, por edhe sot njerëzit vijnë e bëhen kuriozë për jetën dhe historinë e tij. Vijnë, pinë nga një grusht ujë në çezmën me emrin e tij dhe ikin në punën e tyre.

dhe të fuqishme prej miliona eurosh dhe shumë të tjerë kanë ngritur ekonomitë e tyre të vogla që i shërbejnë çdo ditë banorëve në Tiranë dhe në rrethina. Te Kodra e Priftit në Tiranë shumica e tyre kanë ndërtuar vilat e bukura dhe të mëdha, ndërkohë që edhe në Steblevë po rikthehen.

"Gjatë verës kthehen banorët, shumica të rinj, të cilët shfrytëzojnë stinën për mbledhjen e bimëve mjekësore", - tregojnë banorët. Ata i sheh me motorë që i ngjiten malit, si dikur baballarët e tyre me kuaj dhe kthehen pasdite vonë me bimë të ndryshme mjekësore si sherebel, çaj mali, tërfil, salep e plot të tjera.

Reshat Gruda, 60 vjeç, kthehet në fshat gjatë verës, së bashku me gruan, Neslien. Ka mbjellë kopshtin më misër, fasule e patate dhe kërkon malet për mbledhjen e çajit të malit, të cilin e ka të shitur që pa e mbledhur në Tiranë. Një gotë raki, pak bukë të ngrohtë, djathë dhe petulla vendos shpejt e shpejt në tavolinë, dhe të duket se e gjithë zemra e mirë e tyre është shtruar përpara.

Selim Gruda është një tjetër banor, mbi të 60-tat, që na pret ngrohtë e na fton në shtëpinë e tij që po rindërtohet. Ashtu si ai, shumë të tjerë po i rregullojnë shtëpitë, pasi pas shtrimit të asfaltit, Stebleva është larg nga Tirana vetëm 70-80 minuta.

Banorët e Steblevës janë përmendur vazhdimisht ndër breza si mjeshtra ndërtimi, që kanë ndërtuar kryevepra në gjithë Shqipërinë, në vende të ndryshme evropiane e jashtë Evropës.





Kur shikon shtëpitë e vjetra, dykatëshe e me telis prej druri, siç quhen ballkonet shtëpive, bindesh për mjeshtërinë e tyre. Portat e gurit me hark, muret e gurit, shkallët e drurit dhe portat e jashtme të mëdha e të gdhendura, bindesh menjëherë se ata janë mjeshtra të ndërtimtarisë.

BUJQËSIA DHE BLEGTORIA, MUNGESA E TREGUT FRENON ZHVILLIMIN

Banorët e Steblevës kanë qenë të njohur për kultivimin e patates, të cilën edhe tani e kanë shumë të mirë. Kohët e fundit organizata të ndryshme po nxisin kultivimin e farës së patates. Vendosja e krahinës në një lartësi mbi 1100 metra mbi nivelin e detit, e bën shumë të përshtatshme për kultivimin e këtyre farërave. Në kohën e komunizmit fara e patates së Steblevës shpërndahej në të gjithë Shqipërinë. Ndërsa tani prodhimi i farës shkon në më shumë se 10 mijë kv, por haset vështirësi e madhe në shitjen e tyre.

Zylyf Avdiu, rreth 58 vjeç, së bashku me vëllezërit e tij, ka ndërtuar buzë rrugës një bar-kafe, një baxho, shtëpinë dhe një stallë të madhe për bagëtinë. Nga baxho provojmë djathin, gjizën dhe gjalpin e freskët.

"Gjithë qumështin e marr nga bagëtitë e mia, - thotë ai, - pasi nuk kam besim te blegtorët e tjerë për cilësinë e qumështit. Qumështi duhet të jetë i pastër, i freskët, i kulluar dhe i pastruar, gjë të cilën nuk na e sigurojnë blegtorët".

Vitet e fundit është folur shumë për subvencionet në blegtori dhe bujqësi, por Zylyfi thotë se nuk ka marrë asnjëherë subvencione. "Më thanë njëherë të përgatisja dokumentacionin, por më thanë se gjysmën e shumës duhej ta jepja ryshfet". Kur e pyesim se sa dele ka, na përgjigjet: "Numri i bletëve dhe deleve nuk tregohet"...

Medi Kurti, një tjetër banor i Steblevës gjatë muajve të verës, nuk e ka problem të tregojë numrin e bagëtive, ashtu siç nuk e ka problem të tregojë edhe vështirësitë.

"Kam pasur shumë, rreth 500, por i kam rralluar. Tani kam rreth 200 kokë dele e qengja, por i kam lart në bjeshke. Ia kam lënë një çobani tjetër që t'i ruajë", i cili ashtu si edhe Zylfiu, e ka ndërtuar baxhon mes malesh, në stane, pranë bagëtive.

"Bagëtitë duan shërbim, duan njerëz t'u qëndrojnë pranë dhe ne nuk i kemi, - thotë ai. Kam marrë ndonjëherë subvencion, por më shumë kemi pa marrë. Sepse na thonë: "Nuk kemi buxhet këtë vit", dhe kështu që vit pas viti. Dhe kur i kemi marrë, shumat kanë qenë krejt qesharake.

"Nuk është subvencioni problem, - thotë Mediu. Problem është tregu. Nuk kemi ku t'i shesim qengjat dhe bulmetin, si dhe kemi vështirësi të mëdha gjatë dimrit. Shtegtimi i bagëtive drejt zonave fushore tani është i pamundur, për shkak të konflikteve mbi pronësinë, dhe ne jemi të detyruar që më shumë se gjysmën e vitit delet t'i mbajmë brenda".

Mediu ka shfrytëzuar një ndërtesë të ish kooperativës dhe ka ngritur një restorant të vogël veror, ku punon së bashku me djalin. Mbi një sobë në qoshe, bidoni i qumështit po zien mish qengji, të cilët e kanë porositur disa klientë nga Librazhdi e Tirana. Mishi i qengjit në bidon është një gatim i veçantë i zonës.


"Punoj vetëm me porosi. Përdor gjithçka nga bagëtitë e mia: mishin, djathin, gjalpin, gjizën. Punoj këtu gjysmën e vitit dhe pjesën tjetër në Tiranë".

Godina nuk duket si restorant, por Mediu thotë se është në proces legalizimi, dhe pas legalizimit dhe ndërtimit të rrugës, kjo fushë e vogël anës rrugës, mund të bëhet një ndalesë e mirë për turistët që do të shtohen këtyre anëve.

Shënim: Më shumë foto rreth këtij reportazhi do të gjeni në faqen zyrtare në facebook të gazetës



"Te Qeralli" dhe shtëpia prej druri e Mersin Hoxhës, dy shtëpitë pritëse të turistëve në Steblevë



Në trojet e të parëve të Ataturkut, në vitin 2002, me kontributin financiar të djalit të këti fshati, biznesmenit Ferat Lila, u ndërtua çezma e Mustafa Qemal Ataturkut, por individë të panjohur e kanë shkatërruar.

HISTORI

STEBLEVA DHE ATATURKU

Banorët e tij krenohen se janë bashkëfshatarët e Mustafa Qemal Qtaturkut, themeluesit të Turqisë moderne. Ramazan Hoxha, i cili ka lindur në Steblevë, ka qenë profesor i mateatikës dhe ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Ai është marrë me kërkime mbi origjinën e themeluesit të Turqisë moderne, dhe për këtë ka botuar edhe një libër voluminor me titull "Mustafa Qemali, djali nga Stebleva e Dibrës që u bë Ataturk".

Ai thotë se stërgjyshi i Ataturkut ka qenë Mustafa Canka nga Stebleva. Djali i tij, Pirush Canka, ishte gjyshi i Ataturkut. Djali i Pirushit, Beqir Canka, babai i Ataturkut, u shpërngul në Selanik dhe njihej si Beqir Stebleva ose si Beqir Agai-Shqiptari. Ai u martua me Zybere Hanëmin, vajzën e Fejzulla Deras nga Sebishti, i cili në Langaza mbante mbiemrin e gruas së tij, Aishes; Haxhisofollari, sepse u fut domazet në shtëpinë e saj. Nga kjo martesë lindër 6 fëmijë, nga të cilët jetuan vetëm tre.

Syrjai, vëllai i madh i Ataturkut, u vetëvra në moshë të madhe, kur shërbentë në ushtrinë osmane.

Motra e ataturkut, Makbulja, mori emrin e hallë së babait të saj, Beqirit, në kujtim të të emrit të saj, pasi ajombeti në Steblevë.

Mustafa Qemali, mori emrin e të parit të fisit Canka, në kujtim të emrit të Mustafa Cankës, stërgjyshit të tij. Me ataturkun ndërpritet vazhdimësia gjenealogjike në linjë mashkullore të fisit Canka nga Stebleva, pasi partesa zyrtare e tij me Latife Ushakizaden, vajzën më të pasur të Izmirit, nuk prodhoi pasardhës. Ndërsa në linjën femërore, vazhdimësia e fisit canka vazhdon edhe sot në Shqipëri.

Por përmendja e Ataturkut në fshat, përveç krenarisë, ka edhe reagime negative. Në trojet e të parëve të Ataturkut, në vitin 2002, me kontributin financiar të djalit të këti fshati, biznesmenit Ferat Lila, u ndërtua çezma e Mustafa Qemal Ataturkut, por individë të panjohur e kanë shkatërruar. Ashtu siç kanë hequr edhe tabelën e rrugës që të çon në fshat, të cilët banorët i kanë vënë emrin e "Qemal Ataturku".

Rruga e Arbërit nr. 135

albanologji


Në Shqipërinë shtetërore ishte Ruzhdi Mata që prej katër dekadash e pati lidhur emrin e vet me atë të Josif Bagerit. Ai ka qenë i pranishëm pothuajse në të gjitha veprimtaritë me karakter kërkimor e shkencor përgjatë dy dekadave të fundme dhe me sa duket shumë shpejt mund të paraqitet para lexuesit si përkujdesës e përgatitës për botim i veprës së plotë të Josif Bagerit.

Josif Bageri i Rekës së Dibrës

Nga **prof.dr. SHABAN SINANI**

Haki Stërmilli s'i mbeti borxh Dibrës në kohë të zisë
Dhe Dibra Haki Stërmillit po në të njëjtën masë.
Josif Bageri iu përkushtua me ashk e dashuri poezisë
Dhe për flamurin e Ismail Qemalit s'harroi të flasë[1].

Un jom Shqypeja e Shqypënis
Sqohi, or zoqt e trimnis …
Un jom shpeza e furrikut,
Epni dërmën ma rrezikut.
Mjaft në t'errët, n'vorfuni,
Sqohi trima, zoqt e mi …[2]



Në foto: Josif Bageri (Wikipedia)

- **Josif Bageri me të drejtë konsiderohet si themeluesi i letërsisë etnografike të Dibrës me rrethina. Gazeta që ai botoi është e para dhe e fundmja që u shkrua në këtë nëndialekt, mjaft konservativ, jo vetëm në anën fonetike, në leksik dhe në disa aspekte të eptimit, por mbi të gjitha për disa vlera antropogjuhësore dhe sidomos për studime arkeogjuhësore**
- **Josif Bagerit i takon, giithashtu, merita e të parit shkrimtar dibran që e pajisi shqipen e vendlindjes, shqipen e Rekës së Dibrës, me ligjërimin e shkruar. Ky ishte një ndërrim rendi jo vetëm në pikëpamjen gjuhësore e kulturore, por dhe teknike.**
- **Josif Bageri nuk është thjesht *poeti i Rekës,* siç përmendet ndonjëherë. Ai përbën një prej nyjave të forta ku ndërlidhen krijues të mëparshëm e të mëvonshëm shqiptarë, që krijuan në vendlindje apo atje ku i çoi udha e jetës, siç ndodhi me Migjenin. Ne nuk e shohim të rastit, për shembull, që çfarë kishte kërkuar në Sofje më 1911 Josif Bageri, pranimin e një meshtari shqiptar dhe liturgji në gjuhën amtare, do ta kërkonte në Kongresin e Beratit babai i Migjenit Gjoko Nikolić. Ashtu sikurse çmojmë si tipar përafrues prirjen e të dyve për të shekullarizuar veprën e tyre: Josif Bageri duke u kërkuar lexuesve të *Ushtimit të Krujës* pranimin e princit protestan Wilhelm Wied përtej dallimit fetar, kurse Migjeni duke u këshilluar të vetëve të mos besonin më tek *perënditë klasike,* tek *Zoti klasik.***

I.

Njohja për herë të parë me emrin, jetën dhe veprën e Josif Bagerit në vitin 1982, kur studentja shqiptaro-bullgare Natanjela Falli vendosi t'ia kushtonte tezën e saj të diplomës veprimtarisë atdhetare dhe krijuese të tij. Ishte viti i fundmë i studimeve tona universitare, të gjitha programet e studimeve për letërsinë ishin përfunduar, dhe emri i Josif Bagerit nuk na ishte shfaqur askund.

Ky qe rasti për të mësuar se as *Kopësht malsori*, vëllimi i vetëm me poezi që ai pati arritur të botonte[3], as *Shqypeja e Shqypënis*, e përkohshmja që ai drejtoi për disa vite me radhë[4], nuk gjendeshin në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Nuk gjendeshin apo nuk shërbeheshin, ishte dhe mbetet ende një pyetje pa përgjigje, por e sigurt është që Natanjela Falli, studentja e kursit tonë, i fotokopjoi të dyja në Bibliotekën Kombëtare të Sofjes dhe, pasi përfundoi tezën e diplomës, me vlerësimin *shkëlqyer*, na i dha për disa kohë ne, miqve të saj, në duar, edhe vëllimin *Kopësht malsori*, edhe koleksionin e gazetës *Shqypeja e Shqypënis*.

Vetëm një vit më pas do të kishim në duar të parën monografi kushtuar kësaj figure të kapërcyellit prej Rilindjes në periudhën e pavarësimit të shtetit shqiptar, Josif Bageri, shkruar nga Ruzhdi Mata. Një vit më vonë, më 1984, në Prishtinë do të mbrohej doktorata e parë dhe me sa dimë edhe e fundmja kushtuar gjuhës së Josif Bagerit[5]. Më pas do të rikthehej sërish një mënjanësi e gjatë dhe e frikshme. Nëse për periudhën deri më 1990 mund të supozohej si shkak ndikues, drejt a zhdrejt, në luhatjet e mëdha të vëmendjes shkencore ndaj veprës së Josif Bagerit fakti që ai qe drejtor i gazetës së Durrësit *Ushtimi i Krujës* (1914), e cila në një farë mënyre ishte zëdhënëse e qeverisë së Shqipërisë principatë, më pas kjo do të ndodhte për shkaqe që nuk lidheshin me studimet, por me pozitën e shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Dibrës, numri i të cilëve që po shkonte duke u mpakur e shuar, për shkak të pamundësisë ligjore për t'u vetëshpallur si shqiptarë, për shkak të ngatërrimit të qëllimshëm të besimit me kombësinë dhe për shkaqe të tjera të ngjashme[6].

Me themelimin e shoqatës kulturore *Josif Bageri*, nismëtarë të së cilës qenë intelektualët rekas Branko Manojlovski dhe Branislav Sinadinovski, nis një tjetër periudhë, *llazariane* mund ta quajmë, për interesimin shkencor rreth kësaj figure dhe për ringjalljen e vetëdijes shqiptare në gjithë bashkësinë e shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme. Figura e Josif Bagerit u shndërrua sërish në shenjën e identifikimit të shqiptarëve të atjeshëm në pikëpamjen etnike, fetare e kulturore[7]. Branko Sinadinovski do t'i kushtonte Josif Bagerit dhe një studim monografik[8].

Në Shqipërinë shtetërore ishte Ruzhdi Mata që prej katër dekadash e pati lidhur emrin e vet me atë të Josif Bagerit. Ai ka qenë i pranishëm pothuajse në të gjitha veprimtaritë me karakter kërkimor e shkencor përgjatë dy dekadave të fundme dhe me sa duket shumë shpejt mund të paraqitet para lexuesit si përkujdesës e përgatitës për botim i veprës së plotë të Josif Bagerit.

II.

Sido që një autor joqendror në historinë e letërsisë shqipe të fillimit të shekullit XX, poezia e Josif Bagerit dhe veprimtaria publicistike e tij patën vëmendje shumë herët. Për vëllimin *Kopësht malsori* u shkruan recensione në *Kalendari Kombiar* që dilte në Sofje (1911), në të përjavshmen e Bostonit *Dielli e flamuri* (1911); kurse gazeta Bashkimi e Shkodrës shprehte interes për gjykimet e Josif Bagerit për veprën moralo-didaktike *Agimi i gjytetnìs* të Shtjefën Gjeçovit (1911). Këtyre mund t'u shtohet dhe botimi i komentuar i letrës së Kristo Bagerit drejtuar të atit, Josifit, nga shkrimtari bullgar Georgi P. Stamatov (1913)[9]. Ndërsa për vëmendjen që i kushtoi gazeta *Avtonomija* punës atdhetare dhe intelektuale të Josif Bagerit, një tribunë që nisi të dalë prej vitit 1928 dhe e mbylli jetën e vet më 1944, kemi të dhëna vetëm *përanash*, të pamjaftueshme për të arritur në vlerësime[10]. Autorët e këtyre recensioneve dhe shkrimeve nuk njihen[11], por pavarësisht prej kësaj për ne kanë shumë rëndësi, sepse provojnë që libri dhe gazeta e tij nuk mbetën të ishullzuar, por qarkullonin në një hapësirë mjaft të gjerë shqiptare, kudo ku kishte shoqëri atdhetare, dhe leximi i tyre ngjallte interes. Megjithëse një gazetë e vogël, që drejtohej prej një artizani që nuk kishte dalë prej aulash universitare, siç e dëshmojnë letrat drejtuar redaksisë, shpesh të nënshkruara vetëm me heteronime, *Shqypeja e Shqypënis* lexohej në Kajro, në Bukuresht, në Janinë, në Korçë, në Gostivar, në Shkup, në Shpat të Elbasanit, në Manastir, në Shkodër, madje dhe në Amerikë.

Një fazë e dytë vëmendjeje ndaj poezisë dhe publicistikës së Josif Bagerit vërehet në periudhën midis dy luftërave e në vitet në vijim. Papas Gaetano Petrotta, në librin e tij *Popolo, lingua e letteratura albanese* (Palermo 1932), e veçoi i pari si zë më vete Josif Bagerin. Në kuadër të 25-vjetorit të vetëqeverimit, më 1937, ishte gazeta *Java* që skicoi të parin portret jetëshkrimor të tij, ndërsa disa vite më vonë, në vitin 1943, Peter Elezi nga Shelcani i Elbasanit, një emër thuajse i harruar në historinë e letrave shqipe, mbledhës i folklorit dhe autor tekstesh shkollore, i kushtoi dy artikuj jetës dhe veprës së tij. Artikujt u botuan në Kostancë të Rumanisë[12].

Më pas, për një kohë relativisht të gjatë, në studimet historiko-letrare dhe në ato kushtuar zhvillimit të gazetarisë përgjatë Rilindjes e më vonë nuk pati gjë të re. Në tekstet e historisë së letërsisë studioheshin si një nënkrye më vete ata që quheshin *autorë minorë të Rilindjes*. Për shkrimtarët dhe publicistët e mëvonshëm, me pozicion joqendror në letërsi, nuk u rezervua as dhe një paraqitje e tillë panoramike. Në vëllimin III të historisë së letërsisë shqipe, që qe gati për botim më 1965 dhe më 1968 pati shkuar për shtyp, Josif Bageri nuk përmendet. Rreth e qark atyre viteve, Petraq Pepo në Tiranë, një nga njohësit më të vlerësuar të historisë së marrëdhënieve shqiptaro-bullgare gjatë lëvizjeve kombëtare të dy popujve; dhe Mehmet Gjevori në Prishtinë, gjuhëtar, patën shkruar gjegjësisht për letërkëmbimin dhe për poezinë e tij[13]. Kështu, në rrethinat e historisë së letërsisë dhe të mendimit shqiptar, ai do të mbetej dhe në dekadën në vijim, gjatë viteve 1970. Me sa duket, ndërsa përgatitej për të botuar monografinë për Migjenin (1968), me prejardhje nga i njëjti vend, Reka e Dibrës, Petro Janura e kishte parë të pashmangshme një ndalesë tek figura e Josif Bagerit si poet e mendimtar[14]. Ndërsa Bojka Sokolova do t'i bënte shoqërinë *Dëshirë*, gazetën *Shqypeja e Shqypënis* dhe botuesin e saj Josif Bageri, kryeargument të rezultateve të kërkimeve të saj rreth rolit të kolonisë shqiptare të Sofjes në zhvillimin e letërsisë dhe të mendimit kombëtar shqiptar gjatë Rilindjes[15]. Në fakt, kishte qenë Eqrem Çabej i pari që, qysh në vitet 1930, e kishte cilësuar letërsinë romantike shqiptare si *letërsi mërgimi*, letërsi të ardhur prej kolonive.

III.

Josif Bageri me të drejtë konsiderohet si themeluesi i letërsisë etnografike të Dibrës me rrethina. Gazeta që ai botoi është e para dhe e fundmja që u shkrua në këtë nëndialekt, mjaft konservativ, jo vetëm në anën fonetike, në leksik dhe në disa aspekte të eptimit, por mbi të gjitha për disa vlera antropogjuhësore dhe sidomos për studime arkeogjuhësore. Mjaft të veçojmë këtu mbijetesën e stabilizuar dhe të pazëvendësueshme të vetëvetorit i vet, që gjen ligjërimin e mbramë të rendit të vet historik-gjuhësor të pacënuar (rast tipik i titulli i poezisë *Mësoni gjuhën e vet*, ku refleksivi përdoret edhe për vetën e dytë dhe në gjithë poezinë për të tri vetat). Gjuha e Josif Bagerit, gjuha e Haki Stërmillit dhe gjuha e përmbledhjeve me lëndë popullore të pashkruar, që gjendet në arkivat e institucioneve të trashëgimisë, janë tri shkallë të pashmangshme për studime të zhvillimit të shqipes së folur e të shkruar në trekëndëshin Dibër - Tetovë - Gostivar.

Josif Bagerit i takon, giithashtu, merita e të parit shkrimtar dibran që e pajisi shqipen e vendlindjes, shqipen e Rekës së Dibrës, me ligjërimin e shkruar. Ky ishte një ndërrim rendi jo vetëm në pikëpamjen gjuhësore e kulturore, por dhe teknike. Cilido që do të dëshironte të vërente shkallën e përafrimit

SHENJIM I BOTUESIT

Siç mund të vërehet dhe nga titulli, *Pyetje të tjera në albanologji - autorë dhe teza* është vijim i një projekti të hershëm shkencor të autorit për rindërtimin prapavajtës të traditës dhe historisë së mendimit shqiptar në antropologji, në letërsi e gjuhësi, në qytetërim, kulturë e besim, duke synuar rikthimin në dritë të njohjes të ndihmesave të autorëve të rendit parësor e dytësor në këto fusha.

Me shkas e më shpesh pa ndonjë shkas të drejtpërdrejtë; në tekst e jashtë tekstit; në filologji të tekstit dhe përmes vështrimesh antropokulturore, autori tenton të riintegrojë në studimet shqiptare çfarë ishte në mënjanësi, çfarë kishte mbetur përjashtë në historinë e traditës së pashkruar, në traditën e heshtur të shkrimeve, në letërsi dhe etnogjuhësi, në studimet për identitetin dhe botën shqiptare.

Qëllim themelor i projektit është njëherësh verifikimi i tezave, vlerësimeve, qortimeve e pohimeve të këtyre autorëve paralelisht me atë të mendimeve të dijetarëve rreth tyre në historitë e letërsisë, kulturës dhe arteve shqiptare.


Nëse në vëllimin e parë (*Pyetje në albanologji*, bot. *Naimi*, Tiranë 2013), lexuesi u njoh me paradigmën e albanologjisë dje dhe sot dhe me kontributet e personaliteteve të tillë si Aleks Buda, Jeronim de Rada, Hasan Ceka, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Lef Nosi, Vexhi Buhara, Matteo Mandalà, Maximilian Lambertz dhe Milan pl. Šufflay, në këtë vëllim të dytë gjejmë të dhëna të reja e të panjohura, analiza dhe vlerësime me karakter rishikues për figura të tjera po aq të rëndësishme, si: Papa Klementi XI (Giovanni Francesco Albani), Àt Giorgio Guzzetta, Àt Gjergj Fishta, Àt Viktor Volaj, Ndre Mjeda, Fan S. Noli, Kostë Çekrezi, Mitrush Kuteli, Migjeni, Esad Mekuli, Petro Marko, Idriz Ajeti, Dritëro Agolli, Rexhep Ismajli etj.

Mund të thuhet se me këtë projekt, që do të vijojë edhe me vëllime të tjerë, hap pas hapi autori po përfundon një histori të mendimit dhe qytetërimit shqiptar mbështetur mbi kriterin e dukurisë, të personalitetit dhe të veçanësisë së tij, që mund të konsiderohet një enciklopedi e vërtetë albanologjike.

SHABAN SINANI

PYETJE TË TJERA NË ALBANOLOGJI

Autorë dhe teza



LIST OF ALBANIANS WHO CAN WRITE THE ALBANIAN LANGUAGE CORRECTLY.

1) Faik Konitza, President of the "Vatra" of Boston and managing editor of the "Dielli".
2) Fan S. Noli, Prime Minister of Albania; Archbishop and Metropolitan of the Orthodox Diocese of Durasso.
3) Constantine A. Chekrezi, instructor, George Washington University, Washington, D.C.
4) Father Gjergj Fishta, Franciscan friar and poet, Shkutari, Albania.
5) Luigj Gurakuqi, Albanian Minister of Finance.
6) Leser Fundo, President of the "Bashkimi" Society and editor of its paper, Tirana, Albania.
7) Kristo Dako, Christian Minister, in the employ of the Standard Oil Company, Tirana, Albania.
8) Midhat Frasheri, Albanian Minister to Greece.
9) Milto Sotir Cura, school teacher, Koreha.
10) Sotir Gjika, associate editor, Gazetta di Puglia (Italian), Bari, Italy.
11) Don Lazer Shantoja, Jesuit priest, Shkutari, Albania.
12) Archilla Thasi, editor of the Dielli, Boston, Mass.
13) Sejfulla Malesbova, Chief Secretary, Albanian Prime Minister's Office, Tirana, Albania.
14) Anton Frasheri (known in America as Adams), Private Secretary to Albanian Prime Minister, Tirana, Albania..

Àt Giorgio Guzzetta
Àt Gjergj Fishta
Àt Viktor Volaj
Buletini Katolik Shqiptar
Dhimitër Shuteriqi
Dritëro Agolli
Esad Mekuli
Fan S. Noli
Hylli i Dritës
Idriz Ajeti
Instituti i Studimeve Shqiptare
Josif Bageri
Kostë Çekrezi
Migjeni
Mitrush Kuteli
Ndre Mjeda
Papa Klementi XI
Petro Marko
Pjetër Zarishi
Preng Doçi
Rexhep Ismajli

Shaban Sinani
Pyetje të tjera në albanologji: autorë dhe teza
Redaktor: Naim Zoto
Botues:
Naimi - shtëpi botuese dhe studio letrare
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-234-10-0
328 faqe; 15.5 x 23.5 cm.
Çmimi: 1000 lekë

të nëndialektit në të cilin shkroi Josif Bageri me shqipen letrare kombëtare brenda vetëm një shekulli do të mjaftonte të kështillonte për pak çaste poezitë e tij në *Kopësht malsori* ose artikujt në *Shqypeja e Shqypënis*. Letërsia etnografike e së folmes së Dibrës me Josif Bagerin dhe letërsia etnografike e së folmes gjirokastrite me Musine Kokalarin kanë qenë me fat për mënyrën mjeshtërore me të cilën janë dëshmuar në stade të hershme të tyre.

Poezia e Josif Bagerit, me të dyja degët e saj, atdhetare në një anë (*Vajtim mbi varrin e të ndjerit vjershëtor Naim Frashërit; Para fëtyrës Naim Frashërit; Shqyptarët e Shkupit; Kushtrimi i shqyptarvet në Monastir*) dhe edukative në anën tjetër (*Secili nga ne lypën të mbjell farë të mirë e jo të lig, Mësimi dëbon errësirën, Fortësia e pares dhe vepra e saj, Shtëpia ime, Àta i mirë dhe i biri, Jo padia, po dituria e ruen feen, Eni të gjith në msimtore, Malli im*), nuk na çudit aspak: ky ishte modeli që kishin krijuar personalitetet e Rilindjes shqiptare, që nga Naim Frashëri e Konstantin Kristoforidhi, deri tek Ndre Mjeda, të cilët shkruan letërsi njëherësh edhe për nevoja didaktike-shkollore. Jo pa shkak poezia e tij është botuar edhe në përmbledhje me karakter ushtrimor për fëmijët[16], ndërsa prej studiuesish të tjerë është theksuar rëndësia arsimore e personalitetit të tij[17]. Është me shumë interes sidomos mënyra se si në poezitë didaktike të Josif Bagerit ndërthuren padukshëm mësime katekistike të një të krishteri të rritur me porositë, ndalimet, virtytet e mëkatet, nga njëra anë, dhe vlerat morale të rekomanduara prej të mësuarit shekullar. Ka një kufi të padukshëm mes tyre dhe kjo lidhet me thelbin e personalitetit të Josif Bagerit si *njeri i vetëshkolluar* dhe *i vetëformuar*.

Duke iu referuar një konteksti të gjerë historik-kulturor, gjeorajonal, gjeofetar, gjeoetnik e gjeogjuhësor, botimi i veprës së plotë të Josif Bagerit ka rëndësi jo vetëm për protagonistin, poetin, publicistin, atdhetarin; por dhe për historinë e rolit të bashkësisë së shqiptarëve të Sofjes në lëvizjen pavarësiste; për lidhjet midis veprimtarëve që kishin qëllime kombëtare shtetformuese në Shqipëri e Bullgari; për vendin që meritojnë Reka dhe Dibra në historinë e veprimit dhe mendimit kombëtar; për identitetin shqiptar dhe raportet e përbërësve të tij (gjuhë, etni, besim); për tentimet e shumta që rezultojnë në procesin e përveçimit të shqiptarëve për t'i shmangur nga identiteti i tyre përmes manipulimit me fenë; për historinë e shqipes së folur e të shkruar në Dibër e në viset shqiptare në Maqedoninë e sotme; mbi të gjitha për të argumentuar në një shkallë më të thellë si kjo bashkësi e vogël shqiptaro-ortodokse u bë vatra nga dolën emra që zënë kryet e vendit në botën shqiptare: Migjeni më së pari, por, sipas disa të dhënash, edhe të parët e Konstantin Kristoforidhit u degëzuan prej andej, për të shtuar mësuesin Anastas Albanski (Arnaudov), intelektualin nga Reka e Sipërme Bajazid Doda (ndihmës e bashkautor i baronit Ferenz Nopcsa në veprën *Jeta e fshtarave shqiptarë të Rekës se Epërme*), Llazar Siljanin (bashkëveprimtar i Josif Bagerit dhe autor i librave *Besa a fea e shqipëtarëvet të vjetër*, Sofje 1907; *Cilët janë shqiptarët e sotëm dhe gjuha e tyre* (Кои се денешните албанци и техния език, Sofje 1911); *Ngjashmëria e bullgarishtes së sotme me gjuhën shqipe*, bot. *Mbrothësia,* Sofje 1911)[18], akademikun Matej Matevski dhe historianin Urosh Matevski, profesorët Branislav Sinadinoski dhe Branko Manojlovski dhe jo pak të tjerë[19].

Nuk është aspak e rastit kjo vijimësi e breznive krijuese në Rekë të Epërme e përqark. Tentimi për të shkruar shqipen dëshmohet më i hershëm se në vise të tjera, madje dhe urbane, ndër shqiptarët e hapësirës së tyre historike në Maqedoni. Qysh në mesin e shekullit XIX gjenden provat e para për ta shkruar shqipen me alfabetin cirilik pikërisht nga meshtarët shqiptarë, që do të kërkonin më vonë me këmbëngulje (bashkë me ta dhe Josif Bageri e Llazar Siljani) përdorimin e gjuhës amtare edhe në meshim e liturgji[20]. Josif Bageri nuk është thjesht *poeti i* Rekës, siç përmendet ndonjëherë. Ai përbën një prej nyjave të forta ku ndërlidhen krijues të mëparshëm e të mëvonshëm shqiptarë, që krijuan në vendlindje apo atje ku i çoi udha e jetës, siç ndodhi me Migjenin. Ne nuk e shohim të rastit, për shembull, që çfarë kishte kërkuar në Sofje më 1911 Josif Bageri, pranimin e një meshtari shqiptar dhe liturgji në gjuhën amtare, do ta kërkonte në Kongresin e Beratit babai i Migjenit Gjoko Nikolić. Ashtu sikurse çmojmë si tipar përafrues prirjen e të dyve për të shekullarizuar veprën e tyre: Josif Bageri duke u kërkuar lexuesve të *Ushtimit të Krujës* pranimin e princit protestan Wilhelm Wied përtej dallimit fetar, kurse Migjeni duke u kështilluar të vetëve të mos besonin më tek *perënditë klasike*, tek *Zoti klasik*.

Referencat:

1 Abdylazis Islami, *Dibra*, në *Pëshpëritjet e udhëtarit plak*, poezi, bot. Logos-A, Shkup 1995, f. 107.

2 Josif Jovan Bageri, Shqypeja e Shqypënis, Sofje 1011.

3 Titulli i plotë: Josif Bageri, *Kopësht malsori: msime të shqyptarueta dhe vjersha;* prej Josif Jovan Bagerit, pečatnica Vitoša, Sofia 1910.

4 Doli shqip e bullgarisht, me të njëjtin emër, *Albanski orel (Албански орел)*, ndërmjet viteve 1909-1911, si *tribunë për politikë dhe dije*. Për vendin që pati kjo gazetë në historinë e shtypit shqiptar shih më shumë tek Christine Körner, *Entwicklung und Konzeption der Presse in Albanien und der Albanischen Exilpresse,* edit. R. Trofenik, 1982.

5 Shaqir Berani, *Gjuha e Josif Bagerit,* bot. Instituti Albanologjik, Prishtinë 1988.

6 Për këtë mund të krahasohen të dhënat zyrtare për vetëdeklarimin e popullsisë në Maqedoni për etnicitetin, gjuhën amtare dhe besimin, në *Popis na naselenieto, domakinstvata i stanovite vo Republika Makedonija,* 2002, Skopje, maj 2005. Lidhur me këtë çështje shih dhe: Ejup Ajdini, *Sfidat për shpëtimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni, në Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës,* bot. i Universitetit të Europës Juglindore, Gostivar-Shkup 2014, f. 91-99; Metin Izeti, *Shqiptarët e Rekës ndërmjet fetares dhe kombëtares,* po aty, f. 222-232; Qani Nesimi, *Ortodoksët shqiptarë të Rekës së Epërme - viktimë e nacionalizimit të kishës ortodokse,* po aty, f. 277-292; Qerim Lita, *Shqiptarët ortodoksë në Rekë të Epërme dhe shkombëtarizimi i tyre gjatë shekullit XX,* po aty, f. 292-301; Sejdi Gashi, *Reka e Epërme përballë fenomenit të asimilimit gjuhësor e kombëtar,* po aty, f. 336-343.

7 Shih Branislav Sinadinovski, *Rëndësia e krijimtarisë së Josif Bagerit për shqiptarët ortodoks të Rekës së Epërme dhe popullin shqiptar në tërësi, në Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës,* bot. i Universitetit të Europës Juglindore, Gostivar-Shkup 2014, f. 78-83.

8 Branislav Sinadinovski, *Josif Bageri - rilindasi shqiptar,* Tetovë 2013. Idem, *Nga shënimet e babait tim,* dhe *Shqiptarët Ortodoksë të Maqedonisë* (2016). Krhs dhe Rami Kamberi (përg.), *Josif Bageri: 1870-1915 (jeta dhe vepra),* botim i shoqatës *Josif Bageri*, Tetovë 2012.

9 Georgi P. Stamatov (Георги П. Стаматов) e botoi këtë letër në *Ilustracia Ilinden* (Илюстрация Илиндень), Sofia 1913.

10 Anton Pançev, *Shqiptarët e Rekës në fillim të shekullit XX sipas burimeve bullgare, në Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës,* bot. i Universitetit të Europës Juglindore, Gostivar-Shkup 2014, f. 46-55; po aty, Hamit Xhaferi, *Gjurmëve të jetës dhe individualitetit poetiko-letrar të Josif Bagerit,* f. 155-165. Nuk kemi pasur mundësi të këshillojmë kumtesën e Skënder Asanit me titull *Veprimtaria atdhetare e Josif Bagerit sipas gazetës "Avtonomija" të Sofjes* (2011). Këtu meriton vëmendje dhe trajtesa e Rosana Bejlerit, *Josef Bageri në shtypin bullgar* (Tetovë 2011).

11 Lidhur me këtë fazë të hershme të receptimit të poezisë së Josif Bagerit shih: Recension pa emër për librin Kopësht malsori të Josif Bagerit në Dielli e flamuri, Boston 1911; recension pa emër për librin *Kopësht malsori* të Josif Bagerit në *Kalendari Kombiar,* Sofje 1911. Shih dhe *Një gjykim i J. Bagerit për librin "Agimi i gjytetnisë" të Shtjefën Gjeçovit,* pa emër, në *Bashkimi*, Shkodër 1911.

12 Përveç një artikulli jetëshkrimor me titullin Josif Bageri, botuar më 1937 në gazetën Java që dilte në Tiranë, si dhe nënkreut *Josif Bageri* në librin e cituar të papas Gaetano Petrotta-s, shih dhe Peter Elezi, *Josif Bageri*, në *Shkolla shqiptare,* Konstancë 1943; po ai, po aty, *Vepra e Bajram Currit ndër vjersha të Josif Bagerit,* Kostancë 1943.

13 Shih Petraq Pepo, *Katër letra të shkrimtarit demokrat Josif Bagerit,* në *Arsimi popullor,* Tiranë 1962; gjithashtu Mehmet Gjevori, *Portrete letrare: Josif Jovan Bageri,* në *Rilindja*, Prishtinë 1969.

14 Pjetër Janura, *Josif Jovan Bageri,* në *Jehona*, Shkup 1976; Petro Janura, *Josif Bageri poet i mislitjel od Gorna Reka,* në *Naučen Sobir,* Skopje 1978.

15 Bojka Sokolova, *Roli i kolonisë shqiptare të Sofjes për zhvillimin e letërsisë shqipe në kohën e Rilindjes,* Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 1978; gjithashtu Бойка Соколова, Албански възрожденски печат в България, studim monografik, bot. Българска Академия на Науките, Sofia 1979; idem, Албанската възрожденска интелигенция в България, në *Studia balcanica,* nr. 14, Sofia 1987, f. 181-208.

16 *Poezia didaktike e Josif Bagerit* (zgjodhi e përgatiti Nexhat Abazi), bot. *Ylberi plus,* Tetovë 2009.

17 Shih tek Rezehana Hysa, *Veprimtaria kulturo-arsimore e shoqërisë "Dëshira" të Sofjes dhe influenca e Josif Bagerit në përhapjen e arsimit dhe shkollave shqipe në Rekë të Epërme,* botuar në *Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës,* bot. i Universitetit të Europës Juglindore, Gostivar-Shkup 2014, f. 313-331; gjithashtu Shefqet Zekolli, *Josif Bageri - krijues i parë i letërsisë shqipe për fëmijë në Maqedoni,* në *Studime albanologjike,* nr. 10, Shkup 2014, f. 199-207.

18 Më shumë tek Avzi Mustafa, *Llazar Siljani - rekanasi atdhetar dhe intelektual i harruar,* në *Nacional,* e përjavshme letrare e Tiranës, 14 prill 2013.

19 Shih ndër të tjera tek Avzi Mustafa, *Anastas Albanski (Arnaudov) mësuesi nga Reka e Epërme, në Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës,* bot. i Universitetit të Europës Juglindore, Gostivar-Shkup 2014, f. 65-78; gjithashtu dhe Xhelal Jakupi, *Fepatriotizmi i një rekaliu gërçecas: shembulli i Hafëz Rufat Saliut,* po aty, f. 388-399.

20 *Dokumenti është një dorëshkrim i gjetur ne fshatin Niçipur të Rekës së Epërme qe është i vitit 1868. Dorëshkrimi është shkruar nga Joan (Gjon) Serafimi në të folmen shqipe të Rekës. Shih Mustafa Ibrahimi, Rreth disa dokumenteve të shkruara në të folmen shqipe të Rekës me alfabet cirilik, në Shqiptarët e Rekës së Epërme përballë sfidave të kohës,* bot. i Universitetit të Europës Juglindore, Gostivar-Shkup 2014, f. 439-440.

Rruga e Arbërit nr. 135

debat

Vojsava Tribalda pasi u martua me Gjon Kastriotin mori mbiemrin "Kastrioti". Rreth përkatësisë etnike të saj në historiografinë skënderbegiane janë hedhur disa mendime. Shumica e këtyre mendimeve janë të përgjithshme, anësore e pothuajse kanë lënë pa prekur fare problemin, se cila ka qenë përkatësia etnike e familjes së saj.

Rreth përkatësisë etnike të

Nga **HILMI SADIKAJ**

VOJSAVA TRIBALDA pasi u martua me Gjon Kastriotin mori mbiemrin "Kastrioti". Rreth përkatësisë etnike të saj në historiografinë skënderbegiane janë hedhur disa mendime. Shumica e këtyre mendimeve janë të përgjithshme, anësore e pothuajse kanë lënë pa prekur fare problemin, se cila ka qenë përkatësia etnike e familjes së saj. Burime të tjera, sidomos atyre që datojnë nga çereku i fundit i shek. XIX, të gjithë të huaj, duke mos u thelluar në të dhënat mbi të cilat janë mbështetur, por mbi bazën e një vështrimi subjektiv e tepër të sipërfaqshëm, dhanë edhe mendime për një përkatëse etnike sllave të Vojsavës. Kuptohet se këta autorë nuk e kanë pasur plotësisht të qartë se dyert princërore arbëre, deri edhe zotër feudalë më të vegjël, për vite me radhë kishin qenë në kontakt me krerë sllavë, fqinj me prona me ta. Vetë jeta i kishte detyruar që të bashkëpunonin në aspekte politike, ekonomike e ushtarake dhe kishin bërë përpjekje që t'i forconin këto lidhje me krushqi të ndërsjellta. I përkisnin së njëjtës fe ortodokse, merrnin dhe jepnin prika, huazonin zakone e norma zakonore, njihnin gjuhët e njëri-tjetrit, vinin emra që u pëlqenin pa vënë re cilës etnie i përkisnin etj. Kështu që prindërit arbër në pikëpamje territoriale shtriheshin drejt lindjes, deri në rrjedhën e sipërme të lumit Vardar, duke përfshirë: Mokrat e Shkupit, Pollogun e Tetovë-Gostivarit, Ohrin me krahinë, Prilepin, Prespën e Kosturin me krahinë e më gjerë.

Për këto shtrirje të dyerve princërore arbre drejt lindjes mjafton të kujtojmë Hlapenin[1)], vjehrrin e kreshnikut sllav Kraleviq Markos, të shoqin e Helenës, bijës së Hlapenit, që kishte marrë si prikë kur u martua me të Kosturin me rrethinë [2)] Andrea II Muzaka që shtiu në duart e tij këto treva [3)] pas vrasjes së Kraleviq Markos [4)] dhe martesës së tij me të venë e kreshnikut në fjalë, Helenën, të bijën e Hlapenit, me kusht që të lëshonte gruan që kishte (bijën e despotit të Beratit dhe ta merrte atë). Zotëruesi i Dibrave, Ohrit dhe i trevave veriore e lindore të Ohrit ishte Pal Gropa e pasardhësit e tij[5)].

Një mbretëri mjaft të gjerë arritën të krijonin Balshajt, të cilët, duke e pasur qendrën në Shkodër, synonin t'i kthenin në vasalë të tyre të gjithë princërit e tjerë arbër e sllavë përreth. Duhet mbajtur parasysh se shtrirjet ekonomike dhe politike nuk pengoheshin nga përbërja etnike e popullsive të trevave të tyre të zotërimit. Për rrjedhojë zotër arbër dispononin popullsi raja të etnive arbre e sllave, që sipas trevave merrnin edhe emra të veçantë: arbër, tribalë, serbë, bullgarë etj.

Krahas këtyre dy drejtimeve rreth përkatësisë etnike të Vojsava Kastriotit, në gjenealogjinë e Gjon Muzakës (1510) janë sjellë të dhëna që e sqaronin në një farë mënyrë edhe mundësinë e përkatësisë arbëre të saj. Mendojmë se duke qenë përpara fakteve që nuk ishte e nevojshme të parashtroheshin, nuk e përmendnin këtë përkatësi direkt. Kësisoj u dhanë mundësi të tjerëve që ta përmendnin si të papërcaktuar ose, çka solli edhe pasoja për më vonë, që ta përmendnin edhe si me origjinë sllave.

Mendimi ynë për autorët që e lanë pa përmendur etninë arbëre të Vojsava Kastriotit është se ata e dinin se ajo është e asaj etnie. Për rrjedhojë, nuk e ndjenin të nevojshme që ta sqaronin më tej atë. Kronologjikisht për herë të parë për Vojsavën flet Marin Barleti. Ai mjaftohet vetëm duke thënë se ajo ishte e shoqja e Gjon Kastriotit, se ishte e bija e



Vojsava Kastrioti.

princit fisnik të Tribalëve, por nuk thotë se cilës etnie i përkiste.

Në burimet e mëvonshme rreth përkatësisë etnike të Vojsava Tribaldës filluan të bëheshin shtesa e ndonjë ndryshim, por prapëseprapë mbeteshin të përgjithshme e të papërcaktuara qartë të dhënat për të.

Autori i veprës "Punët e ndritshme të zotit Gjergj Skënderbeut"[6)] na jep këtë të dhënë: "... dhe e ëma e Skënderbeut, e quajtur Vojsavë, që e bija e zotit të Pollogut që është pjesë e Maqedonisë dhe e Bullgarisë". Duke e plotësuar të dhënën e Barletit me të dhënën që po e shqyrtojmë, na del se ati i Vojsavës, princi i Tribalëve, zotëruaka krahinën e Pollogut që, siç shihet, është fusha e Gostivar-Tetovës me rrethinat, në rrjedhën e lumit Vardar. Këto treva kanë qenë të banuara prej arbërish e tribalësh (popullsi sllavo-maqedono-bullgare), por zotëritë e tyre feudalë nuk ishte e thënë që do të ishin doemos tribalë. Në rastin konkret familja e prindërit e Vojsavës kanë qenë arbër, pasi, siç thamë më lart, në këtë kohë (çereku i fundit i shek. XIV) ato krahina i zotëronin feudalët arbër.

Edhe Francesko Sansovino përsërit të dhënën e Anonimit (që disa ia atribuojnë Franco Demetros) ku theksohet se Vojsava qe e bija e zotit të Pollogut, që është një pjesë e Maqedonisë dhe e Bullgarisë [7)].

Sikurse mund të konstatojë secili, nuk shohim as ndryshimin më të vogël midis të dhënave të tyre, prandaj edhe nuk kemi çfarë të themi ndonjë gjë më tepër për çështjen që kemi në shqyrtim.

Disa dekada më pas autori Lavardin thotë se e shoqja e Gjon Kastriotit e kishte emrin Vojsavë, e denjë për një burrë të tillë, duke qenë se ishte bija e të shkëlqyeshmit Mbretit të Tribalëve (ose zoti i Pollogut që ishte pjesë e Maqedonisë dhe e Bullgarisë), që porsa i përket mirësisë së saj, zgjuarsisë dhe shprehjeve të saja të shkëlqyeshme, i tejkalonte cilësitë e grave të tjera [8)].

Sikurse shihet edhe Lavardini përsërit të dhënat e Anonimit dhe të Sansovinos porsa i përket faktit se i ati i Vojsavës, ish-zot i Pollogut, që ishte pjesë e Maqedonisë dhe Bullgarisë, por shton disa epitete që bëjnë fjalë për cilësitë e saj individuale si dhe rreth babait të saj, të cilin e paraqet si mbretin tepër të shkëlqyer të Tribalëve.

Më pas edhe Pontano duke u mbështetur si duket tek Lavardini, e konsideron Vojsavën si "bijën e prindit shumë fisnik të Tribalëve" dhe nuk jep asgjë më tepër [9)].

Pothuajse pas një shekulli me këtë çështje u mor R.P.Duponcet [10)], i cili është mbështetur si duket tek autorët që përmendëm dhe jo te Barleti, prandaj e konsideron atë si të bijën e mbretit të Pollogut dhe jo të princit, siç thotë Barleti. Disa vjet më vonë Giammaria Biemmi, Vojsavën e konsideron si të bijën e një zoti të Tribalëve dhe thotë se "sot quhen bullgarë"[11)].

Ndryshimi me të dhënat e autorëve që shkruan para tij qëndron në faktin se ky për Tribalët thotë se qenkan bullgarët e kohës së tij (1742). Megjithatë ne na duhet që parashtresën ta marrim disi me rezervë, pasi në kohën e dhënë nuk duhet të ketë qenë kusht i domosdoshëm që edhe zotëritë feudalë t'i përkisnin gjithmonë etnisë së rajave të tyre e për rrjedhim etnia e tyre jepet e papërcaktuar përfundimisht.

Edhe autori Paganel, Vojsavën e konsideron si të bijën e princit të Tribalëve, pa e përcaktuar përkatësinë etnike të princit në fjalë [12)].

Francesko Tajani, të shoqen e Gjon Kastriotit e quan Vojsava dhe thotë se është e bija e një princi të Tribaleve, siç quheshin bullgarët që zotëronin Bosnjën. Që Tribalët mund të kenë qenë bullgarë është parashikuar edhe nga disa autorë të tjerë, por e thëna se ata paskan zotëruar Bosnjën, gjë për të cilën i referohet Paganelit, nuk qëndron për arsye se ky i fundit nuk ka thënë as se Tribalët janë bullgarë e as se ata të kenë zotëruar Bosnjen[13)].

Konstantin Jireçek mjaftohet të thotë se Pollogu tani (pra në kohën kur jetoi e shkroi ai) është Tetova në Vardarin e Sipërm, kurse rreth përkatësisë etnike, nuk thotë asnjë fjalë[14)].

Krahas autorëve që e lënë të papërcaktuar etninë e Vojsavës [15)] janë edhe disa që i atribuojnë asaj një etni serbe. Kështu J. De Hammer, duke bërë një krahasim midis Olimpias dhe Vojsavës, thotë për këtë të fundit se qenka princeshë serbe (servienne)[16)]. Ne mendojmë se me shprehjen "servienne" nuk duhet të ketë shprehur mendimin e tij për përkatësi etnike, por thjesht për natyrë nga pikëpamja fisnore, me kuptimin: nga një familje e klasave të ulëta shoqërore, fshatare, pasi fjala "servienne" e përmban më tepër një kuptim të tillë që i kanë dhënë autorët që e kanë trajtuar se sa kuptimin "serbe". Pra, gjithnjë sipas nesh, kjo fjalë nuk i është atribuuar për të përcaktuar përkatësinë etnike.

Prof. Karl Hophi, mbështetur në materialet arkivale që konsultoi, edhe ai Vojsavën e paraqet si të shoqen e Gjon Kastriotit, por në kllapa. Pranë emrit të saj ka shënuar emrin "serbe". Kushdo mund ta kuptojë se kjo e dhënë ç'ndikim mund të ketë shkaktuar mbi predisponimin e J. G. V. Hahnit, që konsultoi materialet e Karl Hophit, por edhe te ndonjë tjetër.

Kjo konsideratë nuk përjashton mundësinë që të ketë dalë nga një parashtresë tjetër e tij, që, siç dihet, është përpjekur të krijojë një lidhje midis personit me emrin Branillo, kështjellarit të Vlorës dhe atij me emrin ose mbiemrin "Kastriot" që na jepet si kështjellar i krahinës, sikurse ky Branillo të ketë qenë jo vetëm i pari i familjes "Kastrioti", por edhe "serb"[17)]. Dhe meqenëse për këtë parashtresë nuk i është refuzuar asnjë burimi, ne paraqesim mendimin se autori, duhet të jetë influencuar thjesht nga trajta e jashtme e emrit Branillo, që, siç dihet, është emër serb dhe përdoret kryesisht nga sllavët, pro

histori

Edhe lidhja që konstatojmë tek mbiemri Tripalda ose Tribalda tek Vojsava, dhe titujt e familjes së Markezit të Tripaldës, arbëresh i shpërngulur nga Arbëria për në Itali, përforcon parashtresën tonë se Vojsava Tripalda Kastrioti i përkiste etnisë arbre.

Vojsava Tribaldës "Kastriotit"

nuk përjashtohet mundësi që të përdoret edhe nga banorët me etni të tjera. Siç është argumentuar tashmë nga studiues të tjerë, emri Branillo në funksionin e kështjellarit të Vlorës nuk është as identik, por as që ka ndonjë lidhje me Kastriotin, kështjellar të Kaninës. Por edhe sikur të ketë, përsëri arsyetojmë se vetë emri Branillo, që në shqip do të shkruhej Vrana, fare bindshëm mund të jetë shkruar qëllimisht nga shkruesi sllav i dokumentit serb të Vlorës në vitin 1366, që ka pasur edhe tendenca subjektive me prirje etnike sllave, jo vetëm në bazë të argumenteve të parashtruara, por edhe për sa e sa argumente që kanë paraqitur studiues të tjerë.

Një konsideratë anësore lidhur me përkatësinë etnike të Vojsava Kastriotit, ka shprehur edhe Julius Pisko[18] kur thotë: "Pretendimi i disa historianëve se Kastriotët e kanë origjinë serbe bazën duhet ta ketë në martesën e Gjon Kastriotit me Vojsavën, bijën e një princi të Tribalëve". Siç shihet Pisko Tribalët i konsideron sllavë, e megjithatë kjo nuk do të thotë se edhe zoti i tyre feudal, i ati i Vojsavës të mos ketë qenë arbër.

Fisniku arbëresh Gjon Muzaka, mbi bazën e njohjes individuale të familjes "Kastrioti" lidhjeve martesore të ndërsjella të asaj kohe, por edhe të të dhënave të ndonjë bashkëkohësi, që diçka i tregoi rreth kësaj familjeje, diçka flet për gjenealogjinë që shkroi[19] dhe flet edhe për Vojsavën, duke thënë se "Gjon Kastrioti, i ati i zotit Skënderbeg, pat për grua zonjën Vojsava Tribalda, me të cilën i lindën katër fëmijë meshkuj dhe pesë fëmijë femra". Më tej vazhdon: "E ëma e të thënit zotit Skënderbe, gruaja e të thënit zotit Gjon, pati emrin Vojsava Tribalda dhe vinë nga një derë e fisme".

Të dhënat e Gjon Muzakës rreth Vojsavës janë të qarta, por megjithatë ai nuk e përmend fare përkatësinë etnike të familjes së saj. Nisur nga kjo do të pyesja: E pse do ta trajtonte në kronikën e tij, kur ajo dihej se ishte arbre dhe atij nuk i dilte e nevojshme që ta shprehte atë që në fakt dihej jo vetëm prej tij e prej trashëgimtarëve, pasi ai e paraqet qartë lidhjen midis saj dhe Vrana Kontit. "Ai arbëresh dhe kur u vendos në Itali mori titullin Marchese della Tribalda". Idenë e farefisnisë së Vojsava Tribaldës (Kastriotit) me Vrana Kontin, markezin e Tribaldës, Muzaka na e jep me fare pak fjalë, sa për të shpjeguar se ku konsistonte farefisnia e saj me Vrana Kontin dhe familjen Muzaka, duke thënë se rridhte në linjë lidhjeje femërore. Kështu që. meqë nga Blasio Muzaka lindi zonja Theodora, e cila u martua me Pal Zardarin, të birin e Vug Zardarit dhe nga kjo martesë lindi zonja Marie, e cila u martua me Vrana Kontin, dukë i Ferrandinës dhe markez i Tribaldës dhe meqenëse Maria ishte mbesë Muzakajsh në linjë femërore dhe meqenëse nuk la trashëgimtar dhe pronat e saj mbeteshin pa zotërues, pasardhësit e tij duhet ta dinin se u përkisnin atyre, Muzakajve. Kështu del shpjegimi pse Vojsava edhe Vrana Konti mbanin të njëjtin mbiemër, Tripaldi, por njëkohësisht jepet edhe etnia e tyre arbre, pasi dihet mirë se së paku Vrana Konti ishte arbër i pastër.

Kështu në shtesën që i bëhet kronikës së Gjon Muzakës, duke vënë kujtimet e të birit të tij Konstandinit, që edhe ai ua lë pasardhësve të vet[20], Vojsava jepet si bija e Momçinit, që u bë shoqja e Ivanit, të cilëve u lindi Gjergj Kastrioti. Pra, Vojsava ishte nga një degëzim i familjes princërore arbre të Muzakajve[21].

Fan S. Noli në librin e parë që shkroi për



Tradita gojore thotë se princi i Vojsavës, princi i Pollogut, e me rrjedhën e viteve edhe pasardhësit e njerëzit e afërt të tij, familjarë e jo familjarë, nga represionet e ushtrive osmane, meqenëse gjendeshin në trevat skajore të principatës ose zotërimit, u tërhoqën në mënyrë masive drejt perëndimit dhe u vendosën në brendësi të Arbërisë, në fshatin Guri i Bardhë të rrethit të Matit, zotërim e kështjellë e Gjon Kastriotit. Ky ngulmim i madh arbëreshësh, të dalë nga krahina e Pollogut dhe e vendosur në Gurin e Bardhë, ruajtën për shekuj disa karakteristika që i dallonin disa nga popullsitë e fshatrave të tjerë të Matit, kryesisht në veshje të grave, zakone, folklor, krushqitë i bënin vetëm brenda fshatit të vet.

Skënderbeun (1921) thotë se: "Gjon Kastrioti ishte martuar me princeshën Vojsava, të bijën e princit të Pollogut, një krahinë midis Gostivarit dhe Shkupit". Kjo krahinë dukej se ishte pjesë e perandorisë së Balshajve dhe hynte nën influencën e Kastriotëve. Ndenjësit e saj Barleti i quan Bullgarë, por Noli thotë se "princërit e saj mund të ishin shqiptarë që nga koha e Balshëve". Noli për këtë konkluzion u referohet kronologjikisht sipas kohës që kanë shkruar, burimeve si: Barleti, Anonimi, K.I.Fl, Veneti, 1545, Muzakës f. 295-301 dhe shpreh mendimin se (Muzaka) "është i vetmi që na e jep llagapin e Vojsavës duke e quajtur Tripalda e Tribalda". Gjithnjë sipas tij, ky "llagap ujdis shumë me fjalën Triballë" (Bullgarë). Por në qoftë se ai do të ketë qenë llagapi i vjetër i shtëpisë së saj, atëherë nuk kemi pse ta konsiderojmë fare se tingëllueka sllavisht, pasi edhe Andre Engjëll Flav Komnen e nxjerr nga familja e Muzakajve, kështu që duhet të ketë qenë shqiptare e kulluar. Por, për këtë çështje nuk bën fare fjalë Gjon Muzaka vetë. Megjithatë ky i fundmi na thotë se një princ shqiptar me titullin "Markez" di Tribalda, i cili rronte në Itali pas vdekjes së Skënderbeut, kishte gjak prej Muzakajve[22].

Mendimi ynë është se Fan S. Noli nuk u angazhua përfundimisht dhe prerë e sa duhet për këtë çështje dhe të na sillte një konkluzion të prerë.

Marin Sirdani shpreh konsideratën se "legjenda e sllavësisë së familjes Kastrioti sipas Piskos e Fallmerajerit e ka rrënjën tek princesha Vojsava e Pollogut me të cilën u martua Gjon Kastrioti, kurse Thaloczy dhe Jireçek e zanë shqimit përrallë sllavësinë e Kastriotëve" [23]. Siç shihet, ky autor vetëm sa e përmend princeshën Vojsava të Pollogut me të cilën u martua Gjon Kastroti dhe nuk thotë asnjë fjalë rreth përkatësisë së saj etnike. Por kur përmend parashtresat rreth kësaj çështjeje të Thaloczyt dhe të Jireçekut, kuptohet se duke dalë kundër përkatësisë sllave të Vojsavës, pranon plotësisht përkatësinë e saj arbre.

Dr. Gaspr Jakova Meruri thotë: "U martua me Vojsavën të bijën e N. N. zotit të Pollogut rajon i Maqedonisë fqinje me Bullgarinë" dhe jo (se ka qenë – H. S.) e bija e mbretit të Bullgarisë, siç kanë parashtruar disa[24]. Siç shihet parashtresa e tij është e matur dhe e mbështetur në të dhënat burimore të paraqitura para tij, por kur konstaton se në të ka të dhëna të papërcaktuara apo edhe të pasakta ndërhyn dhe sqaron se nuk është dakord që Vojsava të ketë qenë e bija mbretit të Bullgarisë, siç thonin të tjerët. Kësisoj len mundësinë që të diskutohet më tej rreth përkatësisë etnike të saj.

Disa vjet pas Alessandro Cutolo rreth kësaj çështjeje thotë: "Gjoni mori për grua princeshën Vojsava, të bijën e një kreu tjetër shqiptar të shkëlqyer, zotit të Pollogut...". Siç shihet ky autor thotë shprehimisht se zoti i Pollogut, babai i zonjës Vojsava, gruas së Gjon Kastriotit, ishte njëri nga krerët arbër të shkëlqyer [25]. Fan S. Noli në punimin e tij të dytë mbi Skënderbeun thotë: "Ai (bëhet fjalë për Gjon Kastriotin – H. S.) u martua me Vojsava Tripaldën e Pollogut". Për këtë të dhënë tepër të rëndësishme i referohet Hophit, Chroniques 301. Duke vazhduar të trajtojë f.308 të Chroniques, shton: "Muzaka thotë se Vojsava ishte shqiptare nga familja e Muzakajve" [26]. Por si duket për t'u paraqitur sa më tolerant, për mendimin tonë pa qenë nevoja, sepse i duket ndoshta jo aq bindëse parashtresa që sapo përmendëm, citon në vazhdim Barletin me parashtresën e tij tepër të përcaktuar dhe që u ka lënë shteg sa e sa interpretimeve të diskutueshme se Vojsava është bija e zotit të Pollogut, që është një pjesë e Maqedonisë dhe Bullgarisë dhe në vazhdim citon Jireçekun që e lokalizon Pollogun në Tetovë, në Vardarin e Sipërm.

Sipas mendimit tonë, citimi i këtyre burimeve nga ana e Fan S. Nolit, lidhur me përkatësinë etnike të Vojsava Tribaldës (Kastrioti), është prirur, çka është e logjikshme, për një qëndrim diskutues, sepse edhe pasi përmendi sipas Chroniques Greco-Romanes, shqiptarësinë e saj, Vojsavës, na jep edhe këto dy parashtresa të përgjithshme e të papërcaktuara. Kështu nuk të imponohet sa e si duhet, sidomos po të marrim më konsideratë vargun e parashtresave të tjera, që gjithashtu këtë të dhënë e trajtojnë si tepër të përgjithshme dhe të papërcaktuar si duhet në radhë të parë për mungesë njohjeje të trevës dhe mundësisë së administrimit të saj feudal të populluar nga arbër e tribalë por në pronësi të zotërve arbëreshë.

Duke konkluduar në shprehim mendimin se jo vetëm nga sa jep Konstandin Muzaka, që mbështetet në Gjenealogjinë që i dërgoi Andrea Engjëll Flav Komneni, por edhe në disa faktorë të tjerë që duhen marrë në konsideratë, për shembull siç ishte mundësia që zotërit Arbër të kenë qenë shtrirë gjatë shekujve XIII-XIV, por edhe më parë edhe në trevat lindore të Arbërisë, në hapësirat deri në lumin Vardar dhe në trevat fqinje me to, pavarësisht se popullsia ishte mikse: arbre dhe tribale, zotëruesit feudalë kanë qenë arbër nga dyert e Balshajve, Gropajve, Muzakajve, Kastriotëve etj.

Edhe lidhja që konstatojmë tek mbiemri Tripalda ose Tribalda tek Vojsava, dhe titujt e familjes së Markezit të Tripaldës, arbëresh i shpërngulur nga Arbëria për në Itali, përforcon parashtresën tonë se Vojsava Tripalda Kastrioti i përkiste etnisë arbre.

Tradita gojore thotë se princi i Vojsavës, princi i Pollogut, e me rrjedhën e viteve edhe pasardhësit e njerëzit e afërt të tij, familjarë e jo familjarë, nga represionet e ushtrive osmane, meqenëse gjendeshin në trevat skajore të principatës ose zotërimit, u tërhoqën në mënyrë masive drejt perëndimit dhe u vendosën në brendësi të Arbërisë, në fshatin Guri i Bardhë të rrethit të Matit, zotërim e kështjellë e Gjon Kastriotit. Ky ngulmim i madh arbëreshësh, të dalë nga krahina e Pollogut dhe e vendosur në Gurin e Bardhë, ruajtën për shekuj disa karakteristika që i dallonin disa nga popullsitë e fshatrave të tjerë të Matit, kryesisht në veshje të grave, zakone, folklor, krushqitë i bënin vetëm brenda fshatit të vet. Gjithashtu, në këtë fshat, por për raste edhe më në thellësi drejt fushës së Tiranës, që herët, në shek. XV-XVI ka qenë e fortë tradita fetare katolike që u transmetua brez pas brezi deri sa u myslimanizuan. Mjafton të përmendim Pjetër Budin dhe një varg prelatësh që shërbyen jo vetëm në fshatin e tyre (Guri i Bardhë), por edhe në Martanesh, edhe në fshatrat e tjerë rreth e rrotull.

LITERATURA

1) Jorga, N. Breve, Histoire de l'Albanie et dy people Albanaise, Bucarest, 1919, VIII, pag. 38.
2) Po aty.
3) Hopf, K. Chronique Greco-Romanes, pag. 281.
4) Du Cange, po aty.
5) M. Barleti, Historia et gestis de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis, liber primus, pag. II, Orige et genus Castriotea familiae...
6) Anonimi, "Punët e ndritshme të zotit Gjergj Skënderbeut", 1539, f. 102.
7) Sansovino Francisco, Historia Universale, 1568.
8) Lavardin, Histoire de Georges Castriot, Syrnome Scanderbeg, roy d'Albanie, Paris, 1577.
9) Pontano, Scanderbegus, Hanoviae, 1609.
10) Duponcet, R. P., Histoire de Scanderbeg, Roz d'Albanie, Paris, 1709, Libre premiere, p. 6.
11) Biemmi, G. Histoire Scanderbegi... Venedik, 1742, f. 124.
12) Paganel, G., Histoire Scanderbeg, roy d'Albanie, Paris, 1855, f. 2.
13) Tajani, Fr., Istorie Albanesi, 1866, f. 54.
14) Jireçek, K., Geschichte der Serben, vëll. II, Gotha, 1918, f. 6.
15) Hammer, J. D., Historire de l'Empire Ottoman, përkthim nga gjermanishtja prej J. Hellert, Paris, 1835, f. 339.
16-17) Hopf, K., Chroniques.., f. 304, 532.
18) Pisko, J., Scanderbeg, Vjenë, 1894, Kap. I, f. 3.
19-21) Hoph, K. Chroniques..., f. 301, 304, 307.
22) Noli, F. S., Historia e Skënderbeut, Gjergj Kastriotit, Boston, 1921, f. 57.
23) Sirdani, M., Skanderbegu simbas gojëdhënash, Shkodër, 1926, f. 2.
24) Jakova, G. Marturi, L'Albanie Nouvelle, vjeti i parë i fevrier 1932, nr. 2.
25) Cutolo, A., Scanderbeg, Milano, 1940, f. 20.
26) Fan S. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, (1405-1468), New-York 1947, përkthyer shqip nga shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1967, kap. II, Fillime legjen.

Marrë nga libri "Dibra dhe etnokultura e saj", V.I, f. 127-134. Botuar nga Lidhja e Historianëve Shqiptarë Dibranë. Shtypur në shtypshkronjën "Luma", Tetovë 1995.

Rruga e Arbërit nr. 135

intervista

Jonida, logopedja pioniere e Dibrës



Intervistë me Jonida Trupen, pedagogen e logopedisë në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë

Nga **SAMET ZAGRADI**

JONIDA TRUPJA është një ndër logopedistet e para të Dibrës. Ajo është nga Staraveci. Arsimin e mesëm e ka kryer në shkollën e mesme "Said Najdeni" në Peshkopi, ndërsa studimet e larta i ka kryer në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike , në programet e studimit Bachelor dhe Master Shkencor në degën Logopedi. Gjatë viteve të studimit ka qenë e angazhuar me punë vullnetare pranë organizatës "Përtej Barrierave", po në Tiranë. Fillimet e karrierës i ka në qytetin e Peshkopisë, menjëherë pas përfundimit të studimeve, ku filloi të ushtrojë profesionin si logopediste. U bë pjesë e stafit akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" - filiali Peshkopi. Aktualisht vazhdon të ushtrojë profesionin e saj, por paralelisht punon edhe si pedagoge me kohë të pjesshme pranë Universitetit të Mjekësisë, në fakultetin ku u diplomua.

- Si është të qënit pedagoge dhe cila është marrëdhënia juaj me studentët?

- Shumë shpejt u bëra pjesë e auditoreve, por tashmë për një tjetër qëllim. Të dy eksperiencat për mua janë një fillim i mirë dhe më kanë dhuruar ndjesi shumë pozitive. Në rastin e parë kanë qenë emocione të papërshkrueshme për vetë faktin që një eksperiencë me përgjegjësi të madhe mu dha mundësi ta jetoj në vendlindjen time, ku në fakt ka marrë fill çdo eksperience e imja deri më sot. Ndërsa fakulteti ku u diplomova dhe sot jam pjesë e stafit, mbart kujtime në çdo auditor ku mora dijet e para profesionale. Në këtë fakultet kam pasur fatin që të kontribuojnë në formimin tim pedagogë të mrekullueshëm që për mua janë modele për tu ndjekur. Është privilegj dhe përgjegjësi shumë e madhe të jem në mesin e profesorëve dhe doktorëve të afirmuar në fushën e mjekësisë.

Studentët kam pëlqyer ti trajtoj si kolegë dhe jam përpjekur të jem sa më e drejtë me ta, qoftë në mësimdhënie, vlerësim dhe në mirëpritjen e mendimeve të tyre, për ta bërë marrëdhënien tonë sa më produktive. Një pjesë e tyre sot janë pjesë e rrethit tim shoqëror edhe pse ka përfunduar raporti ynë pedagogë-student.

- Ju jeni Logopediste dhe njëkohësisht po e ushtron këtë profesion. Sa nevojë ka Dibra për logopedistë?

- Logopedia është program studimi relativisht i ri në Shqipëri, prandaj shërbimi lodopedik mungon në shumë qytete, gjithashtu edhe në Dibër. Logopedia merret me problemet dhe defektet e të folurës, dhe nevoja për këtë shërbim është e madhe pasi në mungesë të profesionistëve që mund ti mbulojnë të gjithë rastet, qytetarë të Dibrës i drejtohen qyteteve të mëdha si Tirana ku dhe dyndja e profesionistëve është më e madhe. Megjithatë, përgatitja e vazhdueshme e brezave të rinj jep shpresë për një mbulim më të gjerë institucional të këtij profesioni. Logopedia së fundmi ka marrë një hov të madh zhvillimi dhe vetë komuniteti po ndërgjegjësohet për rëndësinë e ndërhyrjes logopedike, në mënyrë të tillë që rehabilitimi i çrregullimeve të gjuhës dhe komunikimit si pasojë e shkaqeve të ndryshme të bëhet sa më herët të jetë e mundur.

- Sa e vështirë është të jesh e suksesshme në Dibër?

- Të rritur nën ndikimin e një mentaliteti si në të gjithë qytetet e vogla, çdo lloj fillimi mund të jetë i vështirë për një femër. Por ne mund t'ja dalim edhe kur përballemi me faktorë të tillë jo favorit . Vitet janë dëshmi e shumë vajzave të suksesshme në Dibër. Për mua suksesi në karrierë i një femre, besoj varet nga mbështetja që ajo merr nga familja dhe miqtë. Edhe pse është ende shumë herët për të folur për një karrierë të suksesshme, unë sot jam pasqyrë e motivimit, mbështetjes dhe besimit të familjes time në çdo hap që kam hedhur, besoj si çdo prind për fëmijën e tij, qoftë vajzë apo djalë. Diferenca që po shuhen dita-ditës edhe në qytetin tonë.

- Në qoftëse se do të ishte në dorën tuaj, cilat do ishin gjërat e para që do doje të ndryshoje në komunitetin tonë ?

- Nëse do të ishte në dorën time, do krijoja më shumë hapësira për të rinjtë dibranë, të cilët janë një potencial i fuqishëm zhvillimi. Projekte dhe mundësi punësimi ku të shfaqeshin idetë dhe aftësitë e tyre, të vlerësohej iniciativa dhe dëshira për të kontribuar në zhvillimin e qytetit të tyre. Besoj se ndryshimi fillon nga secili prej nesh.

- Sa vend zënë librat, muzika dhe filmat në jetën tuaj. Cilët janë të preferuarit?

- Unë udhëtoj shumë për shkak të punës kështu muzika është pjesë e pandashme e ditës time. Pëlqej zhanre të ndryshme të muzikës dhe dëgjoj këngëtarët më të zë të momentit. Ndërsa literatura artistike tashmë i ka lënë hapësirë literaturës që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën time, dhe që më shërben për formimin e mëtejshëm profesional. Kohën e lirë më pëlqen ta kaloj mes miqve dhe të afërmve për tu shkëputur pak dhe nga teknologjia.

- Thuaj dy fjalë për rinin dibrane.

- Të rinjtë dibran sot i gjen pjesë të rrjeteve të ekselencës në universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Shumë prej tyre japin kontribut në sektorin publik e privat në tregun e punës. Unë besoj se duke e dashur fortë atë që bëjmë, qoftë profesion apo zanat, ne mund të arrijmë sukses për veten, Dibrën dhe dibranët. Edhe pse në dukje mundësit që të ofron qyteti i Peshkopisë janë të pakta, forca jonë e mendimit duhet të jetë baza e ndryshimit.

- Si ndiheni të intervistoheni si një shembull për rinin dibrane dhe jo vetëm?

- Duke ju falënderuar për konsideratën, ndjehem e privilegjuar të jem pjesë e kësaj rubrike dhe të shihem si shembull për të rinjtë. Ju përgëzoj dhe ju si gazetë për një dritare të tillë promovimi dhe motivimi për të rinjtë dibranë. Suksese në punën tuaj!

Faton Daci, fizioterapisti i Dibrës



Nga **SAMET ZAGRADI**

FATON DACI është mjek fizioterapist, i cili e ushtron profesioni e tij me shume pasion dhe dëshirë. Është themeluesi i Shoqatës Shqiptare të Fizioterapisë, e cila që prej vitit 2012, ka organizuar mjaft veprimtari të suksesshme, si kongrese ndërkombëtare dhe trajnime për fizioterapistët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në rajon. Gjithashtu, klinika dhe trajtimi i pacientëve janë pjesë e punës së përditshme, një pune e cila i jep kënaqësi kur shikon përmirësimin e gjendjes së pacienteve. Ndërkohë, mes këtyre angazhimeve, gjen edhe kohën për të dhënë mësim në universitet, për të kontribuar në edukimin e brezave të rinj të fiziterapistëve. Por përtej profesionit dhe angazhimeve profesionale, mbi të gjitha Fatoni është një djalë i ri, i cili e shijon jetën në maksimumin e saj. I pëlqen të kaloj kohë e lirë mes veprimtarive fizike, siç janë sportet, palestra dhe vrapi buzë detit që është një "terapi" shumë relaksuese.

- Ju keni studiuar në Bullgari? Cilët kanë qenë vështirësitë e tua?

- Studimet i kam kryer në vitet 2003-2010 në Bullgari në Universitetin Mjekësor të Plevenit. Vështirësitë që kam hasur kanë qenë ato që çdo student kalon gjatë viteve të studimeve. Por duke shtuar edhe faktin që isha në një vend të huaj, kjo do të thotë më shumë kohë për t'u përshtatur me kulturën dhe mentalitetin e tyre. Gjithsesi, jam një person i cili integrohet lehtësisht dhe kjo ka qenë në avantazhin tim. Suksesi në studimet ka qenë si rezultat i dedikimit dhe përkushtimit tim të vazhdueshëm.

- Sa i vështirë dhe sa fitimprurës është profesioni fizoterapistit në Shqipëri?

- Profesioni i fizioterapistit, sidomos në Shqipëri dhe diasporë, është relativisht i ri, ose ka marrë më shumë zhvillim gjatë dy dekadave të fundit. Për këtë arsye është dashur një punë ndërgjegjësuese për masën e gjerë të opinionit publik. Gjatë këtyre viteve në Tiranë, ne si SHFSH kemi punuar fort dhe i kemi dhenë prioritetin e duhur integrimit të profesionit të fizioterapistit në fushat përkatëse të mjekësisë. Investimi jonë në trajnime, kongrese dhe aktivitete formuese për fizioterapistët ka funksionuar pikërisht për t'i dhenë fizioterapisë vendin që i takon në aplikimin e saj të domosdoshëm për rehabilitimin dhe trajtimin e pacientëve. Mund të them me plot bindje se është një profesion sa i bukur dhe sfidues, aq edhe shpërblyes ne aspektin e kënaqësisë të punës dhe atë në vlerë monetare. Por kjo padyshim qe kërkon impenjim, dedikim dhe investim të vazhdueshëm në fushën e studimeve të fizioterapisë si një nga shkencat mjekësore të aplikuara.

- Ju jeni pedagog në Universitetin Amerikan të Tiranës? Cila është marrëdhënia juaj me studentët?

- Aplikimi i fizioterapisë në aspektin akademik është një investim i mirë për të formuar breza të denjë dhe të aftë studentësh në këtë profesion. Përtej marrëdhënies strikte dhe tradicionale akademike, unë personalisht kam zgjedhur edhe një rol tjetër me studentet e mi, atë të një profesionisti dhe këshilltari të mirë, por edhe rolin mbështetës për t'i integruar studentët që gjatë viteve të studimeve në praktika mësimore në klinikat ku unë punoj. Njëkohësisht, studentët i trajtoj si kolegë kur ata i angazhoj jo vetëm në praktikë në klinikë, por edhe në aktivitetet e shumta që zhvillon FSHF. Besoj se kjo lloj marrëdhënie e afërt dhe trajtimi i studenteve si kolegë, i motivon ata që të japin maksimumin gjatë studimeve në fizioterapi. Gjithashtu, unë jam shumë i gatshëm t'i informoj dhe të këshilloj studentet për të rejat në fushën e fizioterapisë dhe specializimet që ata duhet të ndjekin pas përfundimit të studimeve.

- Cilin do të falënderoje për suksesin tuaj?

- Suksesi asnjë herë nuk vjen nëse nuk ke mbështetjen e personave të duhur në jetë. Për këtë arsye, edhe unë gjej rastin të shpreh falënderimet e mia të përzemërta për familjen time, e cila më ka mbështetur në çdo hap të jetës. Nuk mund të le pa përmendur edhe mirënjohjen time për kolegët e mi, për pedagoget e universitetit, si edhe për të gjithë bashkëpunëtorët e projekteve që kemi zhvilluar gjatë këtyre viteve. Një falënderim të madh për të gjithë pacientet që kam patur rastin të trajtoj gjatë gjithë këtyre viteve eksperience, për besimin e tyre.

- Dibra mbetet gjithmonë me ju. Çfarë do të doje të ndryshoje në vendlindjen tuaj?

- Karriera ime si fizioterapist ka filluar në qytetin tim te lindjes, në Dibër. Unë kam punuar për gati 2-3 vjet, dhe atje kam patur fatin e mirë të bashkëpunoj me një staf të shkëlqyer mjekësh dhe kolegesh. Kam shumë kujtime të mira prej kësaj përvoje dhe për këtë arsye kam shumë dëshirë që në të ardhmen të kthehem sërish dhe të investohem në profesionin e fizioterapistit në qytetin tim, në Dibër.

Me Dibrën jam i lidhur ngushtë, është qyteti ku kam lindur, jam rritur dhe kam hedhur hapat e para drejt suksesit në karrierë. Por njëkohësisht, Dibra është qyteti ku kam shumë kujtime, eksperienca dhe ku aktualisht jeton familja ime. Kur flas për Dibrën ndjej shumë nostalgji. Në atë qytet kam plot miq, shokë, familjarë dhe njerëz që i vlerësoj.

Personalisht, mendoj se Dibra ka shume potenciale për t'u zhvilluar në disa drejtime, qoftë atë ekonomik, social-kulturor dhe turistik. Qytetarët e Dibrës dhe bashkëkombësit e mi janë njerëz me vlerë dhe jam i bindur që në një të ardhme të afërt do japin kontributin e duhur, që ky vend të përmirësohet dhe të ofrojë më shumë punësim, shërbime cilësore mjekësorë, arsimim, dhe mundësi argëtimi dhe formimi për të rinjtë.

aktualitet

Dhunohet busti i atdhetarit Mersim Dema

Policia po heton rastin. Banorët mendojnë se e ka shkulur era. Institucionet indiferente.

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Në një nga mëngjeset e meskorrikut 2017, Shupenza, njësia administrative me të njëjtin emër e Bashkisë Bulqizë, është zgjuar duke u përballur me një ngjarje aspak të këndshme e përçudnuese, atë të heqjes së kokës të bustit të atdhetarit dhe patriotit të shquar të kësaj zone, Mersim Dema. Natyrisht që një ngjarje e tillë, ka shokuar banorët, pasi në një situatë normale, një gjë e tillë nuk do ti shkonte askujt ndër mend që mund të ndodhë. Busti i vendosur në qendër të Shupenzës, përball me godinën e njësisë administrative dhe Postën e Policisë, vetëm rreth 5 metra larg tyre, të ndara vetëm nga rruga nacionale Shupenzë-Peshkopi, ngjitur me oborrin e shkollës së mesme, kurrsesi nuk jepte shkas, qoftë edhe për një mendje sado fantaziste, se në një ditë vere si kjo e meskorrikut, të mund të binte pre e dhunimit. Nuk mund të mendohet se një figurë e tillë patriotike, si e Mersim Demës, me të cilën krenohet Shupenza, Homeshi dhe gjithë zona e Grykës së Vogël dhe më gjerë, e përjetësuar simbolikisht në këtë lapidar, të mund të binte pre e dhunimit, me kokën e rrëzuar përtokë, mes pluhurit dhe papastërtive. Gjë kjo me të vërtetë skandaloze dhe e papranueshme, sido që të ketë ndodhur.

KUJTESË: MERSIM DEMA - "MBRETI I MALEVE"

Lindur më 1864 në njërën prej familjeve të fisit të madh e të njohur të Demajve, në fshatin Homesh, Mersim Dema gjithë jetën e tij punoi e luftoi për atdheun, si një udhëheqës i shquar i forcave kryengritëse popullore dibrane. Ja si e portretizojnë patriotin Mersim Dema, tregimtarët gojorë: "Mersim Dema, në kohën kur jetoi e veproi ka ecur me pushkë në krah dhe abetare nën sqetull me parullën "Liri a vdekje". I përkushtuar në riorganizimin e kuvendeve tradicionale të Maleve të Dibrës, që kurrë nuk e njohën pushtetin osman, por i rregulluan marrëdhëniet shoqërore mes tyre sipas të drejtave zakonore, Mersim Dema u cilësua për kohën që jetoi e punoi si "Mbreti i Maleve". Princi gjerman Vilhelm Vidi, i ardhur nga Fuqitë e Mëdha në fronin e Shqipërisë më 7 Mars 1914, në një takim që ka zhvilluar në Durrës me krerët më në zë të Shqipërisë, në korrik të 1914, ku ka marrë pjesë edhe Mersim Dema, si përfaqësues i Dibrës, në një audiencë të veçantë që rezervuan me këtë rast për të, Princi dhe Princesha, pasi janë njohur me veprimtarinë e tij, Vidi i është drejtuar Mersimit me fjalët: - "Unë jam Princi i Shqipërisë, por "Princi i Dibrës" qenke ti".

Kujtojmë se gjatë viteve 1895-1900 malësorët e Grykës së Vogël nën udhëheqjen e Mersim Demës zbrapsën disa ekspedita turke. Po gjatë kësaj periudhe Mersimi mbajti lidhje edhe me klubet dhe organizatat e fshehta, që ishin formuar për të ndihmuar çështjen kombëtare. Zotëronte kulturë të përgjithshme, ushtarak me gradë oficer, gjë që për kohën ishte e veçantë, pasi nuk mund ta dispononte kushdo. Ja si betoheshin malësorët e Grykës së Vogël, që bëheshin pjesë e formacioneve të tij luftarake, një betim ky i veçantë, formuluar dhe zbatuar nga Mersim Dema: "Për këtë që kam përpara (Kuranin), me këtë që kam në dorën e djathtë (pushkën), do të mbroj këtë që kam në të majtë (flamurin kuq e zi me shqiponjën dy krenore në mes). Duhet theksuar se vetëm nën kryesimin e Mersim Demës deri në vitin 1905 ishin zhvilluar në Grykën e Vogël gjashtë kuvende (ish parlamente të kohës), dy tek Varret e Shupenzës, tre tek Gurra e Mazhicës dhe një tek Gropat e Ujkut mbi Homesh.

RETROSPEKTIVE. PËRURIMI I BUSTIT

Më 27 korrik 2010, qindra banorë të zonës, por edhe të ardhur nga Dibra, këndej dhe andej kufirit, Mati etj, si dhe treva të tjera brenda dhe jashtë vendit, deri edhe të ardhur nga Amerika, përfshirë edhe unë shkruesi i këtyre radhëve në cilësinë e gazetarit, morën pjesë në përurimin e vendosjes së bustit të atdhetarit Mersim Dema, në qendër të ish komunës Shupenzë. Ishte dhe do të mbetet kjo ditë, vërtet e paharruar për banorët e Grykës së Vogël dhe më gjerë, pasi vendosja në vendin e duhur dhe plotësisht të meritуar e bustit të këtij patrioti, mbartëte në vetvete simbolikën mjaft të spikatur për ta, atë të atdhedashurisë, duke i dhënë kështu vlera ndër breza krenarisë atdhetare të banorëve të kësaj treve.

"Ndoshta jemi pak vonë, në nderimin e kësaj figure, u shprehen banorët që morën pjesë në këtë përurim, por gjithsesi mirë u bë, pasi një fjalë e urtë thotë: "më mirë vonë se kurrë".

"Nderimi që i behet Mersim Demes, tha atëherë në fjalën e përshëndetëse, ish kryekomunari i Shupenzes, Moiz Llani, është nderim për të gjithë komunitetin tonë, pasi gjithë jetën e tij, ai punoi e luftoi për liri e pavarësi të atdheut".

E kush mund ta mendonte se plot pas 7 viteve, në mëngjesin e një dite vere korriku 2017, busti i Trimit të Maleve, të gjendej i thyer e rrëzuar përdhe.

OPINIONET E BANORËVE DHE INDIFERENCA E INSTITUCIONEVE

Ishte një telefonatë nga Lushnja ku Sadi Dema, stërnip i Mersim Demës, i cili së bashku me vëllain e tij, Ali Dema, u bënë promotorë për vendosjen e bustit në qendër të ish komunës Shupenzë, që më bënë me dije për dhunimin e bustit. Natyrisht, ai me mjaft shqetësim më bëri me dije për ngjarjen e rëndë dhe shokuese, ku më kërkon në cilësinë e gazetarit, që ta verifikoj këtë ngjarje për ta pasqyruar.

Si ka ndodhur, kush, pse? Kush mund të dhunojë monumentet me vlera atdhetare e kulturore? Kush mund të cënojë pa ju dridhur dora dhe qerpiku, monumentet e vlerave të krenarisë së komunitetit të Grykës së Vogël, por edhe më gjerë, përveçse një mendje e fandaksur dhe e çmendur? Kë cënoi busti, përveçse rriti moralin e krenarisë kombëtare të zonës? Mos kemi të bëjmë me rast të cënimit të pronës private? –Jo dhe jo, pasi busti është vendosur në anë të gardhit rrethues të shkollës së mesme dhe ngjitur me murin mbajtës të rrugës automobilistike, që jo vetëm nuk cënon asnjë centimetër tokë bujqësore, por vetëm se zbukuron dhe hijeshon qendrën e Shupenzës.

Asgjë nuk zinte vend në mendimet e mia, për të gjetur një arsye çfarëdo për t'i dhënë zgjidhje enigmës së cënimit të monumentit. Për dreq këto pyetje dhe mjaft të tjera si këto, më shoqëruan gjatë asaj nate, kur dhe mora lajmin nga Sadiu, për dhunimin e bustit. Nuk di të them me saktësi se kur më zuri gjumi dhe sa fjeta atë natë. Të nesërmen në mëngjes nuk e bëj të gjatë, por nisem drejt Shupenzës. Zbres në qendër dhe çapis drejt monumentit. Ç'të shikoj! Monumenti kishte



mbetur pa bustin e patriotit! Koka dergjej në tokë, mes pluhurit e papastërtive, e thyer dhe copëtuar nga thërmimi i allçisë. Banorët lëviznin si në një ditë rutinë të zakonshme për ta, pavarësisht se mua më dukej sikur çdo gjë aty kishte ndaluar.

Futem në një nga internet kafenetë, aty në qendër, në anë të godinës së Njësisë Administrative, të cilën e menaxhon një miku im. Ulem në të vetmen tavolinë bosh që gjej në lokal, ku nuk vonon të vijë pronari, miku im A. C.

–Miku nuk pyetet përse ka ardhur, nis bisedën ai. Por unë e di përse ke ardhur, për shëmtinë me bustin. Pasi miratoj me kokë, ai vijoi:

"Ngjarja vërtet ka ndodhur në errësirë gjatë natës, por të jesh i sigurt se ajo nuk ka ndodhur nga duar njerëzore, por aksidentalisht nga një ciklon me erë të fuqishme. –Teksa po e vështroja i dyzuar, ai më thotë: - Eja të shkojmë së bashku të shikojmë dhe do të bindesh se ngjarja ka ndodhur krejt aksidentalisht. Do të doja të ishte ashtu, sepse do të çlirohesha nga makthi që më kishte mbërthyer, pasi asgjë nuk më ngushullonte po të kishte ndodhur ndryshe. –Vërtet busti ishte i derdhur në allçi dhe jo në bronx, siç dhe u tha gjatë përurimit të tij në korrikun e 2010, si dhe nuk kishte qoftë edhe një shufër hekuri, që të lidhte bashkë bustin me piedestalin e vendosjes së tij, gjë kjo që e kishte bërë të mundur që era e fortë e asaj nate të zezë, të mund ti ndante ata nga njëri-tjetri.

–Gazetar! –mu drejtuan disa nga banorët e rastësishëm që takova. -As mos të të shkojë ndër mend, se rrëzimi i bustit, mund të ketë ardhur nga vënia e dorës së njerëzve.

Drejtohem në zyrat e njësisë administrative Shupenzë, për të marrë informacion zyrtar në lidhje me këtë ngjarje aspak të zakontë. Çuditërisht në kundërshtim me sensibilitetin që ka shkaktuar ngjarja për banorët e kësaj zone, për zyrtarët vendor nuk ka shkaktuar asnjë lloj ndjesie e interesimi, madje ka prej tyre që ende nuk janë njohur me të. Dy zyrtarë të kësaj njësie, të pyetur për ngjarjen, rrudhin krahët dhe përgjigjen; - jo nuk dimë gjë edhe pse ngjarja kishte ndodhur përball godinës ku ata punojnë vetëm 5 metra larg tyre, aq sa është gjerësia e rrugës automobilistike Shupenzë-Peshkopi, që i ndan ata nga busti!

Takohemi me administratorin e kësaj njësie administrative, Halil Osmani. I pyetur për ngjarjen ai përgjigjet: - Po jam në dijeni të kësaj ngjarje dhe kam njoftuar Postën e Policisë Shpenzë, si dhe kryetarin e bashkisë Bulqizë, Melaim Damzi. Personalisht jam interesuar për këtë ngjarje, pasi më lidh edhe profesioni i mësuesit të historisë, me figura të tilla të historisë tonë kombëtare.

–Pamja vijon të mbetet mjaft shëmtuese, pasi koka e copëtuar dergjet në tokë mes pluhurit e papastërtive! -i them administratorit.

- Po keni të drejtë, por ne nuk mund të ndërhyjmë, deri në përfundimin e hetimeve nga ana e policisë, pasi gjithsesi ngjarja po hetohet nga ana e tyre. Menjëherë me përfundimin e këtyre hetimeve ne do ndërhyjmë për të rikuperuar vendosjen e bustit në vendin e tij të merituar. Ndërkohë këto hetime të policisë, nuk përligjin indiferencën dhe neglizhencën e zgjatur të ndërhyrjes së pushtetarëve vendor për të rikuperuar këtë ngjarje. Aktualisht koha e rrëzimit të bustit, nuk konfirmohet saktësisht nga askush. Ka banorë që shprehen se rrëzimi ka ndodhur prej muajsh, zyrtarët vendor thonë se ka pak ditë edhe pse lapidari nuk është i rrethuar më shirita të verdhë me mbishkrimin; "skenë krimi", siç dhe ndodh rëndom në të tilla raste.

Gjithsesi, indiferenca dhe zvarritja në ndërhyrjen për t'i dhënë zgjidhje kësaj situate përçudnuese me bustin e patriotit dhe atdhetarit Mersim Dema, në asnjë rast nuk e justifikon drejtorinë e kulturës në bashkinë Bulqizë, e cila në plotësim të punës së saj, mund dhe duhet të ndërhyjë urgjentisht.

Le të shpresojmë dhe besojmë se pas këtij shkrimi në gazetën "Rruga e Arbërit", kjo drejtori në plotësim të detyrës së saj, do të ndërhyjë për të vendosur bustin e patriotit Mersim Dema, dekoruar pas vdekjes nga ish Presidenti i Republikës Sali Berisha, më 14 nëntor 1992, me "Urdhërin për veprimtari të klasit të parë", në piedestalin që meriton.

Rruga e Arbërit nr. 135

kulturë

PORTRET

Vjollca Kola, një jetë në arsim

Nga **SAMET ZAGRADI**



Ajo lindi në një familje të madhe me 5 fëmijë, me prindër që bënë gjithçka që këta fëmijë të edukohen dhe arsimohen, pavarësisht çdo pengese të atëhershme. Kjo familje u fali aq shumë dashuri fëmijëve të saj, saqë bija e kësaj familjeje e shpërndau pa kursim në breza të tërë. Ajo tashmë është në pension dhe pas 38 vjetëve në arsim akoma ruan mirësinë, artin e fjalës dhe dashurinë e pakursyer për këdo që ka pranë.

Zysh Vjollca, siç e thërrasim me plot respekt të gjithë, u rrit në qytetin e Bulqizës deri në moshën 14– vjeçare, ku mbaroi arsimin 8 – vjeçar, duke qenë një nga nxënëset më të mira të asaj kohe. Për tetë vjet ajo studioi në qytetin e Tiranës, ku përfundoi shkollën e mesme dhe atë të lartë. Në vitin 1978 u diplomua për gjuhë ruse dhe për gjuhë - letërsi shqipe. Në moshë fare tërë ajo u punësua si mësuese në shkollën "Demir Gashi" dhe pas ndarjes së shkollës, në shkollën "Selim Alliu"në qytetin e Peshkopisë, deri në vitin 2015 kur ajo mbushi moshën e pensionit. Në vitet e para ajo dha lëndën e gjuhës ruse dhe shqipe, më pas ajo kaloi plotësisht si mësuese e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe. Për 22 vjet mësuese Vjollca u mësoi studentëve italisht ku përgatiti intensivisht dhe me një pasion të gjithë studentët që iknin me studime në Itali. 38 vjet në arsim nuk janë pak. Shumë breza të edukuar nga dora e saj, disa prej tyre janë bërë kolegë me të.

Vjollca Kola ka punuar si mësuese në sistemin arsimor 8-vjeçar, 9-vjeçar dhe në atë të mesëm, duke kaluar në duar qindra nxënës, që sot janë njerëz të rëndësishëm në fushën e politikës, biznesit, mjekësisë e fusha të ndryshme të jetës. Me një dashuri nëne, ajo gëzon në mënyrë maksimale respektin e një qyteti të tërë. U dha mësim fëmijëve të ish - nxënësve të saj, duke ruajtur me fanatizëm seriozitetin e një arsimimi cilësor, me një komunikim perfekt dhe një marrëdhënie profesionisti që kurrë nuk iu zbeh nga vitet, që për të mbeten vetëm numra.

"Megjithëse puna e mësuesit është një punë e vështirë,atë e kam bërë me një dashuri e pasion të madh deri në ditën e fundit. I kam dashur shumë nxënësit e mi dhe mendoj që dhe ata më kanë dashur dhe respektuar. Me forcën e shpirtit jam munduar që t'i mësoj ata që njohuritë e dhëna prej meje tu mbeten përjetë. Rezultatet e arritura nga nxënësit e mi janë kënaqësia më e madhe si mësuese. Për këtë mund të flas shumë. Pjesa më e madhe e tyre janë bërë vetë prindër. Kam mësuar breza nga gjyshër, prindër e fëmijë", - shprehet me plot nostalgji zysh Vjollca për ato vite të arta që ajo ka punuar.

Vjollca nuk kishte kurrë armiq, përkundrazi një staf i tërë e donin pranë vetes, për këshillat, fjalët dhe veprimet gjithmonë të matura. Gjithmonë modeste, e thjeshtë dhe një karakter të butë dhe të brishtë në pamje të parë, me një fytyrë tejet miqësore bëri që të admirohej nga shumë njerëz, të rinj e të vjetër. Teknika e saj e ndërtimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve mbetet gjithmonë unike. Tashmë është në pension, por këto marrëdhënie kurrë nuk ndryshuan për asnjë lloj mënyre nga të gjithë ata që kishin arritur të fitonin zemrën e saj. Një zemër aq të madhe, saqë brenda saj qëndrojnë të heshtura qindra kujtime për nxënësit e saj.

Miq, shokë dhe kolegë të saj shprehën dashurinë dhe konsideratën më të madhe që kishin, me fjalët që thanë për të në gazetën tonë. Bisedat për të sillnin shpesh në kujtesë vitet që kanë qenë me të si kolege, si mësuese apo dhe si shoqe unike.

Ajo tashmë jeton në Tiranë bashkë me familjen. "Ditët e para të daljes në pension kanë qenë jashtëzakonisht të vështira. Vetja më dukej e gjitha bosh dhe më dukej sikur jeta ime përfundoi këtu. Shoqet dhe njerëzit e mi të afërt më kanë ndenjur pranë që të më hiqnin mërzinë dhe ma kanë bërë më të lehtë kalimin e kësaj situate. Më pas u bëra me një mbesë dhe kjo ishte gjëja më e mrekullueshme që mund të më ndodhte. Falënderoj çdo ditë Zotin që më bëri të ndihem gjyshja më e lumtur në botë. Ajo më mbush me jetë. Tani më duket sikur kam rilindur përsëri dhe pavarësisht moshës, unë nuk e ndiej fare atë", - shprehet mësuese Vjollca.

Zysh Vjollca gjithmonë ka qenë një mbështetëse e fortë për të gjithë të rinjtë. Pavarësisht viteve mbi supe, ajo mbetet gjithmonë e re në shpirt. Në çdo çast ajo ka qenë promotore e nxitjes së dashurisë për arsimin dhe dijen, duke dhënë mesazhe të forta dhe duke qenë një model pothuajse perfekt për t'u ndjekur. Mesazhi i saj për të rinjtë është që duhet të punojnë shumë, të mësojnë dhe të investojnë energjitë e tyre në arsim, pasi kjo është e vetmja pasaportë e një pune dhe një suksesi në të ardhmen e tyre. "Dijet nuk përfundojnë me mbarimin e shkollës", - përfundon ajo, duke na përgëzuar dhe falënderuar përzemërsisht për punën që bëjmë në promovimin e çdo vlere të harruar nga çdokush në rrethin e Dibrës. Ajo mbetet një nga njerëzit të cilët vijnë me të vërtetë rrallë.

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

Sllova është e Dibrës, Sllovana është e imja

INTERVISTË ME POETËN TRANDAFILE MOLLA BAJA

Nga **ILMI DERVISHI**



Trandafile Molla Baja, me bashkëshortin, Ramazanin

Trandafile Molla Baja, vajza durrsake që shkruante poezi që në kohën e gjimnazit, është e martuar që në vitin 1975 me Ramazan Baja nga Sllova. kanë jetuar në Durrës, por prej vitit 2002 u largua familjarisht për në Itali, në Novara, ku aktualisht jetojnë dhe punojnë. Në një intervistë për gazetën "Rruga e Arbërit" rrëfen për jetën dhe poezinë...

- Kush është Trandafile Molla Baja?

- Durrësakja me gjysh e prindër, lindur në Durrës por që ndjen veten dhe dibrane...

- Çfarë ju lidh me Dibrën?

- Bashkëshorti im, Ramazan Baja, është dibran, dy vajzat e mia, Enkeleda dhe Sllovana thonë "jemi me origjinë nga Dibra. E nëse Sllova është e Dibrës, Sllovana është e imja.

- Pse ia vutë emrin vajzës Sllovana?

- Sllovana është vajza ime e dytë. Ishte dëshira e Ramazani, i cili me dashurinë për vendlindjen, donte t'ia vinte edhe emrin vajzës Sllova...

- Ç'mund të na thoni rreth poezisë?

- Kam shkruar poezi që në gjimnaz. nën kujdesin e mësuesit dhe shkrimtarit të njohur Gjergj Vlashi. Por vetëm pas viteve 1990 kam botuar librat me poezi "Fjalë zemre", "Kur zemra flet", "Vazhdoj të jem" si dhe kam botuar edhe një libër me poezi në gjuhën italiane "Parole di cupre". Kam gati për botim librin tjetër, po me poezi.

- Përveç poezisë, cilat janë pasionet e tua?

- Lexoj shumë. Më pëlqen vallëzimi, udhëtimet...

- Cila është familja juaj?

- Kam një familje të shkëlqyer dhe të konsoliduar. Të qënurit gjyshe më ka dhënë kënaqësi. Mbesës së parë, Aurorës, sapo i festuam 16-vjetorin e lindjes. Jam bashkëshorte e denjë, nënë e përkushtuar dhe një amvise në shtëpi, një mikpritëse e devotshme dhe gatuaj vazhdimisht.

- Për lexuesit e gazetës, ç'do të na thonit?

- I përshëndes dibranët kudo ku janë. Kam respektin si njerëz të mençur e punëtorë. Duke qenë dhe unë gjysmë dibrane, kemi miq dibrane përmes e prej tyre kemi dëgjuar për Rrugën e Arbërit, median tuaj, e cila prej vitesh lobon për rrugën dhe pasqyron problemet dhe shqetësimet e atyre njerëzve dhe asaj krahine. Uroj që ëndrra juaj dhe e jona të realizohet sa më shpejt.

Kur zemra flet

Kur zemra flet, fjala merr dhenë,
Dhe zemra ndjehet çuditërisht më e qetë,
Dhe në jetë hapet një fletë lumturie,
Kur fleta e lumturisë arrin gjer tek retë.

Zemra flet dhe drithërohet nga lumturia,
Merr udhën dhe arrin në hapësirën qiellore,
Kërkon të kapë një rreze diellore.
Dhe fjalën e zemrës kërkon ta shkruaj në një fletore.

Fjala e ëmbël të rrënqeth trupin,
Fjalë e zemrës së brishtë me dashuri flet,
Dhe ti ndjehesh më e lehtë më e lumtur,
Si ndjehet fjala në zemër me dashuri të vërtetë.

Fjalën e zemrës mos e njollosni me baltë,
Është fjalë zemre është fjalë delikate e artë,
Fjala e zemrës ka nevojë për mbrojtje e s'duhet vrarë,
As me dashuri të zjarrtë e as me dashuri të marrë.

Zemra vritet dhe rri shtrirë si e ngordhur,
Kur fjala e artë është e brengosur dhe e lodhur,
Zemra fluturon në qiellin e kaltërt,
Kur fjala i flet zemrës me dashuri të pastër.

Po mos rri e strukur e arta fjala ime,
Dil dhe shoqëro zemrën e vrarë dhe jetime,
O fjalë mos rri strukur e lënduar në zemër,
Por dil e thirr fort: të dua zemra ime.

Mos o fjalë zemre, mos e tradhto zemrën,
Se fjalë e dhimbsur pa zemër nuk bën dot,
Se nga thellësia e zemrës dhe nga dashuri e saj ke dalë
O e ëmbla, e brishta delikatja, e madhërishmja fjalë.

Fjala shndrit kur ajo është e mbushur plot dritë,
Fjala e zemrës është e sinqertë e reale,
Fjala e zemrës është e mbushur plot dashuri,
Si një trëndafil i kuq i mbushur me petale.



skica

DITAR I SUPOZUAR SIPAS NJË VAJZE...

Ky gusht më gjen të martuar!

Unë nuk dua askënd, domethënë nuk jam e dashuruar me askënd edhe pse këtë ma pandehin kur refuzoj të fejohem me ata që më sugjerohen dhe që jo pak herë më imponohen.

E sosa filloren me një mesatare të mirë në krahasim me shumicën. E pranoj që mund të bëja më shumë dhe të dilja më mirë, po ja që logjika ime aq qe në gjendje të përthithte, shto pastaj faktin se, unë, nga natyra jam pakëz dembele. Sot thonë se më ka ardhë koha, ka avit vakti. Ma kujtojnë vazhdimisht gjyshja, tezja, halla dhe më së shumti ime më. Im atë flet rrallë, por kur flet duhet marrë seriozisht. Bisedat me time më, i shkëput thjeshtë më një: boll më.

Tani ka ardhë korriku dhe inshallah i shpëtojnë dhe nga shtatori, kismet, kam plan të filloj një kurs për parukiere, sepse për shkollë as nuk behët llaf.

Shpesh kur nëpër facebook (të vëllait) shoh ndonjë moshatare të fshatit me foto nga shkolla, më mblidhet një lëmsh mu në grykë, diç më trazohet në stomak dhe jo pak herë më tradhtojnë lotët.

Dita ime është: çohu me sabah, laj-fshij, laj enët, disa herë dal në kopsht dhe ndihmoj time më, kohën tjetër shoh telenovela. Një vit më parë lexoja goxha, derisa një ditë, im atë, më gjeti një libër në dorë, Dashuri në kohërat e kolerës, që ma kish dhënë një shoqe një vit më parë në gjimnaz dhe ma dogji në sobë.

"Dashuri ee? Dashke burrë?" Prej asaj kohe mu hoq libri dhe m'u dalldis në rrashtë si çekiç ideja e burrit. Të gjithë i janë vënë punës dhe ja, ky gusht më gjen 18 vjeç dhe me shumë gjasa të fejuar.

Kjo i kënaq prindërit e mi. Unë i mirëkuptoj, sepse ata duan të më shohin të shohin të sistemuar. Ata duan më të mirën, pavarësisht faktit se çfarë dua unë. Vajza në rrugën matanë e la shkollën e mesme pasi u fejua dy fshatra më tutje me të birin e kryeplakut, i cili sapo ishte kthyer nga Anglia. E përjetoi shumë keq. Thonë që deshi ta linte burrin, madje edhe të vriste veten. Por me ndihmën apo vendosmërinë e të ëmës ia doli. Të paktën unë nuk e kam këtë problem. Unë nuk jam fare në shkollë, dhe burri im s'do e ketë këtë dallgë për ta kaluar.

Shoqja ime e klasës, që kisha në fillore, i ka bërë gati letrat për të ikur në Gjermani. Kështu më tha, kur erdh tek unë një pasdite, dhe pret vetëm sa të mbushje moshën e lejuar, tetëmbëdhjetë vjeç dhe i fejuari i saj do vij ta marrë. Me dëshirë dhe me gëzim, duket që pret takimin e katërt me të. Thotë gjithnjë që e ka marrë malli, dhe të them të drejtën, herë kënaqem me lumturinë e saj, herë më vjen gjynah për naivitetin që karakterizon. Megjithatë, ashtu e ka pas fatin e vet.

Thonë: "Tjetrit i shkel në gjurmë, por jo në rrisk", dhe meqë është kështu, pse dreqin dalldisin të të fejojnë me zor. Pra jo vetëm që të shkelin në fat, por madje tentojnë (shpesh herë ia dalin) dhe gëzojnë të ta ndërtojnë atë. Mirë prindërit, sepse ata thash që ma duan të mirën dhe duan të më shohin të sistemuar, por tezet, hallat, tezet e nënës e mbarë farë-e-fisi. Edhe këto ma duan të mirën? Edhe tezja e madhe që ka vajzën katër vjet më të madhe se unë? Nuk do të merrem me to, sepse ndonjëherë edhe filloj ti urrej.

Sot më folën një për një djalë që të ëmën e tij e njihka tezja. I paska folë shumë asaj për mua dhe si pakuptuar i qenkam fut në zemër. Sa zemër të gjerë që paska! Erdhi tezja (që nuk vjen më pa sebep, por sa herë vjen ka gjet dikë për mua), dhe tha ashtu si me lezet, tuj i ra rrotull-rrotull, si kali i lidhun në kunj, se paska një shoqe të mirë, dhe që ajo paska një djalë aq të mirë, deri sa në fund, e lëshoi gjylen: është një rast për tu marrë në konsideratë, madje për të mos u humbur.

Nuk dija ç'ti përgjigjesha, po ti thoja jo, do mendonin se kam dikë tjetër, dhe gjërat s'doja të merrnin të tillë kahje. Por as po nuk i thoja dot, sepse nuk qesh e vetëdijshme për të tillë gjë. E ndjej që jam akoma fëmijë, ose thjeshtë dua.

Megjithatë e shoh shumë mirë që nuk mbetet gjë

Tashti as unë nuk ua kam besën fort këtyre emigrantëve, një jua bën hallall, por munden me iu dalë dy-a-tre tjera. Gjithësesi, unë e mirëkuptoj çdo prind, që nisur nga parime konservatore, pyesin për prindërit, për familjen, edhe pse djali (burri supozohet i ardhshëm) ka dalë pesëmbëdhjetë vjeç nga kjo familje.

tjetër, dhe duhet me patjetër t'i shoh këto mundësi që do vijnë. Nuk është se s'kam frikë, por po mundohem ta fsheh.

Verën e kaluar, kur im vëlla u kthye me pushime nga Tirana ku studion në të lartën, më pati treguar për një shoqen e tij. Edhe ajo nga një fshat i Dibrës, jo nga ata të thellët, hoqi dorë nga dashuria me një djalë, dhe u fejua me një tjetër rrëzë fshatit të saj. Këtë djali me letra në Itali, ia kishin lavdëru në maksimum (se nuk kemi dëgju të shajë kush dikë në prag-fejesë). Pas fejese i bënë "të bëme e të pabëme", e fill në prag-martese, doli që ky zotni djali i lavdëruem, paska nuse dhe djalë në Itali. Shkurt muhabeti, asaj, në lule të rinis i ra "vrugu". Tashti thotë vëllai që është martu me një burrë martuar më parë në Shehër të Dibrës së Madhe, i cili kishte edhe dy fëmijë.

Tashti as unë nuk ua kam besën fort këtyre emigrantëve, një jua bën hallall, por munden me iu dalë dy-a-tre tjera. Gjithësesi, unë e mirëkuptoj çdo prind, që nisur nga parime konservatore, pyesin për prindërit, për familjen, edhe pse djali (burri supozohet i ardhshëm) ka dalë pesëmbëdhjetë vjeç nga kjo familje. Nga ana tjetër, prindërit harrojnë fjalët që vetë na i kanë mësuar: "Nga trëndafili del ferrë, nga ferra del trëndafil". Nuk them që se du trëndafil, por mjafton mos jetë ferrë me gjemba të trashë.

Nisur nga këto, dhe disa histori të ngjashme, kam bërë një pakt me veten, sipas meje është e keqja më e vogël. Po jua them, por mos e merrni si praktikë se mund që të mos ngjis tek ju, domethënë sipas vendit bëhet kuvendi. Që ti shmangem rrezikut fatal (por edhe një fati shpesh të dëshiruar), nuk do pranoj kurrë të martohem me një emigrant. E di që me këtë mund të shmang edhe ndonjë që vërtet është njeri tamam, ama për të qenë e sigurtë, domethënë mos përfundoj aksidentalisht në Shehër. Rasti i parë që do të dalë me dikë që është këtu dhe punon këtu, çfarëdo pune qoftë ajo. Do pyesni pse. Sepse, e para ai është rrit e burrëru këtu, me këto rite e zakone, me këtë sedër e nder. Së dyti këtu jam afër prindërve: shto faktin që i shoh sa herë dua, fundja askush nuk mund të luaj kollaj me jetën time. Dhe së treti, dhe jo më pak e rëndësishmja, ndaj jetën me të, d.m.th, shprehur brutalisht, ndaj netët me të.

Para disa javësh, se paskam harruar t'jua tregoj, erdh një hallë e mamit. Sa u qas në prag të derës së madhe, t'ju them të drejtën më shkoi në mend pse ka ardhë. I rrëfeu mamit me zë të ulët, kur unë po bëja dy kafetë, se qenka një rast shumë i volitshëm në Angli, por djali na qenka pa letra. Kur unë u futa në dhomë me tabaka në duar, që s'më dridheshin më sepse isha mësuar me të tilla gjëra, halla e mamit filloi ma lajka. Pasi ma parashtroi dhe mua rastin me zell shumë të madh, fytyra iu zbeh kur e pyeta se kur do vinte ky djali nga Anglia. Ajo u përtyp dhe tha se nuk vjen dot, s'ka letra. Pastaj tha se do shiheni në foto, do flisni në ashtu, si i thonë: skajp. Dhe masandej, ai të merr atje, k'shu sikur ka sh'ku vetë ose me letra fallso ose me kamion.

Duke parë time më që me ç'po shihja i pëlqente ideja, fillova jo të urrej hallën e saj, por edhe atë. Deri këtu arrin të gjeturit një burrë?!

Unë, dhe jo vetëm unë, jam rrit dhe edukuar me idenë se do shkoj tek burri...

ALBAN TUFA

Për një Dibër të bashkuar

Nga **DIONIS XHAFA**

Përçarja, ndasia, përjashtimi, mosdurimi i tjetrit, ja çfarë janë gjërat të cilat kultivojnë vetëm shije të së keqes e se nuk lënë shteg për të triumfuar e mira e përbashkët. Po janë këto dukuri që shfaqen thuajse kudo, në vendin tonë në radhë të parë, në krahinën tonë ta themi më shkoqur. Edhe pse një krahinë që për fat të keq ashtu bujarisht e krenarisht ka mbetur e braktisur goxha nga njerëzit e vet, brenda saj ka përçarje, një ndasi që ka kuptimin më negativ të mundshëm. E kisha në dorë gazetën gjatë muajit që lamë pas dhe se aty vura re dy artikuj.

Në gazetën "Rruga e Arbrit" të muajit qershor 2017, në faqen 19 ishte artikulli me titullin "Çeta e shpresës" me bashkëautorë Xhevat Jella e Sabit Lleshi. Kurse në faqen 23 të gazetës lexova artikullin: "Do të eliminoheshin në kampe shfarosëse" me autor Dedë Doçi. Autorët personalisht nuk i njoh. Por çfarë vura re në këto dy artikuj? Të dyja flisnin për fatin e dibranëve gjatë kohës së vështirë të Luftës së Dytë Botërore, kur ishte një nga kohërat e trishta dhe njerëzimi ishte ndarë në dy kampe, si me thikë, ku njerëzit vriteshin e priteshin për çështje ideologjike. Në artikullin e parë vura re një fryrje tepër të madhe të luftës partizane, që ngritur me heroizma, vetëm dëshmonte se veç ky mjet na qenkërka më e mira e të gjithëve. Ndërkaq, në artikullin e dytë shfaqej ana tjetër e medaljes dhe se bëhej fjalë për vuajtjet e dibranëve nën pushtetin e komunistëve, që me gjak erdhën në pushtet dhe se në fund rezultoi se vranë njëri-tjetrin vetëm për çështje të karriges.

Dy artikuj diametralisht të kundërt. Mundet që secili të ketë të drejtë. Te e para mbrohet lufta për liri dhe te e dyta del në pah dhimbja njerëzore, njeriu që përballet me një pushtet të egër, gjakatar që tashmë është bërë sistem. Po a ia vlen të ndahesh, të përçahesh, të hysh brenda labirinteve të vëllavrasjes, të përçarjes mes si vëllezërve të tu? A ia vlen të thuash se një palë qenka e mirë dhe tjetra qenka e keqe? Në fakt, bashkimi është vlera që rrit dibranët, shqiptarët, për të qenë në ballë të problemeve të përditshme, që na "hanë" çdo ditë e më pak. Kur të përbashkon e mira, vlera, mendësia se tjetri kur nuk bën gjë është njëjtë me ty, kur e sheh tjetrin si të barabartë me veten, kur në përpjekjen për të mposhtur tjetrin të mundohesh të jesh në rolin e tij e të kuptosh se ç'do të thotë të të vënë tëposhtë, pa pasur mundësi as të flasësh fjalën tënde,a tëherë je brumosur me vlera njerëzore.

KOHË E LARGËT, NDARJE E PADOBISHME

Dy artikujt në fjalë flasin për një kohë relativisht të largët, më 1945 diku ose përpara se të vinte ky vit, që për disa konsiderohet si çlirim dhe për disa si fillimi i robëtimit prej një pushteti që rropati shumë njerëz nëpër kampe e burgje, vetëm e vetëm se kishin ide të ndryshme nga aparati shtetëror i kohës. Në fakt, koha lë gjurmë, lë plagë në zemra dhe se ajo sidoqoftë është burim nga rrjedh urrejtja. Por kjo gjë nuk duhet lejuar. Koha ecën dhe se e shkuara gjithnjë e gërryen të ardhmen, kur kemi ndërmend se çfarë kemi kaluar.

Ndarjet nuk janë të mira, as të dobishme, aq më tepër për një zonë të varfër e të vuajtur si Dibra, ku si të mos mungonte gjë tjetër duhet edhe filizi i një kohe që nxjerr duf e mllef për tjetrin si individ, të cilin duhet ta respektosh aq sa veten. E liria ka vlerë kur mirësia del në pah e bashkimi e rrit mirësinë, për të ardhmen e shëndritshme. Plagët shërohet duke u munduar t'i mbyllësh në forma të ndryshme, nga koha, nga tik taket e orës që rrjedh papushim dhe jo duke e treguar fare hapur se plaga ime është shkaktuar prej teje, aq më tepër prej paraardhësve të tu, që lidhje me mua apo tjetrin nuk kanë. E kështu, vetëm me bashkim mundet që ai pak zell i mirë që ekziston për të bërë punë të hajrit e të shëndetshme të vihet në ingranazh të jetës së përditshme. E keqja gjithsesi duhet anashkaluar më e pakta dhe duhet luftuar nëse ajo na mbulon të gjithëve.

E më mirë se një Dibër e bashkuar nuk mund të ketë, që bën bashkë pjesë të ndryshme të një zone që historia e ka ndarë, copëtuar dhe bërë përshesh me fate të trishta në rrjedhën e një kohe që ka kaluar plot dhimbë. E dhimbja duhet çuar tutje, fshehur përpara tjetrit për të mos e lënduar se litar në shtëpinë e të varurit nuk përmendet, me qëllim që me personin tjetër të gjesh rrugë të komunikimit aty ku janë të përbashkëtat, ku mundesh të lidhesh, pa dëmtuar asnjëri - tjetrin. E bashkimi, vëllazërimi, liria mbi të gjitha janë principe që ngrenë në këmbë zemra kombesh të qytetëruara të Europës, njerëz nga mbarë kulturat e rruzullit dhe sigurisht që mund të bëjnë bashkë edhe zemrat e dibranëve.

Bëj pajtimin tënd me PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Letër nënës nga shumë larg

POEZI NGA MENTOR HOXHA





MENTOR FAIK HOXHA ka një karrierë të spikatur si poet, gazetar dhe studiues. Ka botuar në shtypin ditor dhe në revista ta njohura me qindra artikuj politikë e social-kulturor, mbi 500 portrete dhe intervista ekskluzive me figurat më të rëndësishme politike, artistike, kulturore shkencore e sportive të 27 viteve të tranzicionit shqiptar, si dhe 12 libra të gjinive të ndryshme letrare; poezi, reportazhe, studime letrare e historike, intervista me personazhe VIP të politikës, skenës dhe ekranit shqiptar. Shumica e intervistave, e artikujve dhe e studimeve letraro-historike të tij janë publikuar në faqet e para të gazetave dhe revistave të njohura.

Nga përmbledhjet e tij poetike përzgjodhëm disa poezi ku ndihet malli dhe dhimbja e madhe e autorit për vendlindjen dhe bashkëkombasit e tij, për djalin e tij të vetëm 8 vjeçar, Marion dhe për bashkëshorten, të cilët ka një vit pa i parë, pasi jetojnë në dy shtete të ndryshme evropiane. Mjaft prekëse është poezia "Lamtumirë Atdheu im! dhe "Letër nënës" (kushtuar nënës së tij 85-vjeçare). Tek e para përshkruhet me një ndjenjë të fuqishme dhimbjeje dhe malli ikja e tij nga vendlindja për të mos u rikthyer më kurrë, kurse te vjersha "Letër nënës" tregon artistikisht shkakun e kësaj ikjeje dhe pikëllohet shumë për fatin e tij të zi dhe për nënën e tij 85-vjeçare, pasi, në rrethanat që i janë krijuar ka mundësi të mos e shohin më njëri-tjetrin për së gjalli. Një poet i njohur dibran, Maliq Bitri, shumë vite më parë, e ka cilësuar si "Esenini i Dibrës". Poeti Mentor Hoxha na zbulon në këto poezi mjaft prekëse, jo vetëm fatin e tij, por edhe edhe fatin e rreth një milionë shqiptarëve të ikur nga Shqipëria. Fati i tij ngjason me ikjen e poetit të madh anglez George Gordon Byron (Xhorxh G. Bajronit) i dëbuar nga Dhoma e Lordëve angleze, të Fan Nolit i dëbuar nga Mbreti Zog dhe të e shumë e shumë poetëve të tjerë të dëbuar apo të larguar nga vendlindja e tyre.

...LETËR NËNËS NGA LARG

...Vetëm ti mojë Nënë shpirtin ma kupton
Lindëm në një vend, fati na largon.

Ti në dheun tënd, unë larg nëpër botë
Si dallga në breg, ashtu endem sot.

Por dhe pse aq larg, udhëve të botës
Si zgalem mbi dallgë qëndoj midis shqotës.

Nuk më tremb stuhia, as bota e madhe
Por ah, largësia më mbyti në malle.

Më ndau nga Ty, nga djali dhe gruaja
Ndaj më treti dhimbja në udhët e huaja.

...Siç ka nisur jeta, mbase dhe një ças'
Do na marri vdekja pa u parë bashkë.

Mbase nuk di shihemi, as ditën e vdekjes
Si qiri do shkrihemi nga zjarri i dhembjes.

***

Vetëm ti moj Nënë me shpirtin kristal
Si zjarri në votër, ngrohtësi më fal.

Por ta dish moj Nënë brenda shpirtit ç'kam
Më dhemb ajo votër kur aty nuk jam.

Më ther ai prag me zjarrin e shuar
Kur i Zoti larg ngroh tokën e huaj.

...Dhe mbase përjetë do qëndroj kështu
Si zogu pa fletë harruar diku.

***

...Sido që të jetë fati im i krisur
dua zjarr të ketë votra ku kam lindur.

Mos e lër të fiket emri im i mirë
Por si zjarr të ndrijë në votrën e ngrirë.

Ta shohin të gjithë që unë jam gjallë
Dhe pse larg i dergjur në zjarrminë mall.

***

Nënë moj, e dashur Nënë!
Shpirti im buçet nga larg
Në Atdheun tim kam lënë
Shumë kujtime edhe plagë.

...Prandaj sot nëpër udhë
Birin tënd e mundon brenga
Porsi hëna edhe unë
Nëpër botë shumë renda.

...Por tani i lodhur jam
Llamba e shpresës është shuar
Mijra djem pa nëna janë
I tret ikja e mallkuar.

I tret ndarja pak nga pak
Djemt' dhe nënat shqipëtare
Det i dhimbjes tokën lag
Se u shua shpresa fare.

***

Nënë moj! E dashur nënë!
Zëri im thërret nga larg
Për çdo mbrëmje porsi hënë
Buzagaz më del në prag.

Ta ndjej zërin tënd të bukur
Ti shoh sytë ëngjëllorë
Trupi yt i leht' si flutur
Zbukuron trullin arbnor.

...Të ka mundur pleqëria
Keqas po të mundon ndarja
S'po i sheh dy ditë të mira
Se në votër ra murtaja...

Ballërrudhur, trup kërrusur
Në vetmi i kalon netët
Syri yt qerpikëvyshkur
Qan për bijt' që morën detet.

I shkon lotët çurg për mua
Keqas shpiti t'u zhurit
Por ta dish në sytë e tua
Forcë marr për çdo ditë.

....Edi malli të ka marrë
Për mua që rrugët mora
Shkuan muaj pa u parë
Ndaj më dridhet sonte dora.

Pleqëria dhe zhgënjimet
Të kanë mbushur plot me plag'
Prandaj sot moj nëna ime
Mall e dhimbje kam në varg.

***

Nënë moj, e dashur Nënë!
Shpirti im thërret nga larg
Që Ty vetëm të kam lënë
Zemra ime kullon gjak.

...Eh, moj Nënë hallemadhe
Krejt kërrusur nga lëndimet
Djali yt, udhës së madhe
Kërkon shpresën tek mërgimet.

Ma fal nënë ikjen time
Por nuk kisha rrugë tjetër
Në çdo anë gjeja rrethime
...Më donin disa të vdekur.

Ika nënë..., nuk më mbajti
Vendi im kockë-lëkurë
Dhe nuk dihet ç'më sjell fati
...Ndofta trupin në qivur.

Ti mos qaj për fatin tim
Por qëndro e fort si burrë
Se atje dhe në mërgim
Të këqija s'bëra kurrë.

Në hak kujt nuk i hyra
Nuk i shita miq e shokë
As njeri me dy fytyra
Por i ndershëm dhe i fortë.

***

Nëse Nënë të kam lënduar
M'i fal fajet dhe lëndimet
Se këtu në dhe të huaj
Tok me Ty i pres agimet.

Nëse Nënë të kam lënduar
Falmi fajet dhe mëkatet
Se këtu në dhe të huaj
Birit tënd i ndahen fatet.

LAMTUMIRË ATDHEU IM!

...Po largohem sonte i vetmuar
Larg vendlindjes sime, shumë larg
S'do ta gdhi mëngjezin përqafuar
Nga mikesha ime ndezur flak.

S'do më ngroh më dielli i vendlindjes
Shqipërinë më nuk do ta shoh
Porsi bari do vyshkem prej ikjes
Nëpër udhë që fare si njoh.

S'do ta pi më kafen e mëngjesit
Te "Europa" brenda në Tiranë
Krejt të huaj do më duken njerëzit
Diell tjetër do më gjendet pranë.

Për atdhenë, shokët dhe familjen
Mallin prush do ta kem në shpirt
Rrugëve të botës do të sillem
Si i verbri që do pakëz dritë.

...Shumë vjetë zemra ime priti
Por në fund shpresa krejt u shua
Ndaj po lë vendin që më lindi
Djalin, nënën dhe fatkeqen grua.

Por e di..., Do rikthehem prapë
Në vendlindjen time të nxirosur
Por në trup do kem qindra plagë
Nga ndarja e zezë dhe e pasosur.

15 qershor 2016

BASHKË ME GRUAN RRUGËT MORA

...Kur shpirti im qante nga dhimbja
Askush për mua s'u përlot
Si re më dukej dhe vendlindja
Si korb i zi e imja port'.

Ndaj bashk' me gruan rrugët mora
Kërkova fatin diku larg
Por ish i zi dhe dheu i huaj
Me brenga mbushur rreth e qark.

Kur rrotull votrës bridhja unë
I dëshpëruar dhe mërzitur
Nga brenga ime s'bënte gjumë
Dhe nëna ime shpirtzhuritur.

Përveç asaj s'u brengos tjetër
Pse keq më shkuan punët mua
Madje, dikush, si ujk vjetër
Për ikjen time u gëzua.

Kjo botë e keqe, e pashpirt
Në xhungël kthehet shpesh për ne
Si ujk të ndiqka vendi yt
Dhe grushtin miku yt ta ngre.

Kur shpirti im klithte nga plagët
I mbyllën veshët që të gjithë
Prandaj tani udhës së largët
Me gruan time kërkoj dritë.

Por kush për mua nuk mendon
Për dhjetra plagë që kam në trup
Veç nënës loti i shkon çurg
Dhe shpirti keqas iu bë shkrumb.

FSHATLINDJES BLLIÇE

...Brodha shumë nëpër botë
Pashë vende të magjishme
Por askush s'më ngrohu dot
Si vendlindja, fshati Blliçe.

Molla, kumbulla dhe rrushi
Si gjerdan Blliçes i rrinë
Vajzat faqet kuq si prushi
Djemtë porsi yje ndrijnë.

Në çdo vend ku qëndrova
Londër, Bruksel dhe Berlin
Asnjë femër nuk shikova
Si vajzat e fshatit tim.

Eh t'i shihni sa të bukura
Ç'nur e gas u ndrin në faqe
Belkëputura, buzpaputhura
Si lule mbirë në pragje.

Armiqtë porsi kuçedra
Katër herë fshatin ma dogjën
Por lirinë zjarr përbrenda
Dot blliçjanit s'ia morën.

Shumë rrebeshe edhe dallgë
E përgjakën fshatin tim
Por Blliçja u ngrit mbi valë
Si zgalemi mbi stuhinë.

Thesaret e fshatit tim
Kush si njeh e kush s'i di
Ndaj është kaq e magjishme
Ndjenja që më vlon në gji.

Madhështinë e fshatit tim
Qindra vargje nuk e nxënë
Aty kombi im rilind
Demokracia ka rrënjë.

***

Nëpër botë e nëpër brigje
Pashë mrekullira shumë
Por mallin për fshatin Blliqe
Nuk ma shoi asnjë lumë.

Me rastin e 100 vjetorit të lindjes


Ali Puca, mësuesi me zemër të madhe

Nga **ZABIT LLESHI**

Gryka e Madhe është shquar gjatë gjithë historisë së saj në luftën për liri dhe pavarësi. Ajo ka nxjerrë burra trima, të mençur, udhëheqës e prijësa popullorë, heronj e dëshmorë që mbetën të paharruar, si Mustafa Shehu, Fasli Malja, Sal Meta, Ismail Baloshi, Ahmet Loka, Sal Zeneli, Sulejman Shehu, Jakup Cani, Hasan Pata, Isak Metalia, Jashar Kola, Ramiz Hyseni, Ramadan Cani etj. Krahas përpjekjeve për mbrojtjen e vatanit, ata nuk e ndanë luftën për gjuhën e shkollën shqipe, duke dhënë një ndihmë të çmuar jo vetëm në Dibër e rrethinat e saj, por edhe më gjerë në shkallë kombëtare.. Veprimtarinë e gjithanshme që organizoi Sheh Sula, së bashku me lëvruesit e gjuhës shqipe në Dibër Said Najdenin, Hoxhë Moglicën, Destan Pucën, Shaqir e Ramiz Dacin, Haki Sharofin, Osman Moglicën, e vazhduan Ramiz Alliu, Selim Alliu, Munir Shehu, Asllan Zeneli, Riza Navaku, Ali Puca, Ramiz Gjoka, Ramadan Hoxha, Fadil Shehu, Isuf Xhaferi etj.

Ali Puca lindi më 10 gusht 1917 në Godvi. Origjina e hershme e fisit Puca është nga Hasi (Malësi e Gjakovës). Babai i tij, Destan Puca kishte një emër të mirë në Grykën e Madhe, së bashku me vëllezërit dhe bijtë e tyre kanë dhënë një kontribut të madh në pavarësinë e Shqipërisë, mbrojtjen e vendit, në luftën për demokratizimin e jetës së vendit (1920-1924) etj. Më 1922 u shpërngulën përfundimisht nga Godvia dhe zbritën në Zall-Sopot. Familja Puca u bë një familje e madhe, ndër bazat më të fuqishme të LANÇ të Dibrës, veçanërisht në Grykën e Madhe.

Fëmijëria e Aliut, ashtu si shumë fëmijëve dibranë, nuk kishte ndonjë perspektivë. Familja priste të rritej, që të merrej me blegtori, prandaj edhe shkollën plotore të Zerqanit e filloi me vonesë. Megjithatë, e përfundoi këtë shkollë, ku dolën në pah zgjuarsia dhe vullneti për të mësuar, që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Pas mbarimit të shkollës sëmuret. Në ketë kohë, xhaxhai i tij, emigrant në Ankara, vjen në vendlindje për t'u çmallur dhe në kthim merr Aliun për t'i dhënë ndihmë mjekësore më të specializuar në Ankara. Pas shërimit regjistrohet ne Liceun e Djemve në ketë qytet mbaron klasën e VI, VII dhe liceun më 1940. Në ketë lice u dallua për rezultate të larta në mësime, sidomos në matematikë, lëndët ekzakte dhe



në ato të përgatitjes ushtarake. Në një testim në vitin e parë mori notë maksimale, ku tërhoqi vëmendjen e pedagogëve të shkollës. Shpesh pedagogët, për nxënësit që hasnin vështirësi në matematikë, i drejtonin tek Ali 'Arnauti'. Në përfundim të shkollës u gradua edhe oficer, por me që nuk ishte nënshtetas turk, nuk iu dha dëshmia.

Më 1940, pasi Italia pushtoi Shqipërinë, sulmoi Greqinë. Ali Puca mblodhi një grup shqiptarësh në Ankara, për t'i ardhë në ndihmë popullsisë greke. Të parët që u regjistruan në këtë grup ishin bashkëfshatarët e tij Muharrem Likalla e Ferit Zogu. Ata u paraqitën tek Ambasada Greke në Ankara. Ajo i këshilloi që të luftonin nën flamurin grek, nuk pranuan, ngulën këmbë për të luftuar nën flamurin shqiptar. Në këto rrethana, shqiptarët u larguan nga Ambasada Greke, të indinjuar nga refuzimi i luftës përkrah koalicioni antifashist.

Për disa vite punoi në Ankara, pranë xhaxhait, Mehmetit, si menaxher i dyqanit të tij, por mendja i rrinte në vendlindje. Mbante kontakte me vëllain Hysenin, që ishte më i moshuari i familjes pas vdekjes së Destanit(1931). Ai gjente mundësi të ndihmonte familjen e Luftën, si kauzë e drejtë për çlirimin e Shqipërisë, që e gëzoi pa masë kurorëzimi i saj më 1944. Në qershor 1948 kthehet nga Turqia për të jetuar e punuar pranë njerëzve të tij të afërt. U martua me Nadire Ibrahim Hoxhën, nga Valikardha. Në janar 1949 filloi punë si mësues në Fushë-Bulqizë, pastaj në Zerqan deri më 1974. Ka shërbyer në Sllovë me 1951-1952, në Zogje në vitet 1960-1961.

Nadirja rritur në një familje me ndenja të pastra atdhetare ishte një nënë fisnike me shumë edukatë. Në Sllovë dhe Zogje, erdhën familjarisht duke i qëndruar në krah mësues Aliut. Mbante veshjen e bukur popullore (veshjen e Zerqanit), që rrezatonte pastërti e kulturë. Ajo shihej me simpati e adhurohej nga gratë e Sllovës, Grykës Madhe e të Vogël, dha një ndihmë të madhe në emancipimin e gruas.

Familjes së re i erdhën në dritë pesë djem: Iliri, Aqifi, Feriti, Fatbardhi dhe Shpëtimi. Pas një sëmundje të rëndë, më 1961 Nadirja ndahet nga jeta. Kjo tronditje la gjurmë në ndërgjegjen e fëmijëve të mitur që Aliu e përballoi me forcën e karakterit që manifestonte kurdoherë. Për të rritur fëmijët, Aliu u martua me Hatixhe Xhemalin, nga Kurbegu i Maqellarës.

Ali Puca punoi gjithnjë në shkollat 7-8 vjeçare, duke dhënë lëndën e matematikës. Ai shkriu gjithë talentin e tij në punën me nxënësit. Në vitin 1949, në kursin e kualifikimit të mësuesve në Tiranë, tregoi përgatitjen e tij të lartë shkencore e metodike. Për këtë, u propozua nga Prof.Osman Kraja (shef i katedrës së matematikës në universitet) që të punonte si pedagog në UT. Për arsye familjare, Aliu e refuzoi këtë detyrë. Ishte mjeshtër në mësimdhënie, i qetë dhe me zemër të madhe, komunikonte me takt dhe respektonte këdo. Lëndën e matematikës e bënte sa më të kuptueshme, me atë durimin e tij që ia kishte zili çdo koleg.

Nxënësit e Ali Pucës shkëlqenin në shkollat e mesme. Në kujtimet e tij, Dr. Gafur Muka, shkruan se "Mësuesi i Matematikës në Teknikumin e Prrenjasit pyeste për Ali Pucën. Ai e njihte nëpërmjet nxënësve të tij që vinin në këtë Teknikum për rezultate të larta në Matematikë". Ali Puca gëzonte respekt nga mësuesit e shkollave të mesme të Dibrës dhe ato 8-vjeçare si ndër mësuesit më të mirë të kësaj lënde. Është dekoruar me Urdhrin "Naim Frashëri" nr. dekreti 4649, datë 5.3.1970.

Pasionin e mësuesit Ali Puca e përcolli te shumë nxënës, të cilët më pas u përgatitën si mësues. Nën shembullin e këtij mësuesi punuan ish nxënësit e tij: Hasan Gjura, Tomorr Dani, Miftar Lami, Bujar Novaku, Rakip Alushi, Islam Hysa, Destan Rama, Pertit Kurcani, disa prej tyre u bënë mësues matematike si: Ismail Llagjaçi, Bujar Shehu, Hysen Likdisha, Muharrem Bardhi, Agim Hyka, Latif Okshtuni, Hysen Kamberi etj.

Për eksperiencën, ndihmën, mbështetjen që dha Ali Puca, veçanërisht mësuesve të rinj, pa frikë mund ta quash si 'mësues i mësuesve' të Grykës së Madhe. Fëmijët e tij disa u bënë mësues si Aqifi, Fatbardhi, Shpëtimi mbaroi Liceun Artistik, Iliri agronom i lartë (dha mësim në shkollën e mesme Zerqan, 4 vjet mësues në Strkçan, 1 vit drejtor). Ai ndjente kënaqësi kur djali i Aqifit Erioni, doli mësues, më vonë mbaroi shkollën Eriola e Fatbardhit. Pra tre breza mësuesish në familjen e Ali Pucës.

Ali Puca ishte njeri me zemër të madhe, si çdo mësues në përgjithësi, por babaxhan i thjeshtë, gjithnjë e shihje të qeshur. Kishte dëshirën për të ndihmuar gjithkënd dhe për gjithçka. Komunikonte si me fëmijët edhe me të rriturit, pleqtë e me tipa të ndryshëm, si i afërt dhe i dashur me të gjithë prandaj e thërrisnin 'daj Aliu', si respekt ndaj figurës së tij. Rrallë njeri e fiton një vlerësim të tillë në shoqëri.

Aliun shpesh në vitet 1950-60 e ngarkonin me detyrë në fushata arsimore, sidomos në zona të vështira për realizimin e kontigjentit të nxënësve. Kishte një aftësi për t'u admiruar në marrëdhëniet me njerëzit, me prindërit e nxënësve. Dinte të komunikonte me drejtuesit e fshatrave dhe më njerëzit e thjeshtë. Është interesant, se Dajë Aliu nuk pranonte asnjë detyrë shoqërore, me përjashtim arsimin. As poste drejtuese në shkolla nuk pranonte, ndonëse kishte një autoritet të padiskutueshëm. Ishte i respektueshëm nga të gjithë, pasi të gjithë i respektonte. Jetonte me hallet dhe shqetësimet e njerëzve, zgjidhte probleme shoqërore, ndonëse ishte larg detyrave dhe përgjegjësive shtetërore.

Më 10 gusht 1997, në moshën 80-vjeçare ndahet nga jeta, që për konçidencë kjo ditë ishte dhe lindja e tij. Më 10 gusht mbushen 100 vjet nga lindja e këtij mësuesi me zemër të madhe. Jeta dhe vepra e Ali Pucës si qytetar, si mësues, patriot, bamirës, human, ishte e do të jetë frymëzuese për familjen, të afërmit, për popullin që e njohu brez pas brezi.



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.




Libra


Të gjithë këto tituj te libraria M&B në Tiranë i gjeni me 10% zbritje nga 1 korriku deri më 31 gusht 2017


...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...














Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë,
librarisë M&B në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi.
Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):











cyan magenta yelloë black